


DECENTRALIZIMI në STAGNACION

**Ndjekja e Procesit të Decentralizimit
Republika e Maqedonisë
Raporti 2011**



DECENTRALIZIMI në STAGNACION

**Ndjekja e Procesit të Decentralizimit
Republika e Maqedonisë
Raporti 2011**

Shkup, qershor 2012

Boton:

Fondacioni Shoqëri e hapur – Maqedoni

Për botuesin:

Vladimir Millçin, Drejtor ekzekutiv

Përgatiti:

Georgi Hristov, Jane Vrteski, Natasha Ilijeva – Acevska
Qendra për zhvillimin e demokracisë lokale

Redaktorë:

Fani Karanfillova - Panovska
Kire Milovski
Aleksandar Stojanovski

Përkthimi:

Abakus

Formësimi artistik - grafik:

Koma

Shtyp:

Propoint

Tirazhi:

100

Tirazh pa pagesë/jo komercial

CIP - Katalogizacija vo publikacija
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

352.073.52:005.548.1(497.7)"2011"(047)

352:73]:005.548.1(497.7)"2011"(047)

352:711]:005.548.1(497.7)"2011"(047)

ХРИСТОВ, Георги

Децентрализација во стагнација : следење на процесот на децентрализација во Република Македонија извештај 2011 / [автори Георги Христов, Јане Врtesки, Наташа Илијева Нацевска]. - Скопје : Фондација отворено општество, 2012. - 98 стр., 88 стр. : илустр. ; 24 см

Насл. стр на припечатениот текст: Decentralizimi në stagnacion. - Обата текста меѓусебно печатени во спротивни насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - Тираж 100. - Фусноти кон текстот

Содржи и: Анекс: 1-4

ISBN 978-608-218-149-3

1. Врtesки, Јане [автор] 2. Илијева-Ацевска, Наташа [автор]

а) Општини - Финансирање - Мониторинг - Македонија - 2011 - Извршна власт

б) Општини - Образовни надлежности - Мониторинг - Македонија - 2011 - Извршна власт


COBISS.MK-ID 91972362

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE -----7

KONSTATIMET KYÇE ----- 11

1. Me çfarë do të mbahet mend decentralizimi në RM gjatë vitit 2011	
1.1 Në RM asnjë të re - decentralizim (fiskal) i centralizuar	21
1.2 Komunat të “vozitura” me mjetet e transportit shkollor?!	24
1.3 Legalizim të objekteve të paligjshme - vazhdim i parregullsisë dhe ndërtimeve në të zezë	27
2. Analizë e rezultateve nga decentralizimi fiskal për vitin 2011	32
2.1 Indeksi i decentralizimit fiskal (IDF)	32
2.2 Nën-indeks i implementimit të politikave	35
2.3 Nën-indeksi i bilancit financiar të NJVL-ve	39
2.4 Nën-indeks i gjendjes së përgjithshme ekonomike në komunën	43
2.5 Nën-indeks i transparencës dhe përgjegjshmërisë	46
3. Analiza e rezultateve nga arsimi për vitin 2011	50
3.1 Indeksi i performancave të decentralizimit në fushën e arsimit (IPDA)	50
3.2 Nën-indeks i zbatimit të politikave për arsim nga ana e komunave	53
3.3 Nën-indeks i menaxhimit financiar të sistemit lokal arsimor	56
3.4 Nën-indeksi i shërbimeve komunale në arsim	60
3.5 Nën-indeks i transparencës dhe përgjegjshmërisë në arsim	62
4. Analizë të rezultateve të decentralizimit në urbanizmin dhe planifikimin urbanistik për vitin 2011	65
4.1 Indeksi i performancave të decentralizimit në urbanizëm dhe planifikim urbanistik (IPDU)	65
4.2 Nën-indeks për implementimin e politikave për decentralizim në urbanizmin	68



4.3 Nën-indeks i gjendjes financiare të komunës në pjesën e urbanizmin	70
4.4 Nën-Indeks i performancave të shërbimeve komunale në pjesën e urbanizmit	73
4.5 Nën-indeksi i transparencës dhe përgjegjshmërisë në pjesën e urbanizmit	77

ANEKSI 1:

Kritere për notimin e treguesve fiskal	79
---	-----------

ANEKSI 2:

Kritere për notimin e treguesve në arsim	81
---	-----------

ANEKSI 3:

Kritere për notimin e treguesve në urbanizmin	84
--	-----------

ANEKSI 4:

Përmbledhje e notës sipas fushave për partner komunat	86
--	-----------



Përmbledhje ekzekutive

Në këtë raport janë përmbledhur rezultatet nga vëzhgimi i zbatuar mbi decentralizimin gjatë vitit 2011 për arritjet e gjithë dymbëdhjetë partner komunave në fushat: arsim, urbanizëm dhe planifikim urbanistik dhe decentralizim fiskal. Gjithashtu, në raportin jepet edhe një analizë krahasuese të këtyre rezultateve dhe rezultatet e monitorimit të zbatuar gjatë vitit 2010 (përfshin periudhën 2008-2009) dhe 2011 (përfshin periudhën 2010). Në fakt, me incizimet e zhvilluara për katër vitet e fundit (2008 - 2011) është siguruar një bazë e mjaftueshme me të dhëna për të përcaktuar trendët për zbatimin e decentralizimit. Përveç konkluzioneve nga vëzhgimi, në këtë raport është përfshirë edhe një shqyrtim i shkurtër i disa aspekteve të rëndësishme të decentralizimit në rajonet e analizuara, të cilat ndodhën në vitin 2011, si: dhënia e pasqyrës së decentralizimit fiskal me theks në mospagesën e këstit të fundit (12-të) të bllok dotacioneve për komunat si dhe prezantimi i obligacionit komunal, në pjesën e arsimit është analizuar problemi me transportin shkollor, ndërsa në urbanizëm është dhënë një pasqyrë e procesit të legalizimit të objekteve të paligjshëm.

Njëlloj sikur në raportet paraprake, të gjitha faktet dhe analizat e prezantuara në këtë raport kanë të bëjnë me vlera/notat mesatare të cilat kanë arritur partner komunat në secilën prej fushave të analizuara, ndërsa në Aneksin 4 janë dhënë vetëm notat e përmbledhura sipas fushave për secilën komunë ndërsa arritjet individuale të secilës komunë në veçanti, me analizë të detajuar të secilit prej treguesve janë në dispozicion vetëm në partner komunën përkatëse.

Për të siguruar krahasim të rezultateve për gjithë periudhën krahasuese, hulumtimi për vitin 2011 ka mbajtur qasjen e njëjtë metodologjike dhe metodologjinë specifike të përdorur në hulumtimin paraprak për vitet 2008, 2009 dhe 2010, gjegjësisht: janë përfshirë tre fusha të decentralizimit: decentralizimi fiskal, arsimit, urbanizmi dhe planifikimi urbanistik;


- janë matur më tepër se 50 tregues të cilat paraqesin një lidhje të treguesve kritik të performancës në nivelin lokal dhe një pjesë e tyre inkorporojnë edhe ndikimet nga pushteti i nivelit qendror;

- ishte zbatuar qasje holistike e cila merr parasysh: 1) politika kombëtare me të cilat decentralizohen dhe realizohen kompetencat në nivelin lokal; 2) pavarësia financiare dhe kapaciteti i komunës për implementim të detyrave; 3) performancat e komunave gjatë dhënies së shërbimeve nga fusha përkatëse, dhe 4) shkalla e transparencës dhe përgjegjshmërisë së komunës gjatë implementimit të fushës përkatëse.

Qasja e tillë metodologjike parashikon kalkulim të **Indeksit të Performancave të Decentralizimit (IPD)** në Republikën e Maqedonisë, e cila fitohet me anë të indekseve të posaçme për performancën e komunës në arsim (IPDA) dhe urbanizimit (IPDU) dhe indeksi i decentralizimit fiskal (IDF). Për caktimin e këtyre indekseve në secilën fushë përdoret metodologji e dizajnuar paraprakisht¹, sipas të cilës indekset përkatëse fitohen nga katër nën-indekse, të cilat më tutje kalkulohen me anë të treguesve të shumtë për secilin nën-indeks në veçanti. Shkurtimisht, caktimin e këtyre indekseve e shoqëron procesi i prezantuar në figurën më poshtë ndërsa duhet të merret parasysh fakti që gjithë indekset, nën-indekset dhe treguesit janë të vlerësuar sërish sipas peshës, d.m.th. të gjithë ata marrin pjesë me peshë të njëjtë (rëndësi) gjatë caktimit të indeksit të plotë të decentralizimit.



1 Për informata më të hollësishme dhe qasjen metodologjike dhe metodologjinë e shfrytëzuar gjatë hulumtimit mund të konsultoni “Raporti për Vëzhgimin e Procesit të Decentralizimit: Performanca të komunave në RM 2008-2009”, FIOOM (2010) në gjuhën maqedonishte, shqipe dhe anglishte në ueb faqen <http://www.soros.org/default.asp?lang=mk&menuid=430>



Sërish dëshirojmë të theksojmë që parimi kryesor gjatë këtij monitorimi është objektiviteti. Për të arritur nivelin maksimal të objektivitetit gjatë hulumtimit, ishin ndërmarrë hapat në vijim:

- ▶ Grumbullimi dhe sigurimi i të dhënave primare është bërë me anë të anketës të zbatuar në 12 partner komunat, me plotësimin e pyetësorëve nga nëpunësit përgjegjës shtetëror të gjitha fushave të hulumtuara;
- ▶ Vlerësimi i vlerës së treguesve bëhet me krahasimin e gjendjes së konstatuar dhe kriterëve të përcaktuar sipas standardeve ligjore ose vlerave mesatare²;
- ▶ Indekset dhe nën-indekset për secilën komunë dhe fishë kalkulohe me anë të formulave ekzakte matematike të cilat rezultojnë me notimin sasior për nivelin e performancave të komunave në fushat përkatëse;
- ▶ Përveç kësaj, ishte organizuar edhe një punëtori treditëshe në të cilën kanë marrë pjesë nëpunësit përgjegjës komunal/ekspertë për financa, arsim dhe urbanizëm gjatë së cilës ishin analizuar bashkërisht metodologjia, kriteret, zbulimet dhe rekomandimet nga monitorimi;

2 Kriteret që janë përdorur për notimin e secilit prej treguesve në kuadër të nën-indekseve për fushat financa, arsim dhe urbanizëm janë dhënë në Aneksët 1, 2 dhe 3 në këtë raport.

- ▶ Një pjesë e madhe e të dhënave që kërkoheshin me anë të pyetësorëve, posaçërisht pjesa e financave lokale, ishin zbatuar me të dhënat zyrtare të publikuar me bilancin përfundimtar dhe raportet tjera vjetore të komunave;
- ▶ Ishin përdorur edhe burime plotësuese të të dhënave: rregullore ligjore, lajmëtar zyrtar të komunave, tregues statistikor dhe analiza etj.

Sipas rregullores ekzistuese ligjore të gjitha komunat në Republikën e Maqedonisë janë njëlloj, d.m.th të gjithë janë njësoj përgjegjës për plotësimin e obligimeve të transferuara si kompetenca, pa dallim nga madhësia e tyre, kapaciteti (administrativ, financiar, teknik etj) dhe parakushtet ekzistuese për plotësimin e kompetencave të transferuara. Për këtë, raporti në një pjesë fokusohet në analizën e zbatimit të decentralizimit nga ana e komunave urbane, rurale dhe komunat e Qytetit të Shkupit.³

Pas prezantimit të konstatimeve kyçe (kryesore) nga hulumtimi, vijon analiza e temave që kanë qenë të rëndësishme për decentralizimin në tre fushat gjatë vitit 2011. Në tre kapitujt vijues janë dhënë rezultatet e hollësishme dhe analiza të rezultateve sipas fushave në nivel të nën-indeksit dhe treguesve në tre fushat e përfshira me hulumtimin. Rekomandohet që para leximit të raportit, të interesuarit të marrin parasysh “Raporti mbi Ndjekjen e Procesit të Decentralizimit: Performanca të komunave në RM 2008-2009”, FIShH (2010)⁴, ku më hollësisht është sqaruar metodologjia e vëzhgimit dhe janë dhënë kriteret për vlerësimin e performancave.

Ky raport është hartuar në kuadër të projektit “Decentralizim Transparent dhe Efikas” e cila ka për qëllim një proces të hapur, efikas dhe transparent të zbatimit të decentralizimit nëpërmjet vëzhgimit, lajmërimit dhe informimit publik për përcjelljen dhe ekzekutimin e ingerencave të komunave në fushat: financa, arsim, urbanizëm dhe planifikim urbanistik, zhvillim lokal dhe rajonal dhe veprimtari komunale. Në kuadër të projektit, gjithashtu do të bëhet edhe hulumtim në teren për matjen e kënaqësisë së qytetareve për shërbimet e ofruara nga pushtetet lokale dhe do të bëhet një analizë krahasuese të trendit të kënaqësisë së qytetarëve nga shërbimet në nivel lokal për periudhën 2008-2011. Prej të gjitha fushave, theks të posaçëm do të vendoset në transparencën dhe përgjegjshmërinë e komunës gjatë dhënies së shërbimeve. Projektin e zbaton Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni (FSHHM) në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim të Demokracisë Lokale (QZHDL) në 12 partner komuna⁵, në periudhën gjatë 2008 - 2012.

3 Prej dymbëdhjetë partner komuna, 3 janë rurale, 8 janë urbane ndërsa një është e Qytetit të Shkupit.


4 I gatshëm në gjuhën maqedonishte dhe shqipe <http://www.soros.org.mk/default.asp?lang=mk&menuid=430>, si dhe në gjuhën angleze në http://soros.org.mk/dokumenti/sleden-je_decentralizacija_eng_web.pdf

5 Bogovinë, Veles, Gostivar, Dibër, Ilinden, Karposh, Kumanovë, Negotinë, Ohër, Staro Nagoriçanë, Strumicë dhe Tetovë

Konstatimet kyçe

Sipas rezultateve të fituara, konstatimi i përgjithshëm është se decentralizimi në Republikën e Maqedonisë gjatë vitit 2011 e mban nivelin e vitit 2010, ndërsa në periudhën 2008-2011 ka shënuar një përparim të vogël. Indeksi i Decentralizimi në dymbëdhjetë komunat e analizuara në periudhën prej 4 viteve (2008-2011) mesatarisht është rritur në masë minimale (për rreth 3%), që nuk lejon të konstatohet përparim në procesin e decentralizimit në Republikën e Maqedonisë, ndërsa duke marrë parasysh fantin që nuk është shënuar trend negativ, mund lirisht të konstatohet se **procesi i decentralizimit në periudhën 2008-2011 është në stagnacion**. Më poshtë janë dhënë pasqyrë tabelë dhe grafike të indekseve të decentralizimit në fushat financa, arsim dhe urbanizëm:

12 komuna					
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	2008	2009	2010	2011
1. Financa	50%	2,96	2,81	2,99	2,97
2. Arsime	25%	3,39	3,49	3,52	3,67
3. Urbanizëm	25%	3,12	3,05	3,24	3,24
Indeksi i plotë i decentralizimit në RM		3,11	3,04	3,19	3,21



Gjatë vitit 2011, rritje e vetme e indeksit për dallim nga viti 2010 ka në arsim, në urbanizëm vlera e indeksit është e njëjtë në dy vitet, ndërsa në decentralizimin fiskal shënohet ulje e vogël e indeksit.

Analiza e rezultateve në procesin e decentralizimit në tre fushat e analizuara sipas llojit të komunave (urbane, rurale dhe komuna të qytetit të Shkupit) për periudhën 2008-2011 janë prezantuar në tabelën më poshtë:

		2008			
Indeks i performancave	Faktori i peshës	Urbane	Rurale	K. në SK	RM
1. Financa	50%	2,96	2,75	4,26	2,96
2. Arsimit	25%	3,52	3,00	3,48	3,39
3. Urbanizëm	25%	3,16	2,95	3,23	3,12
Indeksi i përgjithshëm		3,15	2,86	3,81	3,11
		2009			
Indeks i performancave	Faktori i peshës	Urbane	Rurale	K. në SK	RM
1. Financa	50%	2,82	2,65	3,91	2,81
2. Arsimit	25%	3,56	3,25	3,65	3,49
3. Urbanizëm	25%	3,07	2,82	3,51	3,05
Indeksi i përgjithshëm		3,07	2,85	3,75	3,04
		2010			
Indeks i performancave	Faktori i peshës	Urbane	Rurale	K. në SK	RM
1. Financa	50%	2,95	2,78	4,26	2,99
2. Arsimit	25%	3,56	3,53	3,18	3,52
3. Urbanizëm	25%	3,19	3,12	3,97	3,24
Indeksi i përgjithshëm		3,16	3,05	3,92	3,19
		2011			
Indeks i performancave	Faktori i peshës	Urbane	Rurale	K. në SK	RM
1. Financa	50%	3,02	2,69	4,04	2,97
2. Arsimit	25%	3,65	3,51	4,20	3,67
3. Urbanizëm	25%	3,43	3,24	3,96	3,24
Indeksi i përgjithshëm		3,28	3,04	4,06	3,21

Në gjitha vitet e analizuara, **performanca më të mira në decentralizimin tregojnë komunat e Qytetit të Shkupit, ndërsa arritje më të dobëta kanë komunat rurale.**

Në lidhje me decentralizimin fiskal, në gjitha llojet e komunave nuk ka përparim të dukshëm dhe mund lirisht të theksohet se në vitin 2011 situata mesatarisht është pothuaj identike me atë të vitit 2008. Megjithatë, duhet theksuar së paku dy fakte: (1) komuna e Qytetit të Shkupit ka performanca më të mira fiskale nga komunat urbane dhe dukshëm performanca më të mira financiare nga komunat rurale; (2) në periudhën 2008-2011, komunat urbane kanë rritje të vogël të performancave financiare, ndërsa komunat rurale kanë dukshëm rezultate më të dobëta dhe ulje të performancave financiare.

Në lidhje me arsimin, për të theksuar është fakti që prej vitit 2008 deri 2011, të gjitha komunat kanë rritje të performancave. Komunat rurale kanë realizuar më tepër përparim në fushën e arsimit, ndërsa komunat urbane kanë përparim të padukshëm. Kjo tregon për faktin se decentralizimi në arsim i jep efektet e duhur në kuptim të sigurimit të shërbimeve të barabarta dhe të përmirësuara, para së gjithash në arsimin fillor, në komunat rurale. Për të theksuar është edhe përparimi i performancave të arsimit në komunën e Shkupit për periudhën 2010 - 2011.⁶

Në pjesën e urbanizimi, për dallim nga arsimi, përparim më të dukshëm kanë arritur komunat e Shkupit, pastaj komunat rurale dhe përmirësim më të vogël është hasur në komunat urbane.

Këtu duhet të theksohet fakti që mesatarja e komunave rurale në gjitha fushat është rritur falë një komune rurale (Ilinden) e cila me gjitha parametrat ka përparime më të mira në krahasim me komunat tjera rurale, ndërsa në pjesën financiare, arritje më të mëdha ka pasur madje dhe nga komunat urbane. Andaj, mund të përfundohet që rezultatet mesatare të komunave rurale janë dukshëm më të dobët sesa mesatarja e komunave urbane dhe komunat e Shkupit.

Më poshtë janë dhënë disa konkluzione konkrete në bazë të rezultateve nga hulumtimi i vitit 2011. Ndonëse me këtë hulumtim kompletohet një cikël i vëzhgimit katërvjeçar i decentralizimit, sërish **konstatohet se prej vitit në vit nuk ka ndryshime të dukshme në fushat e analizuara, andaj konkluzionet e dhëna në gjitha fushat janë kryesisht të ngjashme me ata prej viteve paraprake.** Të dhënat sugjerojnë se ka nevojë për më tepër përpjekje për të siguruar zbatim më të shpejtë dhe më cilësor të decentralizimit në Republikën e Maqedonisë.

Financa

Konkluzioni i përgjithshëm që mund të nxirret në lidhje me decentralizimin fiskal e vëzhguar për periudhën 2008-2011 është se nuk ka përparim, d.m.th. decentralizimi fiskal në vitin 2011 është pothuaj se në nivelin e njëjtë të vitit 2008.

6 Duhet pasur parasysh që komunat në Shkup kanë kompetenca vetëm në arsimin fillor.

Konkluzione konkrete:

- Në vitin 2011, komunat e analizuara ose pushteti lokal, mesatarisht ka harxhuar rreth 7 herë më pak të holla për banor në krahasim me shtetin ose pushtetin qendror.
- Në vitin 2011 Komunat kanë mundur pavarësisht të vendosin për harxhimin e rreth 35% të mjeteve të përgjithshme nga buxheti komunal ndërsa për 75% tjerat, komunat kanë qenë vetëm një lloj “orientuesit” ose vetëm kanë ridrejtuar mjetet financiare në institucionet përkatëse.
- Ndonëse ka tendencë për rritje, komunat ende nuk mund pavarësisht të vendosin për lartësinë e tarifave dhe kompensimeve për rreth 75% të të hyrave në buxhetet komunale.
- Gjatë katër viteve të fundit vazhdimisht zvogëlohet shuma e fituar nga transferimet për komunat të cilat munden vetë të vendosin si do të harxhohen ato, ose mjete të fituara nga transferimet bëhen *de facto* një lloj “të dedikuara”, ndonëse *de facto* një pjesë e tyre janë bllok dotacione.
- Rreth 85% të buxhetit të përgjithshëm nga komunat e analizuara, mesatarisht, harxhohen për shpenzime aktuale dhe shpenzime për roga dhe kontribute ndërsa vetëm 15% janë synuar për investime kapitale. Kjo përqindje me ndryshime të vogla është identike gjatë gjithë periudhës së analizuar 2008 deri 2011.
- Komunat gjithnjë e më tepër investojnë mjete vetjake plotësuese për financim të programeve komunale që paraqet një indikator i mirë për procesin e decentralizimit, sepse në këtë mënyrë zvogëlohet varshmëria financiare nga pushteti qendror. Mirëpo, duhet të merret parasysh fakti që jo gjitha komunat kanë mundësi të ndajnë mjete të dukshme vetjake për financim të ingerencave lokale, dhe ende për numrin më të madh të komunave, transferimet nga pushteti qendror janë burimi i kryesor (diku edhe i vetëm) i financimit të kompetencave të deleguara.
- Duke marrë parasysh bilancet pozitive financiare, mund të thuhet se komunat mirë i planifikojnë të hyrat dhe shpenzimet, gjegjësisht kapacitetet fiskale të komunave për planifikim dhe menaxhim me financa lokale shënon trend të përmirësimit.
- Komunat e analizuara gjatë vitit 2011, mesatarisht kanë investuar pesë herë më pak në investime kapitale për dallim nga shtetit dhe shënohet trend i komunave që gjithnjë e më pak të marrin pjesë në investime kapitale. Përveç kësaj, ekziston një pabarazi e madhe mes investimeve kapitale në vetë komunat, që lëviz prej 10.040 denarë/banor (Ilinden) ose 90%, deri 553 denarë/banor (Bogovinë) ose vetëm 5%, në krahasim me shumën e shpenzimeve kapitale nga buxheti i RM-së.

- Ndonëse në vitin 2011 shënohet trend i pjesëmarrjes së rritur të shpenzimeve zhvillimore për dallim nga vitet paraprake, sërisht komunat kanë shumë pak mjete financiare për realizimin e nevojave zhvillimore (rreth 25%), ndërsa pjesa më e madhe e buxhetit shpenzohet në plotësimin e nevojave aktuale operative-administrative (75%).
- Në të ardhurat e buxheteve komunale, gjatë gjitha viteve të analizuara rol dominues kanë transferimet, por gjithashtu, jo gjitha kumat kanë mundësi të zmadhojnë të ardhurat e tyre. Prandaj, pjesë më e madhe e komunave, më saktësisht komunat rurale dhe disa komuna urbane, ende janë shumë të varur financiarisht nga pushteti qendror.
- Në vitin 2011, të ardhurat e përgjithshme për kokë banorë në komunat ka qenë 11.835 mkd/b dhe në vlerë absolute është shumë më e vogël sesa në vitin 2010 (12,110 mkd/b). Në shumën reale, të ardhurat janë ende më të vogla nëse merret parasysh që inflacionit në vitin 2011 ka qenë 3.9%.
- Sipas të dhënave nga hulumtimi jonë, në përgjithësi ka më tepër papunësi në komunat rurale, më e vogël në ato urbane, ndërsa ende më e vogël në qytetin e Shkupit. Sipas Entit për Statistikë, rajoni me papunësi më të madhe është ajo e veri-lindjes (62,8%) ndërsa me papunësi më të vogël është rajoni jug-lindor (11,5%).
- Decentralizimi ende nuk ka sjellë rezultatet e barazimit (rrafshimit) mes komunave. Papunësia më e madhe dhe të hyrat më të ulëta për amvisëri, mesatarisht, janë nëpër komunat rurale, pastaj në urbane ndërsa papunësia më e vogël dhe të hyra më të mëdha për amvisëri ka në komunat e qytetit të Shkupit. Sipas Entit Shtetëror për Statistikë, rajoni me papunësi më të madhe është ajo e veri-lindjes (62,8%) ndërsa me papunësi më të vogël është rajoni jug-lindor (11,5%), ndërsa varfëri më të madhe (48%) ka në komunat rurale, pastaj urbane (40%) dhe varfëria më e vogël është në qytetin e Shkupit (12%).
- Të gjitha komunat sigurojnë forma dhe mënyra për informimin e qytetarëve për të dhëna lidhur me buxhetin dhe bilancin përfundimtar të komunës. Për dallim nga viti 2010, kur vetëm 25% të komunave siguronin më tepër se dy forma të ndryshme të informimit (medie lokale, tribuna publike, ueb faqe, etj), ky numër në vitin 2011 është rritur në 45%. Gjithashtu, 70% të komunave të analizuara, ekzistojnë procedura zyrtare (të miratuara me vendim të Këshillit ose me vendim të kryetarit të komunës) për mënyrën me të cilën qytetarët njoftohen për planifikimin dhe realizimin e buxhetit komunal, ndërsa 50% të komunave sigurojnë së paku dy forma për pjesëmarrje të qytetarëve në krijimin e buxhetit komunal (tribuna publike, mbledhje të qytetarëve, publikim i thirrjeve për parashtrimin e propozimeve, komunikim të drejtpërdrejtë me punonjësit NJVL, Këshillin, etj).
- Në 20% të komunave në kanë caktuar revizor të brendshëm, dhe në përgjithësi komunat nuk i publikojnë raportet nga revizionet e bëra nga Enti për Statistikë

për Revizion në ueb faqet e tyre sepse thonë se të njëjtat janë publikisht të gatshme në ueb faqen e Entit Shtetëror për Revizion.

- Njëlloj sikur në raportet paraprake, e kemi konkluzionin që komunat marrin shumë pak kërkesa për shpalosje të informatave me karakter publik në pjesën e financave, ndërsa parashtrimeve tjera ju është dhënë përgjigje brenda afatit ligjor. Megjithatë, vërehet një dukuri e shmangies së dorëzimit të të dhënave të kërkuara për shkak të zbatimit të parregullt të procedurave formale nga ana e kërkuarëve që sugjeron se komunat përqendrohen në plotësimin e kërkesave ligjore dhe kritereve (qasjeve ligjore), dhe jo parimit të sundimit të mirë.

Arsimi

Konkluzioni i përgjithshëm në pjesën e decentralizimit të arsimit është se prej vitit 2008 deri më 2011 është shënuar një rritje e vogël konstante e indeksit, që tregon për përmirësim konstant të performancave për këtë kompetencë të deleguar.

Konkluzione konkrete:

- Segmenti më i dobët në arsimin është gjendja financiare e komunave, ndërsa më i mirë është situata me organizimin dhe sigurimin e shërbimeve. Mjetet financiare që i marrin komunat për arsim nuk mjaftojnë, veçanërisht në kushte të rritjes së çmimeve të lëndëve energjetike dhe prezantimin e arsimit të mesëm të detyrueshëm.
- Në vitin 2011 të gjitha komunat kanë emëruar përfaqësues të tyre në gjitha këshillat drejtues të shkollave (KD) në territorin e tyre që tregon se gjendja afrohet tërësisht standardeve të caktuara me ligj. Megjithatë dinamika me të cilën kryetari i komunës dhe administrata njoftohen për përmbajtjen e punës së KD-së dallohen. Në përgjithësi njoftimet janë periodike ndërsa vetëm në disa komuna ekziston fuqi e rregullt e njoftimit në çdo seancë të KD-së, që ishte edhe standardi i dëshiruar.
- Në vitin 2011, pothuaj se gjitha komunat e analizuar kanë marrë përgjegjësi për racionalizimin e rrjetit shkollor dhe kanë përgatitur elaborate dhe analiza, mirëpo secila prej tyre ka përparuar individualisht në këtë proces.
- Mbi 75% të komunave të analizuar i plotësojnë kërkesat ligjore për udhëheqjen e regjistrave ndërsa më tepër se 50% vetëm më udhëheqin edhe regjistra plotësues të të dhënave, që tregon se komunat janë të interesuar për zbatim më të suksesshëm të kompetencave të decentralizimit në arsim.
- Komunat - ngadalë por sigurt - po marrin pronësinë mbi objektet shkollore por kjo çështje edhe këtë vit nuk ka qenë prioritare për zgjidhje në nivelin komunal. Mesatarisht, pronësia mbi objektet shkollore është ndërmarrë në 40-60% të objekteve. Sërish, si arsye për këtë gjende theksohen marrëdhëniet

pronësore-juridike dhe të pronësisë së objekteve si dhe në evidencën e paqartë të kadastrës.

- Komunat mirë administrojnë me mjetet e gatshme që i marrin nga dotacioni për arsim, por gjendja nuk është aq e mirë në lidhje me ndarjen e mjeteve vetjake për arsim dhe investime kapitale në fushën e arsimit. Më dobët funksionojnë dotacionet kapitale shtetërore për arsim që zbatohen vetëm në një numër të vogël të komunave.
- Komunat harxhojnë më tepër mjete për arsimin nga ajo që fitojnë nga dotacionet e pushtetit qendror dhe ekziston trend i rritjes së mjeteve personale të shpenzuara për arsimin, që praktikisht do të thotë se nevojat e shkollave po rriten ndërsa mjetet për nevojat e rritura i plotësojnë vetë komunat. Në vitin 2011, mesatarisht komunat e analizuar kanë investuar mjete vetjake në shumë prej 5,61% të dotacioneve (1544 mkd/nxënës). Mirëpo, komunat shumë pak angazhojnë kuadër plotësues mësimor, financuar nga mjetet vetjake të komunave.
- Shpenzimet kapitale në arsim janë të vogla në krahasim me shpenzimet e përgjithshme kapitale në komunat. Në vitin 2011, pjesëmarrja mesatare në shpenzimet kapitale të arsimit në shpenzimet e plota kapitale të komunave ka qenë 5,73% , që është rritje për dallim nga vitet paraprake - 3,84% (2010), 4,2% (2009) dhe 2,1 (2008). Megjithatë, kjo përqindje realisht mund të jetë më e lartë por për arsye të ndryshme, projektet nga arsimi shpeshherë shfaqen në pjesën e programeve për veprimtari komunale ose efikasitet energjetik.
- Pushteti qendror ende investimet kapitale në arsim i drejton në shkollat dhe i shmang komunat dhe me atë nuk e respekton Ligjin për Financim të Njësisve të Vetëqeverisjes Lokale dhe nuk i përcjell dotacionet kapitale në komunat.
- Në vitin 2011, pjesa më e madhe e komunave e kanë respektuar obligimin ligjor dhe vendimet për matjet dhe kriteret e shpërndarjes së mjeteve nga bllok-dotacionet mes shkollave në territorin e komunës që janë sjellë nga Këshillat. Gjegjesisht, mbi 60% të komunave përveç që janë të njoftuar dhe i përdorin normat dhe standardet, kanë bërë analiza që gjendjes në shkollat dhe kanë ndarë mjete për atë qëllim.
- Komunat me sukses e organizojnë transportin falas për nxënësit dhe drurin për ngrohje për shkollat, pa vonesa të mëdha të shërbimit dhe pa ndalje të mësimin. Megjithatë, në vitin 2011, si problem numër 1 në arsimin e decentralizuar u paraqit mungesa e mjeteve financiare për transport. Por, ajo është si konsekuencë e metodologjisë për shpërndarjen e bllok dotacioneve, gjegjesisht problemi bie mbi segmentin e decentralizimit fiskal.
- Mesatarisht, në çdo komunë është punësuar një person që vetëm një pjesë të tij punon për arsim (shpesh është inspektor për arsim) dhe në përgjithësi komunat janë të dobëta në lidhje me planifikimin strategjik për zhvillimin e arsimit.

- Në vitin 2011 është përmirësuar transparenca dhe mesatarisht komunat përdorin deri më katër mënyra të informimit të qytetarëve mbi arsimin; në disa komuna organizohen takime mes udhëheqjes komunale dhe përfaqësuesit e bordeve shkollore, por shpeshherë organizohen takime me shoqatat e qytetarëve për tema lidhur me arsimin dhe bëhet në nivel vjetor.
- Të gjitha komunat sigurojnë forma dhe mënyra për informimin e qytetarëve me të dhëna lidhur me arsimin dhe të njëjtat shpeshherë i publikojnë në shtypin zyrtar, dhe më rrallë në ueb faqet e komunave dhe/ose shkollave. Megjithatë, ende raportet e vetëvlerësimit të shkollave nuk publikohen në ueb faqet e asnjë prej komunave, që nuk është në përputhje me dispozitat ligjore.

Urbanizëm

- **Komunat kanë nevojë për thjeshtësim të mëtutjeshëm të procedurave për dhënie të pajtimeve për dokumentimin urbanistik**

Duhet që ministritë të lëshojnë pëlqimet në periudhë më të shkurtë, duke respektuar afatet ligjore, si dhe më shpejtë dhe më konkretisht të japin vërejtje për procesin e hartimit dhe sjelljes së planeve urbanistike.

Komunat e analizuar janë të mendimit se pëlqimi përfundimtar për planet urbanistike nga MTV të jepen vetëm me procedurën e sjelljes së planeve urbanistike, dhe mos të kalohet në përmbajtjen e planeve urbanistike.

- **Komunat kanë nevojë për decentralizim të mëtutjeshëm të planifikimit urbanistik**

Planifikimi urbanistik ende është tepër i centralizuar dhe duhet të vazhdohet me decentralizimin e mëtutjeshëm. Komunat duhet të marrin më tepër pavarësi gjatë planifikimit, ndërsa organet shtetërore duhet t'i mbrojnë interesat shtetërore, aspektin kushtetues dhe ligjshmërinë.

Vetëm 15% të komunave të analizuar mendojnë që rregulloret ekzistuese ligjore mbi urbanizmin dhe planifikimin urbanistik në vitin 2011 kanë mundur 100% të implementohen nga komunat ndërsa tjerët 85% mendojnë që kjo ka qenë e pamundshme për 75% të rregulloreve ligjore. Kjo është pasojë e ndryshimit të shpeshtë të ligjeve dhe akteve nënligjore të cilat nuk janë të përmbyllura dhe pajtuara tërësisht, si rezultat i kësaj krijohen pasiguri ligjore dhe pamundësi për implementimin e përgjysmuar të ingerencave.

- **Komunat nuk janë në mundësi tërësisht të zbatojnë ingerencën (p.sh. të hartojnë dhe realizojnë plane urbanistike) për shkak të nivelit të ulët të decentralizimit fiskal dhe mjetet e pamjaftueshme për nevoja zhvillimore.**

Ndonëse në vitin 2011, në përqindje të madhe prej rreth 90%, komunat e analizuara pavarësisht e financojnë hartimin e PU-ve, të gjitha komunat kanë nevojë për mjete të rëndësishme financiare për financim të hartimit të dokumentimit urbanistik.

Veçanërisht, të gjitha komunat edhe në vitin 2011 kanë nevoja të shumta për rritjen e mëturjes së sipërfaqes që do të përfshihet me PU-në. Shkaqet pse nuk është përfshirë i gjithë territori i komunës me PU-në është niveli i ulët i kapaciteteve fiskale e komunave për hartimin dhe realizimin e planeve urbanistike.

Kontesti i procedurave për sjelljen e planeve urbanistike kontribuon për përdorimin e mjeteve të parashikuara me buxhetin komunal për këtë qëllim dhe nuk janë realizuar tërësisht.

Gjithashtu, praktika në vend në të cilën kompanitë e licencuara për hartimin e PU-ve i hartojnë dokumentet e planifikimit mbi baza që nuk përputhen me gjendjen faktike, shpien drejt anulimit të planit dhe hartimin e sërishëm të planeve urbanistike në afat më të gjatë dhe imponon nevojën e azhurnimit të tyre të rregullt, që shpien drejt mungesës kronike të mjeteve për hartimin e dokumentimit urbanistik në buxhetet komunale.

- **Komunat nuk i realizojnë tërësisht ingerencat e tyre në pjesën e inspektimit urbanistik dhe ndërtimor.**

Njësoj edhe në vitin 2011, ngjashëm me tre vitet paraprake, komunat e analizuara nuk i kanë realizuar mjetet e parashikuara për rrënimin e objekteve ndërtimore të paligjshme. Në komunat e analizuara sipas të dhënave që janë përpunuar, vetëm rreth 7% të vendimeve të sjella për rrënimin e objekteve ndërtimore të paligjshme janë realizuar. Edhe në vitin 2011, njësoj sikur në tre vitet paraprake, si arsye kryesore theksohet pritja e zbatimit të Ligjit për Veprimin me Objekteve Ndërtimore të Paligjshme me të cilin do të rregullohet statusi i objekteve të paligjshme.

- **Komunat janë efikase dhe efektive në dhënien e shërbimeve të llojllojshme në fushën e caktuar.**

Komunat e analizuara, edhe në 2011 e mbajnë përqindjen e efikasitetit prej rreth 90% të dhënies së vendimeve të rëndësishme dhe pëlqimeve nga fusha e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik, siç janë: Mostër e PU-së, Vendim për Kushte të Vendndodhjes, Leje për Ndërtim, Leje për Përdorim.

- **Komunat kanë nevojë për zhvillimin e kapaciteteve për zbatimin e ingerencës me përdorimin e arritjeve bashkëkohore teknike.**

Analiza tregon se komunat vitin e katërt me rend e kanë rritur vlerën e indikatorit për inovacion gjatë zbatimit të ingerencës, por ende nuk kanë arritur kapacitete të dukshme për zbatimin e kompetencës duke përdorur arritjet bashkëkohore teknike.

- **Komunat kanë sistem të mirë për grumbullimin e informatave kthyesë nga qytetarët dhe formave të organizuara të pjesëmarrjes qytetare në procedurat e sjelljes së PU-së.**

Në vitin 2011, komunat e analizuara kanë mbajtur nivelin e lartë të sistemit për grumbullimin e informatave kthyesë nga qytetarët dhe formave të organizuara të pjesëmarrjes qytetare në procedurat e sjelljes së PU-së, megjithatë është ulur norma e përgjegjshmërisë në punën e fushës së urbanizimit.

- **Numri i informatave të kërkuara me karakter publik nga fusha e urbanizimit edhe në vitin 2011 është i padukshëm.**

1. Me çfarë do të mbahet mend decentralizimi në RM gjatë vitit 2011

1.1 Në RM asnjë të re – decentralizim (fiskal) i centralizuar

Për shumë persona, decentralizimi paraqet bazë për çfarëdo forme të decentralizimit, si një shtete e zhvilluara, ashtu edhe në shtetet që synojnë demokratizimin e shoqërive të tyre. Sistemi i decentralizimit fiskal në Republikën e Maqedonisë formalisht ka filluar të zbatohet me fillimin e procesit të decentralizimit në vitin 2005. Shtatë vite pas fillimit formal të transferimit të ingerencave të reja komunave, si dhe hyrja e pothuaj gjitha komunave në fazën e dytë të decentralizimit fiskal, që njëherë do të thotë edhe rritje të autonomisë fiskale, sërish disa analistë si dhe një numër i madh i kryetarëve të komunave mendojnë se komunat në RM ende janë shumë lart shtetit në kuptim të mundësive dhe të drejtave fiskale (dhe financiare).

Si mbështetje për këtë, më poshtë janë prezantuar disa fakte, zbulime dhe qëndrime të shprehura nga kryetarët e komunave, BNJVL ose shkencëtar të njohur botëror që i njohin financat lokale dhe decentralizimin fiskal në RM. Për shembull, gjatë një mbledhje të përbashkët të Komisionit për Financim pranë BNJVL, Komisioni për ndjekjen dhe Zhvillimin e Sistemit për Financim të Komunave dhe prof. Dr. Andrej Timofeev – profesor i Universitetit Xhorxhija në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e mbajtur më 13 prill 2011, mes tjerash ishte konstatuar që⁷:

- Të hyrat e komunave, që jepen nga pushteti qendror nuk janë të caktuara në pajtim me nevojat e ingerencave të decentralizuara, por jepen në mënyrë arbitrare.
- Ka një dallim të madh mes mundësive financiare të komunave andaj duhet të përpilohet një formulë e qartë për shpërndarjen e mjeteve, që do të pasqyrojë dallimet komunale.
- Njëlloj siç ka dallim mes komunave urbane dhe rurale, gjithashtu ka edhe dallim të madh mes vetë komunave rurale si dhe atyre urbane. Gjatë kësaj, formula sipas të cilës do të bëhet barazimi, duhet të përqendrohet në eliminimin

7 <http://www.zels.org.mk/Default.aspx?id=4db6f977-6789-40d8-8d44-195c0f4d5f39>

e dallimeve por gjithashtu duhet të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse për nevojat e komunave.

- Grantet sektoriale, gjegjësisht bllok dotacionet dhe shpërndarja e tyre duhet gjithashtu të bëhen lëndë e një analize gjithëpërfshirëse.
- **Varshmëria e komunave nga pushteti qendror është enorme.** Ata aspak nuk kanë autonomi dhe Qeveria duhet të mendojë a është koha që ndoshta pushtetet lokale të marrin më tepër autonomi.
- Shkurtimeve e disa fondeve të caktuara dhe dotacioneve, si dhe fondin për rrugë dhe dotacionin për arsim, që kanë ndodhur gjatë dy ose tre viteve të fundit, janë gjithashtu një impakt i madh mbi arkat komunale dhe paraqesin një pengesë të vërtetë gjatë zbatimit të ingerencave të tyre.

Si Komisioni për Financim të NJVL pranë BNJVL mendon për decentralizimin fiskal mund të vërehet nga procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22 mars 2011⁸, në të cilën shkruan:

- Ndonëse vlera nominale e të ardhurave të analizuara tregojnë një rritje të vogël, vërehet qartë se vlerat e njëjta paraqesin të ardhura të zvogëluara në komunën për shkak të rritjes së shpenzimeve të jetës si dhe rritjen e lëndëve energjetike dhe mjeteve tjera.
- Një përqindje e madhe e të ardhurave vijnë nga transferimet, dotacionet dhe donacionet, rreth 63% që është edhe një dëshmi për nivelin e pamjaftueshëm të lirisë dhe decentralizimit dhe varshmërisë së madhe të pushtetit lokal nga ajo qendrore.
- Gjatë dy viteve të fundit, komunat përballohen me probleme të mëdha në menaxhimin e dotacioneve për arsim, nga arsye që nuk e ndjekin trendin e rritjes së çmimeve të resurseve,
- Përzierja e pushtetit qendror në ingerencat e komunave gjithashtu është e papranueshme. Për shembull, me vendim të Qeverisë ishte ndryshuar vlera e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore në 5% nga vlera e rregullt e caktuar nga këshillat komunal, dhe që ka të bëjë me ndërtimin e hoteleve dhe objekteve industriale. I njëjtë është shembulli me uljen e vlerës së tatimit personal, për të cilin Qeverisa morri vendim dhe nuk u mundua në asnjë mënyrë të kompensojë këtë komunave.
- Koncesionet, që janë të ardhura të rëndësishme për komuna të caktuara, kanë vonesë me pagesën e vitit të kaluar, që paraqet një problem i madh për ata që kanë planifikuar atë shumë dhe kanë përcaktuar projekte që duhet të financohen nga burimi në fjalë.
- Komunat ndjehen të padrejtë edhe me ndryshimin e Ligjit mbi Rrugët, me të cilin ju merren shumë mjete financiare. Gjatë dy viteve të fundit, mungesa e

8 <http://www.zels.org.mk/Default.aspx?id=4db6f977-6789-40d8-8d44-195c0f4d5f39>

mjeteve ndjehet shumë, posaçërisht në komunat me sipërfaqe të mëdha, si dhe në komunat në të cilat mbisundon numër i madh i fshatrave dhe lagjeve.

- Investimet kapitale nuk duhet të shpërndahen nga komunat, por duhet urgjentisht dhe me kriteret të përcaktuara në bashkëpunim me BNJVL-në, duhet të transferohen komunave.

Në lidhje me decentralizimin fiskal në RM, viti 2011 do të mbahet mend për dy gjëra të rëndësishme. E para ka të bëjë me prezantimin e obligacionit komunal dhe dhënien e të drejtës komunave për të dhënë obligacione, që kuptohet është një hap i mirë për sigurimin e financave të nevojshme për funksionim dhe zhvillim të komunave, dhe e dyta, që gjithashtu do të ndikojë mbi funksionimin e komunave, është mosplotësimi i obligimit ligjor të pushtetit qendror për transferim të kështit të fundit (dymbëdhjetë) të dotacionit në bazë të TVSH-së.

Ndonëse me të drejtën e dhënies së obligimit, komunat kanë marrë një mekanizëm plotësues për hyrje në borxh, sërish duhet të theksohet që nuk kanë fituar autonomi të rritur financiare, sepse njësoj sikur edhe për llojet tjera të borxhmarrjes, duhet të kërkohet dhe merret pëlqim nga Qeveria e RM-së, dhe duhet marrë mendim pozitiv nga Ministria e Financave paraprakisht. Duhet sërish këtu të parashtrohet pyetja se pse është e nevojshme të merret mendim pozitiv nga Ministria dhe pëlqim nga Qeveria, nëse kriteret për borxhmarrje janë të qarta dhe mirë të përcaktuara? Gjegjësisht, me rregulloren pozitive ligjore është rregulluar se shumica e plotë e borxhit afatgjatë të papaguar përfshirë edhe garancitë, nuk duhet të tejkalojë të ardhurat aktuale-operative të buxhetit nga viti paraprak dhe që pagesa e plotë vjetore e borxhit janë borxhmarrjet afatgjate nuk duhet të tejkalojë 30% të të ardhurave aktuale-operative të buxhetit nga viti paraprak. Përveç kësaj, thuhet se me mjetet nga obligacionit mundësohet realizim të projekteve zhvillimore, përmirësim të gjendjes ekonomike në nivelin lokal dhe dinamizim të aktivitetit ekonomik. Do të thotë se përveç “rregullat e lojës” së përcaktuar (dhe përpjekjet e deklaruara për nxitjen e decentralizimit), fitohet përshtypja se shteti ende më tutje dëshiron të luajë rolin e “Vëllait të Madh” dhe që nuk do të dorëzohet lehtë nga kontrolli (së paku financiar) mbi pushtete lokale.

Pika e dytë me të cilën do të mbahet mend viti 2011, duhet të thuhet se sipas analizës së bërë nga BNJVL, për vitin 2011 është kalkulua një mungesë prej 237 milion denarë në komunat e RM-së në fushat e arsimit, kulturës dhe mbrojtjes sociale ndërsa mungesa më e madhe konstatohet në fushën e arsimit. Për shkak të kësaj, nuk është e qartë përse në vitin 2011 gjitha komunave ju është shkurtuar kësti i fundit në bazë të TVSH-së pa asnjë sqarim ose informatë për këto mjete. Sqarimi i Ministrisë së Financave në lidhje me mungesën e mjeteve në buxhetet komunale, si dhe mospagesa e kështit të dymbëdhjetë nga bllok dotacionet për arsim, kulturë dhe punë sociale dhe pagesa tjera për projekte, ishte se “*ajo me siguri është gjendje faktike, gjegjësisht obligimi i shtetit mbaron me përfundimin e vitit fiskal*”. Problemi

me pagesën e pjesës nga TVSH-ja e synuar për komunat është gjetur edhe në fillim të vitit 2012, gjatë së cilës në tre muajt e parë ishte paguar vetëm një këst, ndërsa shumica e paguar plotësisht nuk ka qenë në pajtim me mjetet e planifikuara dhe sipas metodologjisë së caktuar. Në pajtim me lajmërimet zyrtare nga ana e DAP (Drejtoria për të Ardhura Publike) grumbullimi i të ardhurave ka qenë sipas dinamikës së planifikuar, andaj bëhet i paqartë trendi i shumës së zvogëluar të mjeteve të paguara në bazë të TVSH-së, të cilat për disa komuna janë burim kryesor i rrogave dhe financim të funksioneve themelore. Në komunën e Kumanovës, për shembull, në emër të bllok dotacioneve është konstatuar deficit prej 40 milion denarë, duke mos kalkuluar mungesat për kulturë dhe mbrojtje sociale. Gjatë kësaj nuk janë njehsuar lëvizjet e çmimit të naftës që vazhdimisht rritet. Gjithashtu, pagesa e mjeteve nga Agjencia për Rrugë Shtetërore gjatë vitit 2011 nuk është bërë në tërësi (nuk është bërë pagesa e fundit) dhe ky trend negativ ka vazhduar edhe gjatë tre muajve të parë të vitit 2012. Për shkak të problemeve financiare, Këshilli Drejtues i BNJVL në seancën e mbajtur në mars 2012, ka sjellë disa konkluzione me të cilat kërkohet në afatin më të shkurtë të paguhet mjetet e vonuara nga bllok dotacionet për muajin dhjetor 2011 si dhe pagesa e vonuar e mjeteve për bazën e njëjtë për vitin 2012. E njëjta ishte kërkuar edhe nga Agjencia për Rrugë.

Nga ana tjetër, pushteti qendror ka vërejtje dhe argumente të saja për punën e komunave. Posaqërisht ka vërejtje për një sërë parregullsive gjatë menaxhimit të mjeteve nga bllok dotacionet. Janë vërejtur parregullsi në procedurat për prokurime publike, ku kërkohet transport për periudhë më të gjatë se viti shkollor, paguhet ndërmarrje lokale transporti me shumica më të mëdha se çmimi normal për transport, numër të rritur të mësimdhënësve ndonëse numri i nxënësve zvogëlohet dhe shumë gjëra tjera të cilat do të zvogëlonin përqindjen e mungesës së mjeteve.

A do të mund komunat dhe si do të arrijnë të marrin mjete dhe do të përdorin mundësinë për dhënien e obligacionit komunal, si dhe a do të merr masa pushteti qendror për largimin e parregullsive që i kanë vërejtur gjatë punës së komunave mbetet të shohim gjatë periudhës vijuese.

1.2 Komunitat të “vozitura” me mjetet e transportit shkollor?!

Sipas Ligjeve për Arsim Fillor dhe të Mesëm, nxënësit që jetojnë në distancë më të madhe se 2 km nga shkolla kanë të drejtë për transport falas shkollor⁹. Transporti shkollor është një prej shërbimeve arsimore të decentralizuara dhe komunat pothuaj disa vite me rend kanë për obligim të organizojnë transportin në nivel lokal. Në fazën e parë të decentralizimit fiskal, lëndët për transport transferoheshin me dotacion

⁹ Ligji për Arsim Fillor (Gazeta Zyrtare e R së Maqedonisë, nr. 103/08 prej 19.08.2008), Neni 61

synues për transport shkollor ndërsa me fazën e dytë të decentralizimit, këto mjete ishin pjesë përbërëse e bllok dotacionet për arsim fillor, gjegjësisht të mesëm.

Në kuptimin e transaksioneve, sistemi funksionon shkëlqyeshëm ashtu siç është paramenduar, mirëpo në realitet paraqiten shumë probleme, posaçërisht lidhur me transportin e nxënësve të shkollave të mesme. Problemet rrjedhin nga dy burime: a) shumica e vogël e mjeteve të ndara me bllok dotacionet për arsim që nuk përputhet me çmimin e lëndëve energjetike dhe b) sfidat metodologjike për shpërndarjen e drejtë të mjeteve për transportin e nxënësve.

Problemi u paraqit që me dotacionet e para të synuara për transport që atëherë kishin të bëjnë vetëm me arsimin fillor. Shumë komuna kanë reaguar për shpërndarjen e padrejtë të mjeteve, por atëherë ende nuk konsideroheshin si problem serioz (nga publiku, as Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe as nga komunat). Situata filloi të vështirësohet kur u fillua me arsimin e detyrueshëm të mesëm, dhe ajo posaçërisht ndikoi negativisht tek komunat më të mëdha që janë qendra për arsim të mesme dhe që gravitojnë një numër i madh i nxënësve nga komunat më të vogla. Në fakt transportin e sigurojnë dhe paguajnë shkollat pa dallim a shërbejnë vetëm nxënës nga komunat e tyre ose nxënës nga komunat fqinje për të cilat shpenzimet janë më të larta nga ato të parashikuara nga ana e Ministrisë së Arsimit. Në të vërtetë u bë një dallim i madh mes mjeteve të kalkuluar për një nxënës dhe shpenzimet që duhet realisht të paguhet për transport. Përveç kësaj, shumica e plotë e mjeteve është shumë e vogël – atë komunat e pohojnë shumë vite me rrallë. Më saktësisht, vërejtja e komunave është se mjetet për kryerjen e ingerencës nuk i ndjek rritjet e çmimeve të naftës dhe derivateve të naftës dhe me atë shërbimi për transport rritet që shkakton një problem serioz lidhur me mungesën e mjeteve për transport. Gjatë viteve të fundit jemi dëshmitarë të keqësimit të gjendjes në shumë komuna, ndërsa gjatë vitit 2011 për herë të parë kishte edhe ndërprerje të shërbimit nga transportuesit. Në vazhdim e japim gjendjen shikuar nga disa këndvështrime:

- Që prej nëntor 2010, në qëndrimet e sistematizuara të BNJVL theksohet: *“Sipas informatave na komunat, rritje për kompensimin e transportit kishte vetëm në gjeneratën e parë të shkollës së detyrueshme të mesme, dhe pastaj çdo vit transferoheshin shumica e njerëzve, ndonëse kemi edhe gjeneratë të katërt të nxënësve të shkollave të mesme”*. Në dokumentin e njëjtë, e kanë dhënë konkluzionin: *“Në komunat që kanë më shumë shkolla të mesme, të marrin për qindje plotësuere të bllok dotacioneve. E saktë është se mjetet transferohen sipas numrit të nxënësve, por gjatë kësaj nuk merret parasysh se çfarë është numri i nxënësve që vijnë nga komunat tjera dhe për çfarë distance në kilometra duhet të paguhet. Nxënësit vijnë nga vende të largëta, pjesa më e madhe marrin mjete edhe për transport të kombinuar – mes qyteteve dhe qytetare, ka një numër të madh të nxënësve që vijnë nga rrethina që nuk ka transport të organizuar publik dhe nuk është caktuar nëse duhet të paguhet fëmijët që vijnë*

nga këto rrethina, ndonëse në komunën e tyre e kanë drejtimin e njëjtë arsimor,.... Për gjithë këtë MASH-i duhet të përgatit Rregullore, sipas të cilës komunat do të udhëhiqen gjatë pagesës së mjeteve, por edhe do të caktohet shuma e nevojshme e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të vërteta për transport të nxënësve.“

- Vitin e ardhshëm, në mas, Komisioni për Financim pranë BNJVL sërish ka alarmuar për problemin – në Procesverbalin e seancës së mbajtur më 22.03.2011 theksohet se *“Gjatë dy viteve të fundit, komunat përballohen me probleme më të mëdha gjatë menaxhimit të dotacioneve për arsimin, nga shkak që nuk e ndjekin trendin e rritjes së çmimeve të resurseve”*. Ajo me siguri ka qenë një diskutim që ka paralajmëruar se vije një krizë e vërtetë në financimin e arsimit.
- Në nëntor 2011, problemet e para eskalojnë, posaçërisht theksohen në komunën e Manastirit. Gjegjesisht, sipas një artikulli të Utrinski Vesnik më 16.11.2011, *“Një milion euro fantastike ju ka borxh Ministria e Arsimit transportuesve nga Manastiri. Gjatë dy viteve të fundit, ata me shpenzime të tyre i kanë transportuar nxënësit sepse nga qeveria, në vend të mbulimit të shpenzimeve mujore, prej kohe në kohë kanë marr, siç e quajnë “copëza”*.
- (<http://www.utrinski.com.mk/default.asp?ItemID=E3D77B6607C7D74E8663E7C76F1CF5AD>). Siç mund të vërehet nga artikulli, në atë moment për transportuesit nuk është shumë me rëndësi nëse është Ministria e Arsimit ose komuna organi që paguan dhe këtu nuk bëhet dallim i madh nga ata. Për transportuesit me rëndësi është se nuk janë paguar mbi një milion euro dhe kërcënoheshin me ndërprerjen e transportit. Utrinski sërish shkruan që *“Borxhi i shtetit ndaj transportuesve ka arritur një milion euro, sepse transportojnë fëmijë që jetojnë edhe 50 kilometra distancë nga shkolla. Deri në Manastir çdo ditë udhëtojnë nxënës nga Resnja, Krusheva, Demir Hisar, Novaci, Mogila dhe Prilepi.”* Kryetari i Manastirit ka bërë disa përpjekje të sqarojnë se problemi nuk është i komunës dhe se bëhet fjalë për shpërndarjen e gabuar të mjeteve nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Për burimin e njëjtë, kryetari i Manastirit ka deklaruar: *“Diçka duhet të ndryshohet në formulën e shpërndarjes së të hollave. Tek ne mësojnë edhe nxënës nga komunat fqinje, por ajo nuk gjendet në formulën. Ata fëmijë bëjnë shumë shpenzime për transportuesit. Andaj u paraqit ky problem edhe në Shtip dhe qytete tjera. Kërkojmë ndonjë mënyrë që nëpërmjet BNJVL-së të zgjedhim problemin, të shikohet se cilat janë nevojat e vërteta të transportuesve. Askush nuk dëshiron të ndërpret transportin falas për nxënësit”*.
- Pas disa muajve negociata dhe pazarime, vijoi ndërprerje të shërbimit në mars 2012 kur 11 transportues nga Manastiri anuluan shërbimin e transportit. Sipas njoftimi nga televizioni Telma prej 08.03.2012, autobusët nuk i kanë transportuar nxënësit në shkolla. Për ata, përfaqësuesi i transportuesve ka deklaruar: *“Komuna dhe shkollat nuk e plotësojnë obligimin, gjegjesisht nuk i paguajnë faturat. Transportuesit nuk kanë marrë kompensim për vitin shkollor 2010/2011 dhe gjysmëvjetorin e parë të vitit 2012”* <http://www.time.mk/read/405a28167a>

/c66efd1e8f/index.html). Drejtori i një shkolle lokale në Manastir ka thënë se situata e tillë ka shumë konsekuenca të mëdha për zhvillimin normal të mësimit dhe ka deklaruar: *“Problemi kuptohet se nuk është tek transportuesit, por është bërë një kalkulim i gabuar nga ana e udhëheqësit për financa dhe buxhete në komunën e Manastirit”*.

- Për problemin ishte diskutuar edhe gjatë takimit të Komisionit për Ndjekjen e Sistemit për Financime, gjatë së cilës nga Ministrinë ishte dhënë mendim për palën tjetër, sipas të cilës: *“janë vërejtur shumë parregullsi në procedurat e prokurimit publik, ku kërkohet transport për periudhë më të gjatë se viti shkollor, ku paguhet ndërmarrjeve publike komunale çmim më të lartë se çmimi normal për transport, etj”* (Procesverbal nga takimit të Komisionit).
- Problemi me komunën e Manastirit nuk u zgjedh edhe me përfundimin e vitit shkollor në qershor 2012. Televizioni Telma jep komentimin më 21.05.2012: *“Shumë reagim, proteste, takime, marrëveshje por gjendja ende është në status-kuo, komuna ka borxh, ministria pohon se dotacionet po transferohen, ndërsa transportuesit janë të pakënaqur”*. Mirëpo, Ministri për Arsim për burimin njëjtë ka deklaruar: *“Një pjesë e komunave janë të kënaqur nga dotacionet, madje ju mbesim mjete të cilat i investojnë në procesin arsimor, por fakt është se komunat më të mëdha kanë probleme”*. Duke e pranuar problemin, ministri shprehu mendimin se BNJVL dhe MASH bashkërisht do të gjejnë zgjidhje, por bëri të ditur se shteti nuk do të jetë përgjegjëse për borxhet e bëra paraprakisht
- Më 15.06 2012 Komisioni për Financim pranë BNJVL ka sjellë vendimin: *“Nëse pushteti qendror nuk mund të shërbejë shpenzimet për transport fals për nxënësit e shkollave të mesme, të bëhen ndryshime të lidhur në pjesën e financimit të transportit të nxënësve”* si dhe *“gjatë caktimit të shumës së bllok dotacionet, të vërtetohet një variabël e veçantë që do të ndjek çmimin e vërtetë të energjisë elektrike dhe naftës”*.

Mbetet të shohim si problemet do të zgjidhen gjatë viteve shkollore në vijim.

1.3 Legalizim të objekteve të paligjshme – vazhdim i parregullsisë dhe ndërtimeve në të zezë

Në Raportet për Ndjekjen e Decentralizimit gjatë katër viteve të fundit janë përdorur dy indikatorë tjerë që kanë të bëjnë me:

1. *Tregues 2.4: Kapacitete të komunave për rrënimin e objekteve të paligjshme*
2. *Tregues 3.6: Performanca të inspektimit urbanistik dhe ndërtimor*

Gjatë gjithë periudhës, dy treguesit karakterizohen me vlera të ulëta si dhe vlera të ulëta të notave mesatare të indikatorëve:

INDIKATOR	2008	2009	2010	2011
2.4 Kapacitete të komunave për rrënimin e objekteve të paligjshme	2,33	2,33	2,00	2,00
3.6 Performanca të inspektimit urbanistik dhe ndërtimor	1,83	1,58	1,75	1,00

Gjatë vitit 2011 si arsye kryesore theksohet pritja e zbatimit të Ligjit për Veprim me Objekte të Paligjshme me të cilin do të rregullohet statusi i objekteve të paligjshme ndërsa gjatë tre viteve të kaluara – pritjet nga sjellja e ligjit në fjalë.

Në aspekt të rëndësisë së këtij ligji në zbatimin e tërësishëm të ingerencës, fillimisht për realizimin e dokumentimit urbanistik planifikues dhe rëndësia e zbatimit të saj nuk është vetëm mbi urbanizimin, por edhe shumë ingerenca tjera të cilat do të përmendim gjatë analizimit të zbatimit të deritanishëm të ligjit.

Vetë sjellja e ligjit ishte rrethuar me shumë kundërshtime nga ana e qeverisë, komunitetit ekspert, komunat, mediet dhe vetë qytetarët.

Ligji për ndërtime në të zezë, diskriminim për disa prej kryetarëve të komunave

E shtunë, 22 janar 2011, 17:26

“Procedura për legalizimin e objekteve në të zezë po thjeshtësohet dhe lirohet, por propozim ligji ende mbetet diskriminim, vlerësojnë disa prej kryetarëve të komunave. Me atë nuk janë përfshirë gjitha kategorisë, që do të thotë se ligji nuk do të zgjedh tërësisht problemin e objekteve në të zezë. Shuma, nga ana tjetër, prej një euro për legalizim është shumë e vogël dhe nuk do të mjaftojë që më vonë komunat të bëjnë urbanizim dhe infrastrukturë. Viset rurale kanë probleme me planet urbanistike, nuk kanë kuadrin dhe kohën për zbatimin e ligjit“.

<http://mx.vesti.alfa.mk/default.aspx?mId=37&egId=7&eventId=32891>

Në shkurt 2011 ishte sjellë Ligji për Veprim me Objektet e Paligjshme¹⁰, ndërsa në prill 2011 ishte sjellë edhe Ligji për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit për Veprim me Objektet e Paligjshme¹¹. Ligji është me vlefshmëri prej gjashtë viteve prej ditës së hyrjes në fuqi dhe me atë rregullohen kushtet, mënyra dhe procedura për evidentimin, caktimin e statusit juridik dhe sanksionim të objekteve të paligjshme. Lëndë e ligjit janë objektet e paligjshme që deri në ditën e hyrjes në fundi të ligjit

10 Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 23/11

11 Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 54/11

janë bërë punët ndërtimore dhe instaluese në tërësi dhe të njëjtat paraqesin tërësi ndërtimore dhe funksionale.

Afati për parashtrimin e kërkesës për caktimin e statusit juridik paraqet gjashtë muaj prej ditës së hyrjes së ligjit në fuqi dhe e shënon të a.q. fazën e parë të zbatimit të ligjit. Në afat prej gjashtë muaj nga pranimi i kërkesës për caktimin e statusit juridik të objekteve të paligjshme, gjegjësisht prej ditës së vazhdimit të procedurës nëse është ndërprerë, caktohet nëse janë plotësuar kushtet për përfshirje të objektit të paligjshëm në dokumentimin urbanistik-planifikues dhe jepet pëlqim urbanistik ose merret vendim me të cilën refuzohet caktimi i statusit juridik i objektit të paligjshëm.

Gjatë disa muajve të fundit, në mediet po bëhen analiza dhe prezantohen informata se procesi i legalizimit të objekteve të paligjshme nuk zhvillohet me dinamikën që ishte parashikuar dhe shpresohet.

Më poshtë është dhënë pasqyrë e kërkesave të parashtruara dhe numrin e objekteve të legalizuara në vitin 2011 për 12 komunat e analizuara:

	Kumanovë	Tetovë	Gostivar	Karposh	Strumicë	Veles
Numri i kërkesave të parashtruara për legalizim të objekteve të paligjshme	18.053	7.900	8.641	9.143	9.340	7.864
Numri i objekteve të legalizuara në vitin 2011	1.600	260	731	576	98	205

	Ohër	Bogovinë	Dibër	Negotinë	Ilinden	Staro Nagoriçanë
Numri i kërkesave të parashtruara për legalizim të objekteve të paligjshme	11.093	2.810	2.086	1.999	6.170	2.060
Numri i objekteve të legalizuara në vitin 2011	262	424	146	85	760	70

Me titull Ngeci Legalizimi i Objekteve në të Zezë¹², Zorana Gaxhovska në shënimin prej 20.03.2012 në www.makdenes.org prezanton që “më tepër se 350 mijë qytetarë kanë parashtruar kërkesa për legalizim, por vetëm 12 mijë, ose 3.5 përqind prej tyre kanë marrë vendim për legalizim”.

12 <http://www.makdenes.org/content/article/24521497.html>

Një pjesë e qytetarëve mendojnë se faji është tek komunat që ngadalë përgjigjen aplikacioneve dhe nuk është njësoj sikur në reklamat.

„Njëra tërheq tjetrën, tjera dokumente, shpenzimet nuk janë ashtu siç thanë, 1 euro, ajo tërheq tatimet, mirëpo mendoj se ngecja është sërish në administratën.“

- Qytetar i anketuar

“Problemi kryesor me gjitha ndërtimet në të zeza janë marrëdhëniet pronësore-juridike. Qytetarët kur kanë blerë prona, parcelat e tyre nuk i kanë transferuar në emrin e tyre, andaj prona me vite ende është mbi emrin prej të cilit e kanë blerë pronën“.

- Bekim Murati, kryetar i komunës së Sarajit

„Më tepër kane faj qytetarët, presin afatin e fundit për të parashtruar kërkesën, dhe mos të flasim për dokumente tjera që duhet të dorëzojnë.“

Qytetarët sikur të kanë harruar se pasi të parashtrojnë kërkesë për legalizim të objektit të paligjshëm, duhet të kompletojnë dokumentet tjera, thonë kryetarët e komunave. Ata pohojnë se komunat punon për interesin më të mirë të qytetarëve.

Nënkryetari i BNJVL dhe kryetar i Kumanovës, Zoran Damjanovski, thotë se në komunën e tij kanë arritur 19 mijë kërkesa, por rreth 3 mijë nuk janë të vlefshme – “Shpeshherë janë objekteve që nuk mund të ndryshohen në rrugë, arterie kryesore, etj, ajo është diçka që nuk mund të përshtatet në asnjë mënyrë, as me ndryshimin e planeve rajonale, as me ndryshimin e planeve të hollësishme, andaj legalizimin nuk e marrim parasysh për këtë raste sepse nuk mund të intervenohet nga arsye strategjike“

Megjithatë, parashtrohet pyetja nëse vërtetë siç deklaroi kryetari i Shkupit dhe kryetar i BNJVL-së, Koce Trajanovski se pas zbatimit të këtij ligji nuk do të ketë ndërtime të paligjshme në Republikën e Maqedonisë¹³. Teksti më poshtë e vendos në dyshim këtë pohim:

¹³ <http://www.kirilica.com.mk/vest.asp?id=63379>

Me ligj dhe pa ligj, vazhdon ndërtimi i objekteve në të zezë

Data: 25.06.2012, 15:01

Gjatë vitit 2011, në territorin e Republikës së Maqedonisë janë regjistruar 1.412 objekte të paligjshme, njofton statistika shtetërore.

Ky numër në vitin 2010 ishte 1.630, ndërsa në 2009, 1.818.

Mirëpo, nga këto numra nuk mund të nxirren trende të rritjes ose rënies sepse këtë vit paralelisht vijon edhe procedura për trajtimin e objekteve të paligjshme në pajtim me Ligjin për Veprim me Objektet e Paligjshme.

Prej këtu, një numër i madh i objekteve të paligjshme ishin lëndë e procedurës së dhënë, andaj nuk mund të ndahen. Megjithatë, ajo që tregon këtë numër prej 1.412 objekteve të paligjshme është nga fakti se ndërtimi i tyre vazhdon edhe më tutje.

Sipas llojit të objektit, të paligjshëm janë 368 objekte shtëpiake (26.1%), 304 të zeza, mbindërtime dhe përshtatje (21.5%), 163 objekte afariste (11.5%), 84 garazhe (5.9%), 137 gardhe (9.7%), 14 shkallë (1.0%), 37 tarraca (2.6%), 4 tarraca verore (0.3%), 77 pjergulla (5.5%), 123 objekte të përkohshme (8.7%) dhe 101 objekte ndihmëse (7.2%).

<http://www.libertas.mk/vest/28458/I-so-zakon-i-bez-zakon-prodolzhuva-gradenjeto-divogradbi>

Në fund të përfundojmë se ndalimi i ndërtimeve të paligjshme është një prej sfidave kryesore që gjendet para komunave, para së gjithash për shkak të tendencave në të kaluarën, por edhe sot, që dokumentimi urbanistik dhe rregulloret ligjore të “mbeten vetëm në letër”.

2. Analizë e rezultateve nga decentralizimi fiskal për vitin 2011


2.1 Indeksi i decentralizimit fiskal (IDF)

Indeksi i decentralizimit fiskal (IDF) për periudhën 2008 - 2011 paraqet 2,96 (2008); 2,81 (2009), 2,99 (2010) dhe 2,97 (2011). Mesatarisht, në vitin 2009 kemi ulje për 6% për dallim nga 2008, pastaj 2010 në 2010 është shënuar rritje prej 6,5% për dallim nga 2009, dhe përfundimisht në 2011 sërish kemi ulje prej 1% për dallim nga 2010. **Përfundimi i përgjithshëm që mund të tërhiqet është se në lidhje me decentralizimin fiskal në periudhën 2008 – 2011 nuk ka përparim, d.m.th. decentralizimi fiskal në vitin 2011 është në nivelin e njëjtë prej vitit 2008.** Ndonëse në vitin 2010 kishte një trend pozitiv në për dallim nga viti 2009, sërish analiza e të dhënave fiskale pohoi se ky trend pozitiv nuk është mbajtur edhe në vitin 2011. Nën-indeksat që formojnë IDF-në, faktorët e tyre peshues dhe notat përkatëse për secilin vit prej 2008 deri në 2011, të ndara janë dhënë në tabelën më poshtë:

	Nën-indeks	Faktori i peshës	RM 2008	RM 2009	RM 2010	RM 2011
1.	NI 1: Implementimi i politikave për decentralizim fiskal	28%	2,84	2,64	2,95	2,81
2.	NI 2: Bilanci financiar i NJVL	37%	2,89	2,64	2,91	2,95
3.	NI 3: Gjendja e përgjithshme ekonomike në komunën	21%	2,97	2,97	2,97	3,03
4.	NI 4: Transparencë dhe përgjegjshmëri	14%	3,36	3,36	3,28	3,25
	IDF		2,96	2,81	2,99	2,97

Siç mund të vërehet nga tabela, secili nën-indeks merr pjesë me peshë të ndryshme në formimin e IDF-së ose sipas mendimit të nëpunësve përgjegjës shtetëror dhe kryetarëve të partner komunave, peshë më të madhe dhe rëndësi ka nën-indeksi


për bilancin financiar të NJVL ndërsa më pak e rëndësishme është nën-indeksi për transparencë dhe përgjegjshmëri.



Siç mund të vërehet nga tabela dhe figura zbulimet kryesore nga monitorimi i decentralizimit fiskal gjatë periudhës 2008-2011 mund të përmbliidhen në:


- Ndonëse deri në vitin 2010, nën-indeksi për zbatimin e politikave për decentralizim fiskal ka pasur rritje më të madhe, sërish rezultatet nga viti 2011 ka treguar se ky nën-indeks është zvogëluar madje edhe deri në nivelin e vitit 2008. Kjo ndodh para së gjithash për shkak të uljeve të investimeve kapitale në nivelin lokal, si dhe uljen e ndikimit të komunave mbi transferimet që merren nga pushteti qendror.
- Një përparim i vogël është arritur në kuptim të gjendjes financiare të NJVL, që para së gjithash shkaktohet nga rritja e të ardhura personale të komunave, dhe me atë bëhet rritje të buxhetit të plotë dhe të ardhurat për banor në komunat.
- Analiza e gjendjes së përgjithshme ekonomike për secilën komunë në veçanti (shembull, % e papunësisë, shkalla e varfërisë, të ardhura për amvisëri, PBB/banor, etj), nuk mund të bëhet saktësisht sepse nuk ka të dhëna zyrtare të azhuruara në nivel të komunës sipas të cilës mund të jepet notë e saktë për gjendjen ekonomike të komunave; komunat nuk posedojnë të dhëna të tilla, ndërsa Enti Shtetëror për Statistika siguron vetëm një pjesë të këtyre të dhënave, por më tepër në nivel të rajonit planifikues (statistike).
- Ndonëse notat më të larta janë arritur në lidhje me transparencën dhe përgjegjshmërinë e komunave, ato janë me tendencë të vazhdueshme të uljes gjatë periudhës së analizuar.

Prej 12 komunave të vëzhguara në vitin 2008 - 7 komuna kanë pasur vlerë të ngjashme me IDF, në vitin 2009 dhe 2011, vetëm 2 kanë pasur vlerë të ngjashme me IDF ndërsa në vitin 2010 asnjë komunë nuk ka pasur vlerë të ngjashme me IDF. Si pasqyrë, ajo është prezantuar në figurën më poshtë:



Siç ishte theksuar në raportin paraprak, të dhënat tregojnë se, e para, në kundërshtim me pritjet për decentralizimin fiskal (barazia) e performancave fiskale mes komunave, që është një prej qëllimeve kryesore të decentralizimit fiskal, rezultatet tregojnë që nyja mes komunave “më të pasura” dhe “më të varfra” në periudhën 2008-2011 është rritur. Kjo nuk duhet të kuptohet thjeshtë që komunat e pasura janë bërë me të pasura ndërsa ato të varfërat më të varfër, por që nyja mes tyre është rritur, d.m.th. nëse komunat “më të varfër” kanë rritur performancat e tyre fiskale, paralelisht rritja ka qenë më e madhe në komunat “më të pasura”, dhe e dyta, një numër i madh i komunave mund të gjenden në grupin ku indeksi i decentralizimit fiskal është nën vlerën mesatare, që tregon se nuk ka shpërndarje të barabartë të performancave fiskale mes komunave. Kjo në praktik do të thotë se vlerat mesatare duhet të merren me dozë të madhe të kujdesit, sepse nuk i pasqyrojnë gjitha të vërtetat nëpër komunat në mënyrë të barabartë. Për shembull, vetëm një ose dy komuna që kanë tregues më të mirë për decentralizim fiskal mund dukshëm të rrit vlerën (për shembull, 7 është vlera mesatare e mbledhjes së numrave 8 dhe 6, por edhe 12 me 2).

Në figurën më poshtë në mënyrë grafike janë prezantuar vlerat e indekseve të IDF-së për gjitha 12 komunat në veçanti, edhe atë për periudhën 2008-2011. Qendra tregon vlerën 1 të indeksit, i cili rritet drejt periferisë deri në vlerën maksimale 5:



Siç mund të vërehet nga figura, gjatë gjithë periudhës së analizuar, vijat ndjekin formën e njëjtë, që tregon se decentralizimi fiskal ende nuk ka arritur barazinë e performancave financiare në gjitha komunat (në këtë rast, vijat duhet më tepër të marrin formën e rrethit).

Më poshtë është dhënë një pasqyrë e hollësishme për secilin nën-indeks dhe tregues që e formojnë atë nën-indeks. Njëherë është dhënë përshkrim për secilin prej treguesve dhe pastaj nota mesatare e gjitha komunave për vitin 2011 në pajtim me kriteret e dhëna në Aneksin 1. Gjatë kalkulimit të notave mesatare të nën-indekseve dhe indekseve, si dhe notës mesatare për IDF për 2011, komuna e Ohrit nuk është marrë parasysh sepse komuna edhe gjatë vitit 2011 ende gjendeshe në fazën e parë të decentralizimit fiskal dhe rezultatet financiare janë të pakrahasueshme me komunat tjera.¹⁴

2.2 Nën-indeks i implementimit të politikave

Faktori i peshës së këtij nën-indeksi është 28/100, d.m.th. ky indeks merr pjesë me 28% të vlerës së plotë të IDF-së. Vlerat peshë të secilit prej treguesve që formojnë këtë nën-indeks janë dhënë në figurën më poshtë, prej të cilës vërehet që rëndësi më të madhe (peshë) ka treguesi 1.2, i cili ka të bëjë me pjesëmarrjen e të hyrave në buxhetin themelor në lidhje me të hyrat e përgjithshme të komunës (25%), ndërsa më pak peshë ka treguesi 1.6 (10%), i cili ka të bëjë me pjesëmarrjen e mjeteve vetjake financiare për mbështetje të programeve/fushave (rrugë dhe rrugica, arsim, mbrojtje sociale, zjarrfikës, komunale, kulturë, sport etj).

Vlera e këtij nën-indeksi dhe treguesve që e formojnë, bashkë me vlerat mesatare dhe notat prej gjitha komunave të analizuar për vitin 2011, janë shfaqur në tabelën më poshtë. Gjithashtu, për krahasim janë dhënë edhe vlerat mesatare të secilit prej

¹⁴ Prej 1 janar 2012, komuna e Ohrit ka hyrë në fazën e dytë të decentralizimit, bashkë me komunat e Delçevës, Vinicës, Vraneshnicës dhe Zhelinës që nuk janë partner komuna dhe nuk janë përfshirë në hulumtimin.

treguesve për periudhën 2008-2011. Nota mesatare e këtij nën-indeksi për vitin 2011 është 2,81 dhe është diçka më e vogël për dallim nga viti 2008.

2008		2009		2010		TREGUES / faktori i peshës (%)	2011		
NI 1	nota	NI 1	nota	NI 1	nota		vlera	NI 1	
	3,18		3,09		3,64	1.1. Pjesëmarrje në shpenzimet komunale për shpenzime publike në RM për banor / 11%	3,45	0,15	
	2,45		2,36		2,82	1.2. Pjesëmarrje në të hyrat e buxhetit themelor në lidhje me të hyrat e plota/ 25%	2,45	0,35	
	3,09		3,27		3,45	1.3. Shkalla e autorizimit për vendimmarrje të pavarur / 19%	3,64	0,25	
2,84	3,27	2,64	2,55	2,95	2,09	1.4. Kontrolli lokal për transferimet nga pushteti qendror / 12%	1,91	0,13	2,81
	2,73		2,27		2,64	1.5. Pjesëmarrje në shpenzime kapitale në shpenzime të plota/ 23%	2,36	0,16	
	2,73		2,55		3,36	1.6. Pjesëmarrje me mjete vetjake në financimin e programeve/ fushave (rrugë dhe rrugica, arsim, mbrojtje sociale, zjarrfikës, komunale, kulturë, sport etj) / 10%	3,55	1,81	

Tregues 1.1: Pjesëmarrje në shpenzimet komunale në shpenzimin e plotë publik në RM për banor

Ky tregues pasqyron sa janë shpenzimet e buxhetit komunal për banor në krahasim me shpenzimet e buxhetit të Republikës së Maqedonisë për banor dhe ajo fitohet kur shpenzimet e plota të komunës/banor ndahen me shpenzimet e plota të buxhetit të RM/banor. Sa më e madhe kjo vlerë, aq më e lartë nota për treguesin. Faktori i peshës së saj është 11%.

Në 2010, vlera e këtij treguesi është 0,15 që do të thotë se shpenzimet komunale për banor paraqesin 15% në krahasim me shpenzimet e buxhetit të RM-së për banor. **Në krahasim me vitet paraprake të analizuara, nuk ka ndryshime të mëdha të vlerës së këtij indikatorit dhe ajo lëviz në diapazonin 0.14 – 0.16, që tregon se decentralizimi fiskal në kundërshtim me pritjet, nuk jep rezultate të dukshme duke marrë parasysh se buxheti publik në nivel të shtetit në pjesë të madhe shpenzohet nga pushteti qendror.** Nota mesatare e treguesit për vitin 2011 paraqet 3.45 dhe është më e madhe se vlera mesatare e treguesit në vitin 2008 (3,18) dhe në

2009 (3,09), ndërsa më e vogël nga 2010 (3,64). Do të thotë, **komunat e analizuar ende shpenzojnë 7 herë më pak para për banor në krahasim me shtetin.**

Tregues 1.2. Pjesëmarrje në të hyrat e buxhetit themelor në lidhje me të hyrat e plota

Ky tregues tregon cila pjese e të hyrave të plota të komunave janë të hyra nga buxheti themelor dhe fitohet si relacion i të hyrave në buxhetin themelor dhe të hyrat e plota. Sa më e madhe kjo vlerë, aq më e madhe nota për treguesin. Faktori i peshës së këtij treguesi është 25% dhe është me peshë (rëndësi) më të madhe për caktimin e vlerës së nën-indeksit 1 në IDF.

Në 2011, vlera e këtij treguesi është 0,35, që do të thotë se vetëm 35% të të hyrave të plota të komunës janë të hyra nga buxheti themelor dhe është nivelin e viteve 2008 dhe 2009, d.m.th. 35% (2009) dhe 37% (2008). Sërish, vlera e saj mbetet relativisht e vogël dhe nota përkatëse për këtë tregues për vitin 2011 paraqet 2,45, njësoj sikur në vitin 2008.

Kjo do të thotë se komunat mund vetë të vendosin për shpenzimin e vetëm 35% të mjeteve të përgjithshme në buxhetin komunal, ndërsa për 65% tjera komunat janë një lloj “drejtuesi”, d.m.th. vetëm i drejtojnë mjetet financiare në institucionet përkatëse. Konkluzioni i njëjtte me një dozë saktësie mund të thuhet edhe për gjithë periudhën e analizuar, gjegjësisht vetëm për 35-40% të buxheteve komunale vendosin vetëm komunat si dhe për çfarë qëllimi do të përdoren mjetet.

Tregues 1.3. Shkalla e autorizimit për vendimmarrje të pavarur

Ky tregues tregon sa komuna është e pavarur në caktimin e shumës së tarifave dhe kompensimeve dhe fitohet si shumë e të hyrave për të cilat komuna vetë i cakton tarifat dhe kompensimet/taksat dhe të hyrat e plota të komunës (i gjithë buxheti). Sa më e madhe kjo vlerë, aq më e madhe nota për treguesin. Faktori i peshës së këtij treguesi është 19%.

Vlera e treguesit për vitin 2011 paraqet 0,25, që do të thotë se komunat e analizuar mesatarisht, vetë vendosin dhe caktojnë shumën e kompensimeve/taksave dhe tarifat përkatëse për vetëm 25% prej të hyrave të plota. Vlera e këtij treguesi tregon tendencë të rritjes në krahasim me vitet paraprake, ndërsa paralelisht me atë edhe notat mesatare përkatëse për këtë tregues rriten prej 3,09 (2008), 3,27 (2009), 3,45 (2010) deri 3,64 në 2011.

Megjithatë, Ndonëse ka tendencë të rritjes së vlerës së këtij treguesi, kjo do të thotë se komunat nuk mundën aspak vetë të vendosin për rreth 75% të të hyrave të plota në buxhetet e tyre komunale.

Tregues 1.4. Kontrolli lokal për transferimet nga pushteti qendror

Ky tregues tregon shkallën e pavarësisë së komunës në aspekt të shpenzimit të mjeteve që fitohen nga transferimet prej pushtetit qendror dhe fitohet si relacion i transferimeve në buxhetin themelor dhe transferimet e përgjithshme. Sa më e madhe kjo vlerë, aq më e madhe nota për treguesin. Faktori i peshës së këtij treguesi është 12%.

Në vitin 2011, vlera e treguesit paraqet 0,13, që do të thotë se mesatarisht vetëm 13% të të hyrave të plota nga transferimet janë transferime në buxhetin themelor. Vlera tregon ulje të dukshme për dallim nga viti 2010 (25%), ndërsa prej vitit 2008 e këndej shënon trend të *uljes së vazhdueshme*. Njësoj, edhe nota mesatare e këtij treguesi për vitin 2011 paraqet 1,91 dhe tregon trendin e uljes së këtij treguesi – prej 3,27 (2008), 2,55 (2009) në 2,09 (2010).

Këto të dhëna padyshim tregojnë që gjatë tre viteve të fundit vazhdimisht ulët shumën e fituar nga transferimet për të cilat komunat mund pavarësisht të vendosin si do të shpenzohen, d.m.th., de facto më tepër mjete të fituara nga transferimet bëhen një lloj “synimi” ndonëse de jure pjesa më e madhe e tyre janë bllok-dotacione.

Tregues 1.5. Pjesëmarrje në shpenzime kapitale në shpenzime të plota

Ky tregues tregon sa prej shpenzimeve të plota janë synuar për shpenzime kapitale dhe fitohet si relacion i shpenzimeve kapitale dhe shpenzime të plota. Sa më e madhe kjo vlerë, aq më e madhe nota për treguesin. Faktori i peshës së këtij treguesi është 23%.

Për vitin 2011, vlera e treguesit paraqet 0,16, ose prej buxhetit të plotë të komunave vetëm 16% të mjeteve janë synuar për investime. Kjo përqindje është më e madhe për dallim nga viti 2010 (14%) por më e vogël nga 2008 (19%) dhe 2009 (18%). Njësoj, nota mesatare për 2011 paraqet 2,64 dhe është e ngjashme me vitet paraprake, d.m.th. në 2008 (2,73), 2009 (2,27) dhe 2010 (2,64).

Në praktikë, kjo do të thotë se 85% të buxheteve të plota të komunave të analizuara mesatarisht shpenzohen për shpenzimet aktuale (shpenzime për rroga dhe kontribute, mallra dhe shërbime) ndërsa vetëm rreth 15% janë synuar për investime kapitale. Kjo përqindje me dallime të imëta është identike me gjithë periudhën e analizuar 2008 deri 2011.

Tregues 1.6. Pjesëmarrje me mjete vetjake në financimin e programeve/ fushave

Ky treguesi pasqyron sa prej mjeteve plotësuese vetjake komuna merr pjesë në financimin e programeve të fushave të ndryshme (rrugë dhe rrugica, arsim, mbrojtje sociale, zjarrfikës, komunale, kulturë, sport etj) dhe fitohet si relacion i shpenzimeve

të plota sipas fushave/programeve dhe transferimet e plota nga pushteti qendror për ato fisha/programe. Sa më e madhe kjo vlerë, aq më e madhe nota për treguesin. Faktori i peshës së këtij treguesi është 10%.

Për vitin 2011, vlera e treguesit paraqet 1,81, që nënkupton se komunat kanë investuar 81% mjete plotësuese vetjake në lidhje me mjetet e fituara nga pushteti qendror për financim të programeve nga fushat e ndryshme. Ky investim është dukshëm më i lartë nga 3 vitet paraprake - 41% (2008), 30% (2009) dhe 64% (2010). Nota përkatëse e treguesit për vitin 2011 është 3,55 dhe është më e madhe nga 2008 (2,73), 2009 (2,55) dhe 2010 (3,36).

Investimi i mjeteve plotësuese vetjake më të mëdha për financim të programeve komunale pa dyshim paraqet një tregues të mirë për procesin e decentralizimit sepse në këtë mënyrë komunat janë më pak financiarisht të varur nga pushteti qendror, por duhet të merret parasysh fakti se jo gjithë komunat kanë mundësi të ndajnë mjete vetjake të rëndësishme për financim të ingerencave lokale, dhe sërish për një numër të madh të komunave, transferimet nga pushteti qendror janë burimi kryesor (për disa i vetëm) për financim të kompetencave dhe ingerencave.

2.3 Nën-indeksi i bilancit financiar të NJVL-ve

Faktori peshues për këtë nën-indeks është 37/100, d.m.th. ky nën-indeks merr pjesë me peshë prej 37% të vlerës së plotë të IDF, që nënkupton se sipas mendimeve të nëpunësve përgjegjës shtetërore dhe kryetarët e komunave ky nën-indeks është faktori kryesor për decentralizim fiskal të suksesshëm. Peshat e vlerave të secilit prej treguesve që formojnë këtë nën-indeks janë dhënë në tabelën më poshtë prej të cilës mund të vërehet që rëndësi më të madhe (peshë) ka treguesi 2.3 i cili ka të bëjë me shpenzimet lokale sipas llojit të paragrafit ekonomik (25%) ndërsa më pak peshë ka treguesi 2.6 (10%) që ka të bëjë me të hyrat e NJVL-ve për banorë:

Vlera e këtij nën-indeksi dhe treguesve që e formojnë, bashkë me vlerat mesatare dhe notat prej gjitha komunave të analizuara për vitin 2011, janë shfaqur në tabelën më poshtë. Gjithashtu, për krahasim janë dhënë edhe vlerat mesatare të secilit prej treguesve të viteve 2008 - 2010. Nota mesatare e këtij nën-indeksi për vitin 2011 është 2,95 dhe është më e madhe në krahasim me tre vitet paraprake kur notat kanë qenë 2,89 (2008), 2,64 (2009) dhe 2,91 (2010).

2008		2009		2010		TREGUES / faktori i peshës (%)	2011		
NI 2	nota	NI 2	nota	NI 2	nota		vlera	NI 2	
	1,73		2,09		1,55	2.1. Bilanci financiar vjetor (rezerva) / 12%	2,27	0,01	
	3,82		3,45		3,55	2.2. Shpenzimet kapitale në komunën për banor / 14%	3,45	2.334	
2,89	2,64	2,64	2,00	2,91	2,55	2.3. Shpenzime lokale për lloj të paragrafit ekonomik / 25%	2,36	0,30	2,95
	2,45		2,00		2,45	2.4. Gatishmëria e shpenzimeve operuese / 17%	2,45	0,25	
	3,00		2,91		3,27	2.5. Struktura e të hyrave / 22%	3,36	1,52	
	4,09		4,27		4,55	2.6. Të hyrat e NJVL-ve për banor / 10%	4,45	11.836	

Tregues 2.1: Bilanci financiar vjetor (rezerva)

Ky tregues jep bilancin vjetor të komunës, d.m.th tregon a janë të hyrat të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e komunës. Njehsohet si relacion mes dallimit të të hyrave dhe shpenzimeve të plota dhe shpenzimeve të plota vjetore. Sa më e madhe kjo vlerë, aq më e madhe nota për treguesin. Faktori i peshës së këtij treguesi është 12%.

Në 2011, vlera mesatare e këtij treguesi është 0,01 që do të thotë se komunat mesatarisht kanë pasur rezervë prej 1%, d.m.th., shpenzimet e plota kanë qenë tërësisht të mbuluara me të hyrat që kanë realizuar komunat. Nota përkatëse është 2,27 dhe është më e madhe nga notat në 2008 (1,73), 2009 (2,09) dhe 2010 (1,55). **Duke marrë parasysh që komunat aspak nuk kanë marrë borxh (ose shumë pak) në tregun e kapitalit, kjo do të thotë se janë sjellë “të zotë” dhe mesatarisht shpenzimet kanë qenë mirë të planifikuar dhe tërësisht të mbuluar nga të hyrat e realizuara. Më tutje, duke marrë parasysh bilancin pozitiv, mund të theksohet që komunat në vitin 2011 më mirë kanë planifikuar të hyrat dhe shpenzimet për dallim nga vitet paraprake, gjegjësisht kapacitetet fiskale të komunave për planifikim dhe menaxhim me financat lokale shënon tren të përmirësimit.**

Tregues 2.2: Shpenzimet kapitale në komunën për banor

Ky tregues jep vlerësimin e shumës së investimeve kapitale në komunë për banor. Fitohet si relacion i shpenzimeve të plota kapitale dhe numrit të banorë në komunën. Sa më e madhe kjo vlerë, aq më e madhe nota për treguesin. Faktori i peshës së këtij treguesi është 14%.

Në 2011, vlera mesatare e këtij treguesi është 2.334 denarë/ banor dhe është më i lartë se mesatarja e gjitha tre viteve paraprake kur ka qenë 1.894 denarë/banor (2008) dhe 1.503 (2009) dhe 2.170 (2010). Andaj, nota mesatare e treguesit për 2011 (3,45) është e njëjtë me atë në vitin 2009 (3,45), por më e vogël se në 2008 (3,82) dhe 2010 (3,55). Siç mund të vërehet nga notat, investimet e zmadhuara mesatare kapitale në vitin 2011 nuk do të thotë edhe notë më e madhe e treguesit. Në fakt, rritja e vlerës mesatare të investimeve për kokë banorë ka ndodhë nga fakti që 3 prej komunave të analizuar kanë investime më të mëdha kapitale për banor nga tetë komunat tjera, që dukshëm e zmadhon përqindjen e investimeve por jo edhe notën e plotë të treguesit. Në veçanti, investime më të mëdha kapitale për banor prej 10.040 mkd/banor ka në komunën Ilinden, pastaj në Strumicë (3.263 mkd/banor) dhe Karposh (3.004 mkd/banor). Gjitha komunat tjera janë nën mesataren, ndërsa investimet më të vogla kapitale janë vetëm 553 mkd/banor. Për krahasim, investimet kapitale për banor nga buxheti i RM-së për vitin 2011 janë rreth 11.360 denarë/ banor.

Kjo tregon që komunat e analizuar në vitin 2011, mesatarisht kanë financiar pesë herë më pak mjete për banorë në investime kapitale në krahasim me shtetin. Nëse merret parasysh që gjatë viteve paraprake ky përpjekim ka qenë 1:4, tregon në faktin që investimet kapitale kryesisht financohen nga shtetit, ndërsa komunat marrin pjesë më pak në intime kapitale. Përveç kësaj, ekziston pabarazi e madhe mes investimeve kapitale në vetë komunat që lëviz prej 10.040 denarë/ banorë (Ilinden) ose 90% deri 553 denarë/ banorë (Bogovinë) ose vetëm 5% në krahasim me buxhetin e RM-së.

Tregues 2.3. Shpenzime lokale për lloj të paragrafit ekonomik

Ky tregues prezanton komponentin zhvillimor të komunës ose çfarë pjese e buxhetit shpenzohet për nevojat zhvillimore dhe fitohet si relacion i t.a. paragrafëve shpenzuese zhvillimore (46+47+48) dhe paragrafët për shpenzime operuese-administrative (40+41+42). Sa më e madhe kjo vlerë, aq më e madhe nota për treguesin. Faktori i peshës së këtij treguesi është 25% dhe është me rëndësi më të madhe gjatë caktimit të vlerës së këtij nën-indeksi.

Për vitin 2011, vlera e këtij treguesi është 0,30, që nënkupton se 30% të buxhetit të plotë mund të trajtohet si “zhvillimor” ndërsa pjesa e mbetur të shpenzohet për shpenzime aktuale operuese-administrative. Kjo vlerë është në kuadër të vlerave të matura për vitin 2008 (28%), 2009 (21%) dhe 2010 (26%). Nota mesatare për vitin 2011 është 2,36 dhe mund të krahasohet me notat 2,64 (2008) dhe 2,00 (2009) nga vitet paraprake – 2,64 (2008), 2,00 (2009) 2,55 (2011). Mirëpo, njësoj sikur me treguesin paraprak, komuna Ilinden është e vetmja prej të analizuarave ku paragrafët zhvillimor janë më të mëdha nga shpenzimet aktuale dhe kontribuon dukshëm për përmirësimin e vlerës mesatare dhe notën e këtij treguesi. Për shembull, pa komunën Ilinden, vlera e mesme e treguesit paraqet 0,18, gjegjësisht vetëm 18% të buxhetit komunal është

synuar për zhvillim ndërsa pjesa tjetër është për mbulimin e shpenzimeve aktuale që në fakt paraqesin realitetin në vetëqeverisjen lokale në RM.

Konkluzioni është që mesatarisht shpenzimet zhvillimore në vitin 2011 janë rritur në krahasim me vitet paraprake por mbetet konkluzioni që komunat kanë shumë pak mjete financiare për realizimin e nevojave zhvillimore të komunës (rreth 25%) ndërsa pjesa më e madhe e buxhetit harxhohet në plotësimin e nevojave aktuale operuese-administrative (75%).

Tregues 2.4. Gatishmëria e shpenzimeve operuese

Ky tregues jep përpjesëtimin e të hyrave operuese (tatimore dhe jotatimore) dhe të hyrave të plota të komunave në nivel vjetor. Sa më i lartë përpjesëtimi, aq më e madhe edhe nota për treguesin. Faktori i peshës së këtij treguesi është 17%.

Në 2011, vlera mesatare e këtij treguesi është 0,25, që nënkupton se 25% të të hyrave të plota vijnë nga të hyrat tatimore dhe jotatimore. Vlera është e ngjashme si në vitin 2009 (21%) dhe 2008 (26%) ndërsa është identike me vitin 2010 (25%). Nota përkatëse në vitin 2011 është 2,45 dhe është e njëjtë si në vitin 2008 dhe 2010, dhe pak më e madhe se e vitit 2009 (2,00). Sipas kësaj, konkluzioni është i njëjtë sikur vitet paraprake, gjegjësisht **duke marrë parasysh të hyrat e vogla dhe padukshme kapitale të komunës, rezultatet tregojnë që në të hyrat e buxheteve komunale në gjitha vitet e analizuara rol dominues kanë pasur transferimet dhe me atë komunat kanë varshmëri më të madhe financiare nga pushteti qendror**

Tregues 2.5. Struktura e të hyrave

Ky tregues tregon se çfarë pjese e të hyrave të plota të komunës janë të hyra nga transferimet dhe donacione dhe fitohet si relacion i të hyrave të plota nga transferimet dhe donacionet. Sa më e madhe kjo vlerë, aq më e madhe nota për treguesin. Faktori i peshës së këtij treguesi është 22%.

Për vitin 2011, vlera e treguesit është 1,52 që do të thotë se të hyrat e plota kanë qenë për 52% më të mëdha se transferimet. Kjo përqindje është më e madhe në krahasim me vitin 2008 (43%) dhe 2009 (38%) ndërsa më e vogël prej vitit 2010 (57%). Nga kjo edhe nota mesatare për vitin 2011 paraqet 3,36 dhe është më e madhe prej 2008 (3,00) dhe 2009 (2,91). Rritja e vlerës së këtij treguesi mesatarisht është sinjal i mirë për procesin e decentralizimit sepse sugjeron që komunat kanë filluar vetë të sigurojnë më tepër mjete financiare në buxhetet e tyre dhe me atë të bëhen më pak të varura financiarisht nga pushteti qendror. Megjithatë duhet të përmendet fakti që mesatarja e rritur ka ndodhur për shkak të tre komunave (Ilindeni dhe Karposhi), të cilat kanë arritur të sigurojnë të hyra më të mëdha vetjake në buxhetet e tyre (më të mëdha se shumica e transferimit dhe donacioneve). Mesatarja e komunave tjera lëviz prej 80% (Strumica) deri më vetëm 20% (Staro Ngoriçane).

Sipas kësaj, si konkluzion i përgjithshëm mund të thuhet se jo gjitha komuna kanë mundësi të zmadhojnë të hyrat e tyre dhe pjesa më e madhe e komunave, posaçërisht ato rurale dhe një pjesë e atyre urbane, ende janë financiarisht të varur nga pushtetit qendror. Vetëm komunat nga qytet i Shkupit, një pjesë e komunave urbane dhe një pjesë e komunave rurale janë në mundësi të sigurojnë të hyra plotësuese vetjake.

Tregues 2.6. Të hyrat për banor

Ky tregues jep përpjesëtimin e të hyrave të plota të buxhetit të komunës dhe numrin e banorëve në komunën. Sa më i lartë përpjesëtimi, aq më e madhe edhe nota për treguesin. Faktori i peshës së këtij treguesi është 10%.

Për vitin 2011, vlera e treguesit është 11.836 mkd/ banor në shumë absolute shënon rritje në krahasim me 2010 kur kishte 12.110 denarë/ banor. Kjo ulje, në shumë të vërtetë është ende më e madhe, nëse merret parasysh përqindja e inflacionit prej 3.9% për vitin 2001. Gjegjësish, mund të thuhet se të hyrat reale të komunave për banor në vitin 2011 kanë qenë më vogla për rreth 6.2% në krahasim me vitin 2010, d.m.th. komunat në vitin 2011 kanë në dispozicion më pak mjete financiare nga 2010, por më tepër mjete për dallim nga 2008 dhe 2009. Nga kjo, edhe nota përkatëse për vitin 2011 paraqet 4,45 dhe është më e madhe nga 2008 (4,27) dhe 2009 (4,09), por jo më e vogël se 2010 (4,55).

Si konkluzion, në vitin 2011, komunat jo vetëm në shumë absolute por edhe në shumë reale shënojnë rritje të të hyrave për banorë në krahasim me vitin 2010.

2.4 Nën-indeks i gjendjes së përgjithshme ekonomike në komunën

Faktori i peshës së këtij nën-indeksi është 21/100, d.m.th. ky indeks merr pjesë me 21% të vlerës së plotë të IDF-së. Për njehsimin e saktë të indikatorëve që bëjnë pjesë në këtë nën-indeks duhet të ketë informata të azhuruara sipas komunave për: numrin e amvisërive, numrin e popullatës aktive ekonomike, përqindja e papunësisë dhe përqindja e varfërisë. Duke ditur se nuk ka të dhëna të azhuruara në nivel shtetëror dhe më pak në nivel lokal, analizat për vitet paraprake kanë qenë identike, dhe me atë rezultatet. Për të fituar një pasqyrë më precize për lëvizjen e këtij nën-indeksi në vitin 2011, ishte bërë një përpjekje për të siguruar të dhëna të reja relevante. Gjatë kësaj janë përdorur të dhënat që janë publikuar nga ana e Entit Shtetëror për Statistikë dhe bazohen në: (1) supozim për numrin e popullatës në komunat, (2) përqindja e papunësisë në nivel të tetë rajoneve statistikore; (3) përqindja e varfërisë për vitin 2011 ku komunat janë ndarë në tre kategori – urbane, rurale dhe komunat e qytetit të Shkupit. Të dhënat e fundit të gatshme për numrin e amvisërive në komuna (që është i nevojshëm për njehsim të treguesit 3.3) është nga regjistrimi i vitit 2002,

ndërsa vlerësimi i fundit të numrit të popullatës është prej 30 qershor 2011¹⁵, ndërsa prej shkallën e varfërisë relative, prej korrik 2012¹⁶.

Pesha e vlerave të secilit prej treguesve që formojnë këtë nën-indeks janë dhënë në tabelën më poshtë, nga e cila mund të vërehet që gjitha tre treguesit kanë rëndësi të ngjashme (peshë) por sërish peshë më të madhe (37%) ka treguesi 3.3, që ka të bëjë me të hyrat për amvisëri. Këtu duhet të theksohet që NJVL-të vërtetë kanë shumë pak mundësi dhe kufizime të ndikojnë mbi përmirësimin e gjendjeve që janë përfshirë me treguesit e kësaj fushe dhe që kryesisht varen nga situata e përgjithshme ekonomike në nivel të gjithë shtetit.

Vlerat në këtë nën-indeks dhe treguesit që e formojnë, bashkë me notat përkatëse mesatare nga gjitha komunat e analizuar për periudhën 2008-2011 janë shfaqur në tabelën, ndërsa më poshtë është dhënë përshkrim i detajuar i secilit prej treguesve.

TREGUES / faktori i peshës (%)	2008 - 2010			2011		
	Nota mesatare	Vlera mesatare	NI 3	Nota mesatare	Vlera mesatare	NI 3
3.1. Shkalla e papunësisë / 31%	2,64	0,44		2,82	0,36	
3.2. Shkalla e varfërisë / 32%	2,64	0,39	2,97	2,64	0,40	3,03
3.3. Të hyrat për amvisëri / 37%	3,55	15.123		3,55	15.766	

Tregues 3.1. Shkalla e papunësisë

Ky tregues jep shkallën e papunësisë dhe është kalkuluar si relacion i numrit të personave të papunësuar dhe numrit të plotë të popullatës aktive ekonomikisht.

Shkalla e papunësisë për vitin 2011 në partner komunat e analizuar është 36% dhe është më e madhe se mesatarja në nivel të shtetit, e cila sipas të dhënave zyrtare paraqet 32%. Nota përkatëse mesatare për gjithë partner komunat është vlerësuar në 2,82 dhe është diçka më e madhe se nota e 3 viteve paraprake të analizuar. Për njëhësimin e këtij treguesi janë përdorur të dhënat nga Enti për Statistikë që janë ndarë në nivele të rajoneve (jo sipas komunave), ndërsa pastaj për secilën komunë është dhënë një përqindje përkatëse e papunësisë varësisht nga mesatarja e rajonit ku gjendet komuna. Të dhënat janë pasqyruar në tabelën më poshtë:

15 <http://makstat.stat.gov.mk/pkweb2007bazi/Database/Статистика%20по%20попштини/Население/Процени%20на%20население/Процени%20на%20население.asp>

16 <http://www.stat.gov.mk/pdf/2012/4.1.12.50.pdf>

	2010		
	Përqindja e aktivitetit	Përqindja e papunësisë	
Republika e Maqedonisë	56,90	32,0%	
Rajoni i Vardarit	59,10	37,0%	Negotinë, Veles
Rajoni Lindor	58,60	16,4%	
Rajoni Jugperëndimor	55,50	34,3%	Ohër
Rajoni Juglindor	69,90	11,5%	Strumicë
Rajoni i Pellagonisë	63,80	33,6%	
Rajoni i Pollogut	46,70	30,8%	Dibër, Tetovë, Bogovinë, Gostivar
Rajoni Verilindor	58,30	62,8%	Kumanovë, Staro Nagoriçanë
Rajoni i Shkupit	54,70	33,0%	Karposh, Ilinden

Përqindje të popullatës aktive në moshë prej 15 vjeç dhe më tepër sipas Rajonit, Vitit dhe Përqindjeve.

Burim: Entit për Statistikë e RM-së

Sipas të dhënave nga hulumtimi ynë, në përgjithësi, prej komunave të analizuara, papunësia më e madhe është në ato rurale, pak më e vogël në komunat urbane ndërsa ende më e vogël është në komunat e Shkupit. Sipas Entit për Statistikë, rajoni me papunësi më të madhe është rajoni Verilindor (62,8%) ndërsa me papunësi më të vogël është rajoni Juglindor (11,5%).

Tregues 3.2. Shkalla e varfërisë

Ky tregues jep numrin e popullatës së varfër dhe për caktimin e saj janë përdorur të dhënat zyrtare të Entit për Statistikë për vitin 2011, të cilat për fat të keq nuk janë bërë posaçërisht për çdo komunë, por i grupojnë komunat në tre kategori: rurale, urbane dhe komuna të qytetit të Shkupit, dhe japin vlera mesatare të shkallës së varfërisë sipas llojit të komunës. Sipas këtyre të dhënave, në komunat rurale shkalla e varfërisë paraqet 48%, në ato urbane është 40% dhe në komunat e qytetit të Shkupit është 12,8%. Sipas këtyre të dhënave, nota përkatëse për këtë tregues për vitin 2011 është 2,64 dhe është e njëjtë me notën nga vitet paraprake, siç edhe janë identike përqindjet për varfëri relative në RM për 2010 dhe 2011.

Vlera mesatare e shkallës së varfërisë në komunat e analizuar paraqet 40% dhe është brenda kufirit të vlerës mesatare në RM për komunat rurale.

Tregues 3.3. Të hyrat për amvisëri

Ky tregues jep një kalkulim (jo matje direkte) të vlerës së të hyrave për amvisëri. Gjatë kësaj janë përdorur të dhënat vijuese zyrtare nga Enti Shtetëror për Statistikë, të cilat kanë të bëjnë me numrin e amvisërive (regjistrimi 2002), numrin e të punësuarve dhe rroga mesatare mujore e paguar në RM (dhjetor 2011) e cila ka qenë 21.145 denarë.

Sipas këtyre të dhënave, të hyrat mesatare për amvisëri në komunat e analizuar paraqesin 15.766 denarë dhe janë më të vogla sesa mesatarja në nivel të shtetit. Nota mesatare përkatëse për komunat e analizuar është 3,55.

Sërish, mesatarisht më të vogla janë të hyrat në komunat rurale, më pak të mëdha janë në ato urbane ndërsa më të mëdha të hyrat për amvisëri janë në komunat e qytetit të Shkupit.

2.5 Nën-indeksi i transparencës dhe përgjegjshmërisë

Faktori i peshës së këtij nën-indeksi është 14/100, d.m.th. ky indeks merr pjesë me 14% të vlerës së plotë të IDF-së, që do të thotë se sipas mendimeve të nëpunësve përgjegjës shtetëror dhe kryetarët e partner komunave ky nën-indeksi paraqet faktor më pak i rëndësishëm për decentralizim të suksesshëm fiskal. Peshat e vlerave të secilit prej treguesve që formojnë këtë nën-indeksi janë dhënë në tabelën më poshtë, prej cilës mund të vërehet që rëndësi (peshë) më të madhe ka treguesi 4.1, i cili ka të bëjë me gatishmërinë e informatave për buxhetin dhe bilanci përfundimtar i komunës (39%), ndërsa më pak treguesi 4.3 (29%), i cili ka të bëjë me gatishmërinë e informatave të karakterit publik.

Vlera e këtij nën-indeksi dhe treguesit që formojnë, bashkë me notat përkatëse mesatare prej gjitha komunat e analizuar për periudhën 2008-2011 janë shfaqur në tabelën ndërsa më poshtë janë dhënë përshkrim i detajuar për secilin prej treguesve. Vërehet që prej vitit 2008 e këndeje, në vazhdimësi ulet vlera e nën-indeksit që në përgjithësi tregon për uljen e transparencës dhe përgjegjshmërisë së vetëqeverisjeve lokale në fushën e punëve financiare.



2008 dhe 2009		2010		TREGUES / faktori i peshës (%)	2011	
NI 4	nota	NI 4	nota		nota	NI 4
3,36	3,73		3,27	4.1. Gatishmëria e informatave për buxhetin dhe bilancin përfundimtar të komunës / 39%	3,73	3,25
	2,91	3,28	2,73	4.2. Përgjegjshmëria në punë / 32%	2,91	
	3,36		3,91	4.3. Gatishmëria e informatave me karakter publik / 29%	3,00	

Tregues 4.1. Gatishmëria e informatave për buxhetin dhe bilancin përfundimtar të komunës

Ky tregues në vete përfshin: format dhe mënyrat me të cilat informatat për buxhetin dhe bilancin përfundimtar ju prezantohen qytetarëve, ekzistimi ose mosekzistimi i procedurave zyrtare (të sjella me vendim të Këshillit ose me vendim të kryetarit të komunës) si dhe format për pjesëmarrje të qytetarëve për krijimin e buxhetit komunal.

Sipas gjendjes së konstatuar në partner komunitat dhe kriteret e caktuara paraprakisht për këtë tregues, nota mesatare për komunitat e analizuar për vitin 2011 është 3,73 dhe është në nivel me 2008 dhe 2009, ndërsa është rritur për dallim nga viti 2010. Konkluzionet e përgjithshme për këtë tregues në vitin 2011 si dhe dallimet në lidhje me vitin 2010 janë:

- 1. Të gjitha komunitat sigurojnë forma dhe mënyra për informimin e qytetarëve për të dhëna lidhur me buxhetin dhe bilancin përfundimtar të komunës. Megjithatë, për dallim nga viti 2010, kur tre komuna siguronin më tepër se dy forma të ndryshme të informimit (medie lokale, tribuna publike, ueb faqe, etj), ky numër në vitin 2011 është rritur në pesë komuna ndërsa shtatë tjera sigurojnë në dy ose më pak forma të ndryshme të informimit.**
- 2. Në 8 prej 11 komunave të analizuar, ekzistojnë procedura zyrtare (të miratuara me vendim të Këshillit ose me vendim të kryetarit të komunës) për mënyrën me të cilën qytetarët njoftohen me planifikimin dhe realizimin e buxhetit komunal. Në vitin 2010, numri i komunave që kanë miratuar procedura zyrtare ishte 7, ndërsa në 2008-2009, vetëm 4 komuna kanë pasur procedura zyrtare.**
- 3. Në vitin 2011, 6 prej komunave të analizuar kanë siguruar më tepër se dy forma për pjesëmarrje të qytetarëve në krijimin e buxhetit komunal (tribuna publike, mbledhje të qytetarëve, publikim i dorëzimit të**

propozimeve, komunikim direkt me punonjësit e NJVL, dhe anëtarët e këshillit, etj). Në vitin 2010 vetëm 5 komuna kanë paraqitur se janë siguruar dy ose më tepër forma për pjesëmarrje të qytetarëve në krijimin e buxhetit.

Tregues 4.2. Përgjegjshmëria në punë

Përgjegjshmëria në punë caktohet me anë të shumë të dhënave që përfshijnë: a ka caktuar komuna revizor të brendshëm, a janë caktuar procedura plotësuese zyrtare për revizion të brendshëm financiar si dhe a janë raportet e revizorëve dhe revizionit të jashtëm (Enti Shtetëror për Revizion) të gatshme publikisht (gazetë lokale, internet faqen e komunës, tabela me shpallje, etj.).

Sipas gjendjes së konstatuar dhe kritereve të caktuara paraprakisht për këtë tregues, nota mesatare e gjithë partner komunave për vitin 2011 paraqet 2,91 dhe sërish është më e madhe sesa nota në vitin 2010 (2,73), ndërsa njësoj si 2008 dhe 2009 (2,91). Konkluzionet e përgjithshme për vitin 2010 dhe dallimet në krahasim me 2009 për këtë tregues janë:

- 1. Për dallim nga viti 2008 dhe 2009 kur gjitha 11 komunat kishin caktuar revizor të brendshëm, në vitin 2010 dhe 2011, dy partner komuna kanë deklaruar që nuk kanë revizor të brendshëm. Në 7 prej 9 komuna që kanë revizor të brendshëm ekzistojnë procedura të caktuara dhe vendosur për revizion të brendshëm.**
- 2. Në përgjithësi komunat nuk i publikojnë raportet nga revizionet e bëra nga Enti për Statistikë për Revizion në ueb faqet e tyre sepse thonë se të njëjtat janë publikisht të gatshme në ueb faqen e Entit Shtetëror për Revizion**

Tregues 4.3. Gatishmëria e informatave me karakter publik

Ky tregues cakton shkallën e gatishmërisë së informatave me karakter publik për komunën dhe caktohet në bazë të parametrave vijues: numri i kërkesave të përgjigjur për qasje në informata me karakter publik, a ka qenë komuna lëndë e ESHR gjatë vitit 2008 ose 2009 dhe gatishmëria e dokumenteve nga revizioni financiar prej ESHR-së.

Sipas gjendjes së konstatuar dhe kritereve të caktuara paraprakisht për këtë tregues, nota mesatare e gjithë partner komunave për vitin 2011 paraqet 3,0 dhe shënon ulje në krahasim me vitin 2010 si dhe në krahasim me vitet 2008/2009.

Njëlloj sikur në raportet paraprake, e kemi konkluzionin që komunat marrin shumë pak kërkesa për shpallje të informatave me karakter publik në pjesën e financave, ndërsa parashtimeve tjera ju është dhënë përgjigje brenda afatit ligjor. Megjithatë, vërehet një dukuri e shmangies së dorëzimit të të dhënave

të kërkuara për shkak të zbatimit të parregullt të procedurave formale nga ana e kërkuarëve që sugjerojnë se komunitat përqendrohen në plotësimin e kërkesave ligjore dhe kritereve (qasjeve ligjore), dhe jo parimit të sundimit të mirë.



3. Analiza e rezultateve nga arsimi për vitin 2011

3.1 Indeksi i performancave të decentralizimit në fushën e arsimit (IPDA)

Pothuaj 8 vite me rralë, arsimi fillor dhe i mesëm në Republikën e Maqedonisë zbatohen sipas sistemit të decentralizuar për zbatimin e ingerencë. Të përkujtohem që në vitin 2004 u bë transferimi prej nivelit qendror në atë lokal të funksioneve themelore dhe administrative të shkollave maqedonase, ndërsa në gjysmën e dytë të vitit 2005 komunat i pranuan edhe dotacionet e para synuese për arsim të cilat duheshë patjetër t'i harxhojnë për a) shpenzime për mirëmbajtje të ndërtesave shkollore dhe b) transport të nxënësve nga shkolla fillore. Gjatë viteve në vijim, një nga një duke hyrë në fazën e dytë të decentralizimit fiskal, filluan të pranojnë bllok dotacione që cilat në vete i bashkojnë mjetet e plota që vijojnë komunës përkatëse për kryerjen e ingerencë arsim (fillor dhe të mesëm).


Ky vëzhgim ndërlihdet me matjet e bëra për vitet 2008, 2009 dhe 2010 dhe e ndjek gjendjen në arsim për vitin 2011 me anë të:

- a) Matjes së nivelit të përgjithshëm për kryerjen e ingerencë, shprehur nëpërmjet indeksit të performancave të decentralizimit në arsim – IPDA. Ky indeks, në kuadër të analizës sonë, është matur për secilën nga 12 komunat në veçanti, si IPDO lokal, në bazë të cilës edhe kalkuluar edhe në nivel të RM-së;
- b) Matje të performancave të komunave (dhe ministrive) në kuptim të zbatimit të politikave arsimore, si menaxhojnë mjetet financiare për arsim, me çfarë cilësie e organizojnë dhënieën e shërbimeve arsimore në pajtim me kompetencat e tyre dhe sa gjatë kësaj i respektojnë parimet e transparencës dhe përgjegjshmërisë. Ajo matet me anë të katër nën-indekseve të cilat do t'i sqarojmë më poshtë.


IPDA në nivel të RM-së për vitin 2011 ka qenë 3,67. Për dallim nga viti 2010, IPDA tregon një rritje të vogël prej 0,15 pikë vlere. Me këtë vazhdon trendi i rritjes së IPDA-s prej vitit 2008 deri më sot, por rritja e plotë për këto katër vite është vetëm 0.28 pikë vlere. Gjegjesisht, IPDA në vitin 2008 ishte 3,39, në 2009 ishte 3,49, në 2010 ishte rritur në 3,52, ndërsa në vitin 2011 ka arritur notën 3,67.

Prej 12 komunave të vëzhguara, në vitin 2011, 7 kanë pasur vlerë më të lartë, 3 vlerë më të ulët ndërsa 2 komuna kanë qenë në kuadër të mesatares së IPDA-s, siç është treguar në figurat më poshtë:

1. komunat me sukses të ndryshëm zbatojnë ingerencat në arsim (në vitin 2008 ka ekzistuar barazim relativ mes komunave),
2. është rritur numri i komunave që janë mbi mesataren e indeksit nga ata që janë nën mesataren dhe kjo vërtetohet me faktin që performancat e komunave nën mesataren janë më të dobët për dallim nga ata që janë mbi mesataren.



Në figurën më poshtë janë dhënë vlerat e indekseve të IPDA-së për gjitha 12 komunat në veçanti për periudhën 2008-2011. Qendra tregon vlerën 1 të indeksit, i cili rritet drejt periferisë deri në vlerën maksimale 5.



Nga kjo figurë mund të vërejmë që 7 komuna kanë vlerë mbi mesatare të IPDA-s. Vërejmë se ato janë komunat që kanë më tepër banorë (gjysma e djathtë e rrethit) dhe me atë kanë sistem më të zhvilluar arsimor. Komunat më të vogla, për fat të keq, tregojnë nivel më të ulët të performancave, përveç një komunë rurale e cila sipas nivelit të performancës i tejkalon shumë komuna urbane. Megjithatë, si konkluzion është që ekziston asimetri në lidhje me kapacitetin e udhëheqjes me arsimin, e cila shkon në dobi të komunave më të mëdha.


Siç e theksuam më lartë, IPDA-ja edhe për secilën komunë në veçanti dhe për RM-në është një përmbledhje e treguesve që pasqyrojnë nivelin që kanë arritur komunat në kuptim të zbatimit të politikave për arsim (janë marrë ingerenca dhe obligime ligjore), financimi i arsimit, përpjekjet për avancimin e arsimit, si shërbimi, dhe transparenca dhe përgjegjshmëria. Për secilën nga këto fusha, në pajtim me metodologjinë për këtë vëzhgim, gjendja e incizuar në teren është e njehsuar sipas vlerës në nën-indeksë përkatëse, edhe atë respektivisht:

- ▶ **NI1:** Nën-indeks për zbatimin e politikave për arsim nga ana e komunave
- ▶ **NI 2:** Nën-indeks i udhëheqjes financiare e sistemit lokal arsimor
- ▶ **NI 3:** Nën-indeks i shërbimeve komunale në arsim
- ▶ **NI4:** Nën-indeks i transparencës dhe përgjegjshmërisë në arsim

Në kuptimin metodologjik, secila prej këtyre katër nën-indeksëve njëherë ka qenë i njehsuar veçanërisht për secilën komunë. Pastaj, për secilin nën-indeks ishte njehsuar vlera mesatare për 12 komunat. IPDA-ja e përgjithshme për RM është fituar si përmbledhje e vlerave mesatare të cilave nga këto katër nën-indeksë. Gjatë kësaj, IPDA - si në nivelin lokal ashtu edhe atë kombëtar - nuk është e thjeshtë por një përmbledhje e katër nën-indeksëve, që do të thotë se ata ndryshe ndikojnë mbi vlerën e IPDA-s. Peshat e këtyre ndikimeve të ndryshme të nën-indeksëve janë caktuar sipas anketës që kemi zbatuar me nëpunësit përgjegjës shtetëror dhe kryetarët e partner komunave që kanë qenë pjesë e hulumtimit. Sipas mendimit të tyre, fusha më ndikuese gjatë matjes së performancave në ingerencë arsim duhet të jetë udhëheqja financiare dhe ndikimi është më e fuqishme (32% dhe rezultati përfundimtar varet nga ky nën-indeks). Vijon nën-indeksi për zbatim të politikave, që ka ndikim prej 27%, pastaj nën-indeksi i arsimit si shërbim (me 25%), ndërsa ndikim më të dobët i është dhënë NI4 - nën-indeksit për transparencë dhe përgjegjshmëri. Në tabelën më poshtë i shqyrtojmë vlerat e katër nën-indeksëve përkatëse të IPDA-s për periudhën 2008-2011:

	Nën-indeksë	2008	2009	2010	2011
1.	NI 1: Zbatimi i politikave për arsim nga ana e komunave	3,70	4,00	3,87	3,95
2.	NI 2: Udhëheqja financiare e sistemit lokal arsimor	2,56	2,64	2,75	2,83
3.	NI 3: Performanca të shërbimeve komunale në arsim	3,88	3,88	4,13	4,21
4.	NI 4: Transparenca dhe përgjegjshmëri në arsim	3,73	3,73	3,53	4,05
	IPD Arsim (IPDA)	3,39	3,49	3,52	3,67

Siç mund të vërehet nga tabela dhe figura, notë më të ulët vazhdimisht merr gjendja financiare e NJVL në pjesën e arsimit, ndërsa vlerë më të madhe fitohet për atë si komunat organizohen për të dhënë shërbimet nga fusha e arsimit. Më hollësisht, këtë gjendje kemi pasqyruar në figurën më poshtë:



Gjendja e tillë nuk është befasi për ata që e ndjekin këtë problem sepse komunat gjatë viteve të fundit, si vetë ashtu edhe nëpërmjet BNJVL-së theksojnë se mjetet financiare që i marrin për arsim nuk mjaftojnë, veçanërisht në kushte të rritjes së vazhdueshme të lëndëve energjetike. Në vitin 2011 kjo gjendje eskalon me mosdhënien faktike të kështit të 12-të të bllok dotacionit për arsim, ndërsa tek disa komuna u paraqitën probleme në pjesën e transportit falas për nxënësit e shkollave të mesme dhe fillore. Për shkak të rëndësisë së kësaj situatë, ku raport ka kushtuar mjaft vëmendje ngjarjeve nga kjo fushë.

Gjendja e indikatorëve për arsim në vitin 2011 është dhënë në hollësi në vazhdim. Janë shqyrtuar dhe analizuar gjitha katër nën-indeksat dhe treguesit që i formojnë. Njëherë japim pasqyrë të nën-indeksit, pastaj përshkrim të secilit prej treguesve dhe pastaj notë mesatare nga gjitha komunat, sipas kriterëve të dhëna në Aneksin 2.

3.2. Nën-indeks i zbatimit të politikave për arsim nga ana e komunave

Ky nën-indeks synon të pasqyrojë nivelin në të cilën komunat zbatojnë politikat për arsim të prezantuar me decentralizimin. Për këtë, përbëhet nga një grup i treguesve të zgjedhur me qëllim të pasqyrimin të shkallës së secilës komunë dhe administratës së saj që kanë arritur të zbatojnë ingerencat që ju kanë sjellë ligjet për arsim fillor dhe të mesëm, edhe atë: si komuna i përdor bordet komunale, a ndërmer komuna iniciativa për ndryshimin e rrjetit shkollor, a kanë konstatuar vëzhguesit nga niveli qendror parregullsi gjatë udhëheqjes me sistemin lokal, a udhëheq komuna regjistrat për arsim të parashikuara me ligj dhe a janë transferuar tërësisht objektet shkollore komunave. Sipas analogjisë së IPDA-së, ky nën-indeks është njehsuar si përmbledhje e këtyre indikatorëve. Vlerat peshuese të secilës prej këtyre janë përdorur me Metodologjinë e Vëzhgimit nga vitet paraprake.

Në tabelën më poshtë është dhënë një pasqyrë e gjithë treguesve nga ky nën-indeks dhe pasqyrë e vlerës së mesme për periudhën 2008 - 2011.

TREGUES	2008	2009	2010	2011
1.1. Komuna merr pjesë aktive në punën e bordeve shkollore	4,50	4,67	4,92	4,83
1.2. Komuna ndërmer dhe realizon iniciative për hapje të shkollave të reja dhe mbyllje të atyre ekzistuese	2,42	3,08	2,75	3,58
1.3. Komuna respekton ligjet dhe politikat për arsim fillor	4,42	5,00	4,42	4,50
1.4. Komuna udhëheq dokumentim të drejtë për shkollat e saja, sipas rregullave ligjore	3,58	3,58	3,58	3,17
1.5. Komuna ka marrë pronësinë mbi objektet shkollore	2,83	2,92	3,50	3,25

Vazhdojmë me analizën e secilit indikator në veçanti:

Tregues 1.1. Komuna merr pjesë aktive në punën e bordeve shkollore

Ky tregues tregon në cilën masë të bordeve shkollore është caktuar përfaqësues i komunës dhe cila është dinamika me të cilën kryetari i komunës njoftohet për punën e KD-së.

Vlera mesatare e notës për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2011 ka qenë 4,83. Ajo nënkupton që gjendja po afrohet standardeve të caktuara me ligjin, d.m.th., komunat caktojnë përfaqësues të tyre në Bordet Shkollore dhe mbajnë komunikim të mirë me ata. Në vitin 2011 të gjitha komunat kanë emëruar përfaqësues të tyre në gjitha këshillat drejtues të shkollave (KD) në territorin e tyre. Dallimi në notat mes komunave bëhet për shkak të elementit të dytë të treguesit - dinamika me të cilën kryetari i komunës dhe administrata njoftohen për përmbajtjen e punës së KD-së. Mesatarisht, njoftimet janë periodike ndërsa vetëm në disa komuna ekziston fuqi e rregullt e njoftimit në çdo seancë të KD-së, e cila ishte edhe standardi i dëshiruar.

Tregues 1.2. Komuna ndërmer dhe realizon iniciative për hapje të shkollave të reja dhe mbyllje të atyre ekzistuese

Një prej qëllimeve të transferimit të pronësisë dhe ingerencave të udhëheqjes me shkollat në nivel komuna ishte edhe mendimi që vendimet për rjetin shkollor duhet të merren në nivel lokal. Komuna, pas analizave të ndryshme paraprake dhe pëlqim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), mund të propozojë Këshillit të komunës vendim për themelimin e shkollave të reja ose mbylljen e shkollave të

vjetra ose lëndë/okupacione në arsimin e mesëm. Ky tregues tregon sa komunat në RM kanë praktikuar këtë ingerencë.

Nota mesatare për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2011 është 3,58 që paraqet rritje për dallim nga dy vitet paraprake (2.42 në 2008, 3.08 në 2009 dhe 2.75 në 2010). Kjo rritje ka ndodh për shkak të faktit se pothuaj gjitha komunat e analizuar kanë marrë përgjegjësi dhe veprim për racionalizim të rrjetit shkollor dhe kanë përgatitur elaborate dhe analiza, por secila prej tyre ka përparuar ndryshe në këtë proces.

Tregues 1.3. Komuna respekton ligjet dhe politikat për arsim fillor

Ky tregues është i përgjithshëm që duhet të tregojë në çfarë niveli administrata komunale ka respektuar ligjet dhe zbatimin e ingerencave të marra nga fusha e arsimit. Kjo matet me anë të dhënave se gjatë monitorimit nga Ministria e Arsimit a janë marrë masa të caktuara dhe si zhvillohet komunikimi mes Inspektoratit Shtetëror Arsimit dhe komunës.

Vlera mesatare e notës për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2011 është 4,50. Ministria e Arsimit dhe Shkencës në përgjithësi nuk bënë shumë monitorim mbi punën e administratave komunale, ndërsa aktivitetet kryesore i kryen Inspektorati Shtetëror Arsimit në nivel të shkollave. Gjatë këtij monitorimi, kryesisht merren masa dhe rekomandimet për avancimin e punës.

Mund të përfundohet që komunat i respektojnë ligjet ndërsa komunikimi me Inspektoratin Shtetëror Arsimit është i rregullt dhe në nivel të vulltshëm.

Tregues 1.4. Komuna udhëheq dokumentim të drejtë për shkollat e saja, sipas rregullave ligjore

Ky tregues duhet të jep pasqyrë nëse komuna udhëheq të dhënat për shkollat e tyre në regjistra të caktuar me ligj për arsimin fillor dhe të mesëm, a udhëheq regjistra plotësues dhe me çfarë sistematizimi mirëmban atë. Nota mesatare për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2011 është 3,17. Si konkluzion, mbi 75% të komunave të analizuar i plotësojnë kërkesat ligjore për udhëheqjen e regjistrave ndërsa më tepër se gjysma vetëm më udhëheqin edhe regjistra plotësues të të dhënave.

Tregues 1.5. Komuna ka marrë pronësinë mbi objektet shkollore

Një prej ndryshimeve që ka sjellë decentralizimi është edhe transferimi i pronësisë së objekteve shkollore në emër të komunës. Vendimi për këtë ishte marrë bashkërisht, për gjitha shkollat në Republikën e Maqedonisë, ndërsa secila komunë më tutje ka për obligim objekteve të veçanta të transferojë në emër të tyre nëpërmjet kadastrës. Për arsye të ndryshme, ky proces nuk është lehtë për të zbatuar, andaj ky tregues duhet të tregojë sa komunat kanë qenë të suksesshme në këtë detyrë.

Vlera mesatare e notës për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2011 është 3,25. Në këtë tregues kemi konstatuar përmirësim të gjendjes: në vitin 2008 vlera ka qenë 2,83, në 2009 - 2,92, ndërsa në vitin 2010 - 3, që nënkupton se ngadalë por sigurt komunat marrin pronësinë mbi objektet shkollore. Mesatarisht, pronësia mbi objektet shkollore është ndërmarrë në 40-60% të objekteve. Sërish, si arsye për këtë gjende theksohen marrëdhëniet pronësore-ligjore dhe zotësie mbi objektet si dhe në evidencën e paqartë të kadastrës. Megjithatë, mund të përfundojmë se kjo çështje edhe këtë vit nuk ka qenë prioritet për zgjedhje në nivel komunal.

3.3 Nën-indeks i menaxhimit financiar të sistemit lokal arsimor

Zbatimi i secilës ingerencë, madje edhe e arsimit, mundësohet vetëm nëse është e mbështetur me mjete përkatëse financiare. Me decentralizimin, niveli qendror transferon NJVL-së një shumë të caktuar të mjeteve për arsim në formë të dotacioneve, por njësoj mbetet mundësia e komunës të shpërndajë financa nga burimet vetjake që të përmirësojë performancat në arsim. Përveç shumës së parave që e kanë të dispozicion, me rëndësi të madhe është e mënyra si udhëhiqen këto para, por edhe si kontrollohen shpenzimet lidhur me arsimin. Ky nën-indeks synon të pasqyrojë si komunat tona janë vendosur në kuptim të financimit të shkollave të tyre.

Ky nën-indeks paraqet përzierje të 6 treguesve të cilat duhet të zbulojnë: çfarë është përpjesëtimi i mjeteve të harxhuara për arsim dhe dotacionet e fituara nga niveli qendror; sa është pjesëmarrja me mjete vetjake të komunës në shpenzimet e plota të bëra për arsim, sa është pjesa e shpenzimeve kapitale të komunave të synuara për arsim; sa dotacione kapitale për arsim janë fituar nga niveli qendror në emër dhe dispozicion të komunës; a kanë financuar komunat angazhim të kuadrove plotësues në shkollat dhe sa ka qenë efektive menaxhimi i mjeteve ekzistuese financiare për arsimin. Ndikim relativ në këtë nën-indeks mbi indeksin e plotë IPDA, sipas notimit të pjesëmarrësve në hulumtimin, mbi gjithë indeksin është 32%.

Në tabelën më poshtë kemi një pasqyrë të gjithë treguesve të këtij indeksi dhe vlerën e tyre mesatare për periudhën 2008 - 2011.

TREGUES	2008	2009	2010	2011
2.1. Përpjesëtimi i gjithsej mjeteve të harxhuara në arsim dhe mjeteve të fituara me dotacion nga niveli qendror	3,33	3,17	4,33	4,00
2.2 Pjesëmarrje të mjeteve vetjake komunale në shpenzimet e plota për arsim	2,25	2,33	2,42	2,58
2.3. Shpenzime kapitale të synuar për arsimin	2,08	2,33	2,25	2,58
2.4. Shuma e dotacioneve kapitale për arsim të fituara nga niveli qendror, në emër dhe dispozicion të komunës	1,42	1,33	1,42	1,75
2.5. Kuadro plotësues mësimit financiar nga komunat	1,75	1,92	1,58	1,67
2.6. Menaxhim efektiv financiar i sistemit arsimor lokal	3,67	3,67	4,00	3,92

Nota e nën-indeksit të plotë për gjendjen financiare në arsim sërish është rritur shumë pak në vitin 2011 dhe është 2.83. Komunat mirë i udhëheqin mjetet e gatshme, por gjendja nuk është aq e mirë në kuptim të ndarjes së mjeteve vetjake për arsim dhe investime kapitale në arsim. Më dobët funksionojnë dotacionet shtetërore kapitale për arsim të cilat zbatohen vetëm në disa komuna. Në vazhdim, në hollësi do të analizojmë gjashtë indikatorët të cilët përbëjnë këtë nën-indeks:

Tregues 2.1. Përpjesëtimi i gjithsej mjeteve të harxhuara në arsim dhe mjeteve të fituara me dotacion nga niveli qendror

Ky tregues pasqyron sa mjete për arsim ka harxhuar komuna nga mjetet që i fiton si dotacion nga pushteti qendror. Treguesin e fitojmë kur mjetet e plota të realizuara për arsim të mesëm dhe fillor për secilën komunë i pjesëtojmë me mjetet e plota të fituara nga niveli qendror me bllok-dotacione.

Nota mesatare për vitin 2011 është 4 , që do të thotë se kemi ulje të vlerës së treguesit për dallim nga viti 2010 . Shpenzimi mësimit ka qenë për 11% më tepër nga bllok dotacionet nga shteti. Arsye e mundshme për këtë ulje të indikatorit është mospagesa kësti i 12 për bllok dotacione për arsimin fillor dhe të mesëm për vitin 2011. Sërish mund të përfundojmë që komunat harxhojnë më tepër mjete për arsimin nga ajo që fitojnë nga dotacionet e pushtetit qendror dhe ekziston trend i rritjes së mjeteve personale të shpenzuara për arsimin, që praktikisht do të thotë se nevojat e shkollave po rriten ndërsa mjetet për nevojat e rritura i plotësojnë vetë komunat.

Tregues 2.2. Pjesëmarrje të mjeteve vetjake komunale në shpenzimet e plota për arsim

Ky tregues tregon sa është pjesëmarrja e komunës me mjete financiare nga burime vetjake në financimin e ingerencave në arsim. Fitohet kur mbledhen gjitha mjetet vetjake që komuna ka investuar në arsim (mirëmbajtja, investimet, inventar i imët) për nxënës dhe pjesëtohen me mjetet e realizuara në arsim për nxënës sipas bilancit

përfundimtar të komunës. Sipas kritereve për notim, nota mesatare për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2011 është 2,58, që do të thotë se ka një rritje të vogël për dallim nga viti 2010.

Në vitin 2011 komunat kanë marrë pjesë me mjete vetjake në shpenzimet e plota për arsimin me 5.61%. Shkallë më të lartë të investimit proporcional ka realizuar komuna me 30% investime vetjake për dallim nga shpenzimet e plota për arsim, ndërsa në vlerë nominale investimi më i lartë i mjeteve vetjake ka qenë 8267 denarë për nxënës. Investimi më i ulët ka qenë 182 denarë për nxënës, ndërsa mesatarja është 1544 denarë mjete vetjake për nxënës.

Në vitin 2011 mund të përfundojmë që shumë komuna investojnë me mjete vetjake në arsim por shumica e këtyre mjeteve është shumë e vogël.

Tregues 2.3. Shpenzime kapitale të synuar për arsimin – Përqindja e shpenzimeve të plota kapitale të synuara për investime kapitale në arsim

Nga ky tregues shikojmë sa shpenzime kapitale janë synuar për arsim në krahasim me shpenzimet e plota kapitale të komunës. Njehsimi është bërë kur shpenzimet e plota kapitale për arsimin e mesëm dhe fillor (vetjake ose nëpërmjet dotacioneve kapitale nga MASH) pjesëtohen me shpenzimet e plota komunale.

Vlera mesatare e notave për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2011 është 2,58 e cila është një rritje e vogël për dallim nga viti 2010. Sipas të dhënave nominale në vitin 2011, pjesëmarrja mesatare e shpenzimeve kapitale në arsim në shpenzimet e plota kapitale të komunës ka qenë 5.73%, që është një rritje për dallim nga vitet paraprake – 2010 ka qenë 3,84%, 2009 ishte 4,2%, ndërsa në vitin 2008 kjo përqindje ka qenë 2,1%.

Përqindja më e lartë e shpenzimeve kapitale të synuara për arsim është ndarja prej 23% për investime kapitale në arsim. Megjithatë, në përgjithësi, mund të përfundohet që shpenzimet kapitale në arsim janë të vogla në krahasim me shpenzimet e përgjithshme kapitale në komunat.

Mirëpo, të kujtohem për zbulimin që është bërë me vëzhgimin për vitin 2010 kur gjatë konsultimeve të bëra me përfaqësuesit e administratave komunale, kuptuam se kjo përqindje realisht mund të jetë më e lartë por për arsye të ndryshme, projektet nga arsimi shpeshherë shfaqen në pjesën e programeve për veprimtari komunale ose efikasitet energjetik, që pak e ndryshon pasqyrën për investimet e komunave në shkollat e tyre.

Tregues 2.4. Shuma e dotacioneve kapitale për arsim të fituara nga niveli qendror, në emër dhe dispozicion të komunës

Ky tregues pasqyron në çfarë vëllimi pushteti qendror ka transferuar mjete për investime kapitale në shkollat edhe atë nëpërmjet buxhetit komunal dhe jo drejt nga

niveli qendror në shkollat. Mënyra e tillë e financimit të investimeve kapitale është shumë e rëndësishme për autonominë financiare të komunës dhe për menaxhimin e drejtë dhe zotërimin e investimeve në arsim.

Vlera mesatare e notave për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2011 është 1,75. Vetëm dy komuna kanë fituar mjete për investime kapitale në arsim.

Ajo do të thotë se pushteti qendror ende investimet kapitale në arsim i drejton në shkollat dhe i shmang komunat dhe me atë nuk e respekton Ligjin për Financim të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe nuk i përcjell dotacionet kapitale në komunat, por drejtpërdrejt në shkollat.

Tregues 2.5. Kuadro plotësues mësimor financiar nga komunat

Ndonëse nuk është obligim ligjor, disa komuna, për të rritur cilësinë e arsimit, angazhojnë kuadër plotësues mësimor, të cilin financojnë nga buxheti vetjak. Ajo shpeshherë ndodh për të parandaluar ndërprerjen e procesit mësimor gjatë mungesës së mësimdhënësve të rregullt por edhe të përforcohet procesi mësimor. Ky tregues tregon sa është numri i personave nga kuadri mësimor dhe stafi ndihmues që është i financiar nga komunat. Për të krahasuar të dhënat në nivel të Republikës, nuk është marrë parasysh shuma e mjeteve të angazhuara, por numri absolut i personave të angazhuar, por numri absolut i personave tjerë të angazhuar.

Nga grupi i 12 komunave në vitin 2011, sërish vetëm dy komuna kanë financiar fuqi plotësuese në arsim, ndërsa nota mesatare e këtij treguesi është 1,67.

Në praktikë, kjo do të thotë se angazhimi i kuadrove plotësues mësimor, financiar nga mjetet vetjake të komunës, nuk praktikohet shpesh nga komunat, por sërish është prezent si dukuri.

Tregues 2.6. Menaxhim efektiv financiar i sistemit arsimor lokal

Ky tregues pasqyron nivelin e aftësisë së administratës komunale për menaxhim efektiv me mjetet e arsimit: në çfarë baza shpërndahen dhe transferohen këto mjete, a kujdesen për shpenzimet, etj.

E masim si përmbledhje akumuluese të disa variablave: ekzistimi i vendimit të Këshillit të Komunës për matësit dhe kriteret e shpërndarjes së mjeteve mes shkollave të komunës; vendosja e procedurave lokale për rregullimin e punës dhe planifikimit buxhetor të shkollave; analiza të gjendjeve financiare dhe nevojave të shkollave, të bëra në bazë të treguesve organizues, financiar dhe tjerë; hartimi i elaborateve për racionalizim të shpenzimeve në shkollat dhe transferime me kohë të mjeteve financiare në shkollat.

Vlera mesatare e notave për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2011 është 3,92. Kjo notë tregon që gjendja është e mirë, por sërish evidentohet që

obligimi ligjor për të sjellë vendim të Këshillit për matjes dhe kriteret e shpërndarjes së mjeteve nga bllok-dotacionet mes shkollave në territorin e komunës respektohet, por jo në gjitha komunat.

3.4 Nën-indeksi i shërbimeve komunale në arsim

Të përkujtohemi sërish që edhe arsimit është një shërbim ndaj qytetarëve, për të cilën duhet të kenë standarde të “dërgimit” dhe cilësi. Ky shërbim me decentralizimin sigurohet me përpjekje të përbashkëta – si qendrore ashtu edhe lokale. Nën-indeksi i performancave të shërbimeve në arsim përfshin 4 treguesit vijues: pajisja e shkollave sipas normave dhe standardeve të caktuara për hapësirë dhe pajisje; efektiviteti në sigurimin e transportit të nxënësve falas dhe drunj për shkollat; kapaciteti administrativ i angazhuar për udhëheqjen e arsimit dhe qasja strategjike për udhëheqjen e sistemit dhe shërbimeve arsimore lokale.

Ky nën-indeks ka ndikim relativ mbi indeksin e plotë prej 25%. Ishte hulumtuar bashkë për vitin 2008 dhe 2009, me pyetje cilësore të cilave ju janë përgjigjur nëpunësit shtetëror të intervistuar gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave. Nota mesatare në nivel të Republikës për vitin 2011 është 4,21.

Në tabelën më poshtë kemi një pasqyrë të gjithë treguesve të këtij indeksi dhe vlerën e tyre mesatare për periudhën 2008 – 2011.

TREGUES	2008/2009	2010	2011
3.1. Shkollat pajisen për të plotësuar normat dhe standardet për hapësirë dhe pajisje	3,92	3,83	4,25
3.2. Efektiviteti në sigurimin e transportit falas të nxënësve dhe drunj për shkollat	4,58	4,83	4,75
3.3. Kapaciteti organizues për udhëheqje me sistemin dhe shërbimit arsimore lokale	4,17	4,33	4,17
3.4. Qasja strategjike për udhëheqjen e sistemit dhe shërbimet arsimore lokale	2,75	3,67	3,58

Në vazhdim, hollësisht do të analizojmë gjashtë treguesit që përbëjnë këtë nën-indeks:

Tregues 3.1. Shkollat pajisen për të plotësuar normat dhe standardet për hapësirë dhe pajisje

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka sjellë normat dhe standardet për hapësirë dhe pajisje të shkollave, të cilat paraqesin standardet minimale që duhet të posedon çdo shkollë. Në momentin kur shkollat u dorëzuan në nivelin lokal, konstatimi i

përgjithshëm ishte se pajisja nuk plotëson standardet. Pushteti qendror nuk përgatiti dotacione synuese, madje asnjë mekanizëm për t'i dorëzuar shkollat në gjende solide, por në mënyrë implicite pushteteve lokale ju mbeti detyra të kujdesen për shkollat, të punojnë sipas këtyre normave dhe standardeve. Me këtë tregues ne masim: a është njoftuar administrata komunale me normat, a ka bërë incizim të gjendjes së shkollave dhe a kanë investuar mjete plotësuese në shkollat për inventar dhe pajisje shkollore.

Vlera mesatare e notave për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2011 është njësoj sikur në vitin 2010 dhe paraqet 3,83.

Individualisht në komuna, nuk ka më komuna që nuk i njohin/përdorim normativat dhe standardet, nuk ka bërë analizë të gjendjes në shkollat dhe nuk ka ndarë mjete për atë qëllim – do të thotë se nuk kemi më nota të dobëta për treguesin. Nga ana tjetër, 7 prej 12 komunave kanë marrë notë të lartë, që do të thotë se i dinë normat, bëjnë incizim dhe investojnë mjete.

Konkluzioni i përgjithshëm është se komunat janë të njoftuar me normat dhe standardet, kanë realizuar incizime të caktuara të gjendjes dhe disa kanë investuar mjete për përmirësimin e gjendjes sipas planeve dhe programeve paraprkishtë të caktuar.

Tregues 3.2: Efektiviteti në sigurimin e transportit falas të nxënësve dhe drunj për shkollat

Ky tregues tregon sa efektive janë siguruar transporti dhe drunj për nxënësit në komunën. Matet me kombinimin e variablave: mënyra e zbatimit të furnizimeve publike; rregullsia e sigurimit të drunjve dhe transportit për nxënësit, arsyet për vonesat eventuale dhe ndërprerja e mësimin për shkak të mungesës së transportit ose drunjve.

Vlera mesatare e notave për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara për vitin 2011 është 4,83 që tregon se komunat me sukses e organizojnë transportin falas të nxënësve dhe ngrohjen për shkollat, pa vonesa të mëdha të shërbimeve dhe pa ndërprerja të mësimin. Ajo që është konstatuar është se për shkak të udhëzimeve të marra nga Byroja për Prokurime Publike, komunat tash kanë për detyrë që prokurimet t'i dorëzojnë shkollave, që është një potencial për humbje në bazë të ekonomisë vëllimore.

Theksojmë se ky tregues në kontekst të vëzhgimit ka kufizime të caktuara, në kuptimin se tregon përpjekjet të cilat komunat në nivelin lokal i bëjnë për të siguruar rregullisht dru për ngrohje dhe transport për nxënësit. Në këtë drejtim, notën e lartë e pasqyron realiteti – komunat mirë janë gjetur dhe në nivelin lokal i bëjnë prokurimet publike, etj. Por, nga ana tjetër jemi dëshmitarë që sigurimi i transportit për nxënësit vetëm në vitin 2011 ishte bërë problem numër një në arsimin e decentralizuar. Ajo

është pasojë e një problemi tjetër – problemi me financat dhe shpërndarja e tyre. Këtë problem më hollësisht e shqyrtojmë në fokusin special të këtij vëzhgimi.

Tregues 3.3: Kapaciteti organizues për udhëheqje me sistemin dhe shërbimeve arsimore lokale

Nuk mund të ketë rezultate në asnjë veprimtari, posaçërisht në një shërbim masiv siç është arsimi, pa mos angazhuar resurse përkatëse njerëzore që do të organizojnë dhe menaxhojnë implementimin e shërbimit. Për këtë arsye është prezantuar ky tregues që duhet të zbulojë sa potencial njerëzor është angazhuar në arsim nga administrata komunale (a ka person që punon në arsim, e bërë atë ekskluzive ose vetëm pjesërisht, a ekziston inspektor komunal për arsim dhe si në mënyrë organizuese komuna komunikon me shkollat që është ingerenca e saj).

Njësoj sikur në vitin 2010, edhe në 2011 gjysma e komunave të analizuara kanë punësuar së paku një person që punon vetëm në arsim, kanë inspektor për arsim dhe praktikojnë 3-5 mënyra të komunikimit me shkollat. Vlera mesatare e notës së këtij treguesi për 12 komunat e hulumtuara në vitin 2011 është 4,17. Rezultatet tregojnë që mesatarisht në komunat kanë person të punësuar i cili vetëm një pjesë të kohës e kushton arsimin dhe shpeshherë është inspektor për arsim dhe zbatohen dy mënyra dhe forma të komunikimit me shkollat.

Tregues 3.4: Qasja strategjike për udhëheqjen e sistemit dhe shërbimeve arsimore lokale

Ky është një tregues shumë i rëndësishëm, sepse në fakt tregon sa i rëndësishëm është arsimi për komunën. Ajo matet me kombinim të disa variablave: a ekziston strategji për arsim dhe në çfarë forme, a ka projekte të buxhetuar nga ajo strategji dhe a përfshihen rezultatet e vetë-vlerësimit të shkollave në procesin e planifikimit strategjik të komunës.

Vlera mesatare e notave për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara për vitin 2011 është 3,58. Numri i komunave që kanë mbetur në nivelin fillestar (me notën 1) është sërish 1.

3.5 Nën-indeks i transparencës dhe përgjegjshmërisë në arsim

Transparenca dhe përgjegjshmëria e komunës nuk duhet të harrohen për asnjërin nga ingerencat individuale. Andaj, në këtë monitorim duhet vëzhguar edhe në nivel të arsimin. Nën-indeksi përbëhet vetëm nga dy tregues, të cilat në vete përfshijnë shumë elemente: transparencë dhe publicitet në punën e komunës nga fusha e arsimin dhe përgjegjshmëri në punën dhe gatishmërinë e informatave me karakter

publik. Treguesit vlerësohen në bazë të përgjigjeve cilësore të mbledhura me pyetësorët dhe intervistave të bëra gjatë fazës së grumbullimit të të dhënave.

Faktori i peshës së këtij nën-indeksi është 16/100, ky nën-indeks merr pjesë me peshë prej 16% në vlerën e plotë të IPDA. Mesatarja republike për vitin 2011 është 4,05.

Në tabelën më poshtë kemi një pasqyrë të gjithë treguesve të këtij indeksi dhe pasqyrë e vlerës mesatare për secilin për periudhën 2008-2009.

TREGUES	2008/2009	2010	2011
4.1. Transparencë dhe publicitet në punën e komunës nga fusha e arsimit	3,92	3,67	4,21
4.2. Përgjegjshmëri në punën dhe gatishmëri të informatave me karakter publik	3,58	3,42	4,05

Tregues 4.1 Transparencë dhe publicitet në punën e komunës nga fusha e arsimit

Vlera e këtij treguesi tregon sa publik dhe transparent është zbatimi i arsimit në komunën përkatëse. Ajo përfshirin variablat vijuese: mënyra e informimit të qytetarëve për çështjet e lidhura me arsimin; organizimin e takimeve me përfaqësuesit dhe bordet shkollore (BSH) dhe udhëheqjes/administratës së komunave; takime mes shoqatave rinore të qytetarëve dhe udhëheqjes komunale për tema të lidhur me arsimin.


Vlera mesatare e notave për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara është 4,21. **Gjendja mesatare tregon se gjendja është përmirësuar gjatë vitit 2011 dhe që përdoren katër mënyra të informimit të qytetarëve për arsimin; në disa komuna organizohen takime mes udhëheqjes së komunave dhe përfaqësues të bordeve shkollore, por më shpesh organizohen takime me shoqatat e qytetarëve për tema lidhur me arsimin edhe atë në nivel vjetor.**

Tregues 4.2. Përgjegjshmëri në punë dhe gatishmëri të informatave me karakter publik

Përgjegjshmëria është pak më e ndryshme nga transparenca sepse ka të bëjë me mënyrat të cilat komunat japin llogari para qytetarëve për punët financiare dhe resurset tjera në arsim. Gjatë vlerësimit të këtij treguesi, merren parasysh njohuritë nëse ekziston: publikim i temave nga fusha e arsimit në raportet ose në materialet informuese për qytetarët; publikimi i planeve financiare dhe bilanceve përfundimtare të shkollave në gazetën zyrtare komunale; a janë vendosur informatat publike për arsim në internet faqen e komunës dhe raportet e vetë-vlerësimit a publikohen në ueb faqen e komunës.

Vlera mesatare e notave për këtë tregues për 12 komunat e hulumtuara është 4,05, e cila mund të përshkruhet si: arsimiti është pjesërisht i përfaqësuar në raportet dhe materialet informuese; raportet financiare të shkollave publikohen në gazetën zyrtare; informatat publike nga fusha e arsimit nuk janë të vendosur në internet faqen e internetit ndërsa raportet e vetë-vlerësimit nuk publikohen në ueb faqen e komunës ndonëse është obligim ligjor.

Të gjitha komunat sigurojnë forma dhe mënyra për informim të qytetarëve me të dhënat lidhur me arsimin dhe i publikojnë. Raportet e vetë-vlerësimit të shkollave nuk publikohen në ueb faqet nga asnjë prej komunave, që është në kundërshtim me rregulloret ligjore.



4. Analizë të rezultateve të decentralizimit në urbanizmin dhe planifikimin urbanistik për vitin 2011

4.1 Indeks i performancave të decentralizimit në urbanizëm dhe planifikim urbanistik (IPDU)


Zbatimin e decentralizimit në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik e matim nëpërmjet IPDU - Indeksi i Performancave të Decentralizimit në Fushën e Urbanizmit dhe Planifikimit Urbanistik. IPDU është një përmbledhje e treguesve që pasqyrojnë nivelin që kanë arritur komunat në kuptim të zbatimit të politikave për urbanizëm dhe planifikim urbanistik. Ky indeks në dymbëdhjetë komunat e analizuara për vitin 2008 ishte 3,12, për 2009 ka shënuar rënie në 3,05 që në fund sërish të rrit vlerën dhe të arrijë 3,24. Në vitin 2011 IPDU e mban vlerën prej 3,24 që ishte arritur vitet paraprake ndonëse ka ndryshime në vlerat e nën-indekseve.

Kjo do të thotë se në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik në vitin 2011, procesi i decentralizimit në përgjithësi ka nivelin e arritur gjatë vitit 2010.

Indeksi i IPDU-së është i përbërë nga 4 nën-indekse dhe madhësia e tij varet nga ndikimet përkatëse. Nën-indeksi i parë (NI 1) përfshin zbatimin e politikave për decentralizim në pjesën e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik. Ky nën-indeks në përgjithësi jep perceptimin e komunave për lirinë e tyre mbi këtë ingerencë. Nën-indeksi i dytë (NI 2) mat gjendjen financiare të komunave në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik dhe ka të bëjë me kapacitetet fiskale të komunës për hartimin dhe realizimin e planeve urbanistike. Nën-indeksi i tretë (NI 3) mat performancat e shërbimeve komunale në pjesën e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik dhe ka të bëjë dhe efektivitetin e komunave gjatë ofrimit të shërbimeve të ndryshme nga fusha e kësaj ingerence. Nën-indeksi i katërt (NI4) ka të bëjë me transparencën dhe përgjegjshmërinë e NJVL-së në pjesën e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik në bazë të hapave ligjore që janë ndërmarrë nga komunat për informim të implementimit të detyrave si dhe në bazë të aktiviteteve tjera individuale që komunat i zbatojnë për të siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri më të madhe të komunave për ingerencën e caktuar.

Vlerat e nën-indekseve që formojnë IPDU-në me faktorët e tyre peshues për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011 janë dhënë në tabelën më poshtë:

	Nën-indekse	Faktori i peshës	2008	2009	2010	2011
1.	NI 1: Zbatimi i politikave për decentralizim në pjesën e urbanizmit	28%	2,59	2,62	2,70	3,32
2.	NI 2: Gjendja financiare e NJVL-ve në fushën e urbanizmit	31%	3,44	3,13	3,37	3,52
3.	NI 3: Performancat e shërbimeve të NJVL-ve në pjesën e urbanizmit	24%	3,13	3,18	3,10	3,01
4.	NI 4: Transparencë dhe përgjegjshmëri në fushën e urbanizmit	17%	3,42	3,42	4,10	4,07
IPDU			3,12	3,05	3,24	3,24




Siç mund të shihet nga tabela, rëndësi më të madhe për zbatimin e ingerencave nga fusha e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik ka nën-indeksi NI 2, d.m.th., gjendja financiare e NJVL-ve në pjesën e urbanizmit, ndërsa më pak rëndësi në aspekt të decentralizimit është vlerësuar nën-indeksi NI 4 - transparencë dhe përgjegjshmëri në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik.


Vlerë më të madhe në 2011 ka nën-indeksi për Transparencë dhe Përgjegjshmëri në Fushën e Urbanizmit - 4,07 ndonëse ajo është një ulje për 0.03 pikë indeksi për dallim nga viti 2010. Në vitin 2011, Nën-indeksi për Gjendjen Financiare të BNJV-ve në fushën e urbanizmit shënon rritje të mëtutjeshme (në vazhdimësi prej vitin e tretë dhe është rritur prej 3.37 në vitin 2010 në 3.52 në 2011 ndërsa i rëndësishëm është fakti që ka tejkaluar vlerën që ka pasur në 2008 - 3,44. Duhet të theksohet se Nën-indeksi i Performancave të Shërbimeve të BNJV në pjesën e urbanizmit pas rritjes së vlerës së saj në vitin 2009 për 1.6% për dallim nga viti 2008, tash vitin e dytë me rend shënon ulje dhe në vitin 2011 i afrohet vlerës së tretë me 3.01. Në vitin 2011, me

vlerë 4.07, Nën-indeksi për Zbatimin e Politikave për Decentralizim e mban nivelin e njëjtë për dallim nga viti 2010.

Nga 12 komunat e vëzhguara në 2011: 9 kanë pasur vlerë më të lartë, 3 vlerë më të ulët ndërsa asnjë komunë nuk ka pasur vlerë të ngjashme të IPDU¹⁷ për 12 komunat. Kjo përqindje për 2008, 2009, 2010 dhe 2011 është prezantuar në figurën më poshtë:



Në figurën më poshtë janë dhënë vlerat e indeksit IPDU për gjitha 12 komunat në veçanti edhe atë për 2008, 2009, 2010 dhe 2011. Qendra tregon vlerën 1 të indeksit, i cili rritet drejt periferisë deri në vlerën maksimale 5.



Më poshtë është dhënë një pasqyrë e hollësishme për secilin nën-indeks dhe tregues që e formojnë atë nën-indeks. Njëherë është dhënë përshkrim për secilin prej treguesve dhe pastaj nota mesatare në pajtim me kriteret e dhëna në Metodologjinë e lartpërmendur.

17 Njësoj sikur vlera e IPDU-së është intervali i caktuar me kufij $\pm 8\%$ të vlerës së IPDU

4.2 Nën-indeks për implementimin e politikave për decentralizim në urbanizmin

Ky nën-indeks formohet nga tregues me të cilat jepet vlerësim sa politikat kombëtare implementohen dhe/ose kontribuojnë për decentralizimin e suksesshëm. Faktori i peshës së këtij nën-indeksi është 28/100, d.m.th., ky nën-indeks merr pjesë me peshë prej 28% të vlerës së plotë të IPDU.

Vlera e këtij nën-indeksi dhe notat mesatare të treguesve që e formojnë për 2008, 2009, 2010 dhe 2011 janë shfaqur në tabelën, ndërsa më poshtë është dhënë përshkrim i hollësishëm i secilit prej treguesve. Vlera e këtij nën-indeksi është më e lartë në krahasim me vitet paraprake dhe shënon përparim gjatë katër viteve të fundit. Kjo rritje ka ndikim më të madh mbi rritjen e plotë të IPDU për vitin 2011.

2008		2009		2010		TREGUES / faktori i peshës (%)	2011		
NI 1	nota e in.	NI 1	nota e in.	NI 1	nota e in.		vlera e in.	nota e in.	NI 1
2,59	3,83	2,62	3,92	2,70	4,17	1.1 Bashkëpunimi mes komunës dhe pushtetit qendror	0,70	4,00	3,32
	2,00		2,00		2,00	1.2 Liri në ekzekutimin e ingerencave	2,03	3,00	

Rritja e këtij nën-indeksi për dallim nga 2008 dhe 2009 bëhet kryesisht nga numri më i madh i mendimeve të fituara nga punonjësit e sektorëve për urbanizëm mbi ndikimin që e ka pushteti qendror në zbatimin e kësaj ingerence.

Tregues 1.1: Bashkëpunimi mes komunës dhe pushtetit qendror në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik.

Ky tregues tregon se në çfarë mase pushteti qendror i ndjek aktivitetet e NJVL-ve në fushën e sjelljes së dokumentacionit urbanistik. Duke marrë parasysh faktin që NJVL-të sipas rregullave ligjore janë të obliguar të kërkojnë dhe marrin pajtim për dokumentacionin urbanistik ose për pjesë të aktiviteteve tjera lidhur me planifikimin urbanistik nga ministritë dhe agjencitë shtetërore, ky tregues jep përpjesëtimin mes pajtimeve të kërkuara nga ana e NJVL dhe mendimeve të fituara nga ana e pushtetit qendror. Sa më i madh ky tregues aq më i madh bashkëpunimi mes NJVL dhe pushtetit qendror. Ky tregues ishte vlerësuar me faktor peshues prej 32%.

Vlera e këtij treguesi është ulur prej 0,75 në vitin 2010 në 0,70 në vitin 2011. Notat përkatëse mesatare për këtë tregues janë 4,17 në vitin 2010 dhe 4,00 në vitin 2011.

Në vitin 2011, komunat e analizuara më pak vështirësi në procesin e hartimit dhe sjelljes së PU-së kanë me Ministrinë e Kulturës, ndërsa më vështirë me Kadastrën,

Agjencinë për Rrugë ndërsa komunat rurale kanë probleme edhe me Ministrinë e Bujqësisë.

Komunat edhe në vitin 2011 i theksojnë nevojat që ministrinë të japin pëlqime për periudha më të shkurtë, duke respektuar afatet ligjore, si dhe më shpejtë dhe më konkretisht të japin vërejtje në procesin e hartimit dhe sjelljes së planeve urbanistike. Komunat më shumë kanë vërejtje në rastet e “kthimi i shumëfishë i planeve nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe çdoherë me vërejtje të ndryshme” si dhe “vonesa e dhënies së pëlqimeve = jashtë afatit të përcaktuar me ligj”.

Edhe në vitin 2011 komunat e analizuar mendojnë se pëlqimet e fundit për planet urbanistike nga MTL të jepet vetëm për procedurën e sjelljes së planeve urbanistike, dhe mos të futet në planet urbanistike. Ndryshimet e planeve duhet të thjeshtësohen, por në mënyrë të kujdesshme që mos të krijohen mundësi për keqpërdorime dhe korrupsion.

Tregues 1.2: Liri në ekzekutimin e ingerencave

Ky është treguesi i dytë që merr pjesë në formimin e nën-indeksit. Ky tregues është me faktor 68% dhe është rezultat i mendimeve të punësuarve në sektorët për urbanizëm dhe kryetarët e komunave për ndikimin që ka pushteti qendror mbi implementimin e kësaj ingerence, si dhe rëndësia e lirisë më të madhe gjatë implementimit të ingerencës që shpie drejt efektivitetit dhe efikasitetit më të madh në punë.

Ky tregues është i vetmi prej treguesve që vlerën e saj ka fituar në bazë të mendimeve nga të punësuarit e intervistuar në sektorët për urbanizëm dhe kryetarët e komunave për rëndësinë e nivelit të lirisë së ekzekutimit të ingerencës. Sipas mendimit të tyre, planifikimi urbanistik ende është shumë i centralizuar dhe nevojitet decentralizim i mëtutjeshëm i planifikimit urbanistik. Komunat duhet të marrin pavarësi më të madhe në planifikimin, ndërsa organet shtetërore duhet të mbrojnë interesat shtetëror, kushtetutën dhe ligjshmërinë.

Vetëm 16.7% të komunave të analizuar mendojnë që rregulloret ekzistuese ligjore mbi urbanizmin dhe planifikimin urbanistik ka mundur 100% të implementohen nga komunat ndërsa pjesa tjetër prej 83.3% mendojnë që kjo ka qenë e mundur për 75% të rregulloreve ligjore. Edhe në vitin 2011 sundon mendimi që kjo është konsekuencë e ndryshimit të shpeshtë të ligjeve dhe akteve nënligjore të cilat nuk janë të përmbyllura dhe pajtuara tërësisht. Si rezultat i kësaj krijohen pasiguri ligjore dhe pamundësi për implementimin e përgjysmuar të ingerencave.

Duke marrë parasysh se çfarë rëndësie i jepet këtij treguesi në kuadër në nën-indeksit, për të pasur matje konzistente, vlera mesatare e këtij treguesi në vitin 2011 është më e madhe për dallim nga tre vitet paraprake të analizuar (2008, 2009 dhe 2010) dhe është e qëndrueshëm për gjitha komunat e analizuar - 2.03 - që i përket

vlera e mesme e notës së treguesit prej 3, që tregon se komunat në shkallë prej 1 deri 5 lirinë e tyre për ekzekutimin e ingerencës e kanë vlerësuar me 3. Perceptimi nga ana e komunave mund të sqarohet edhe me sjelljen ose ndryshimin e një sërë rregullore ligjore nga fusha e urbanizmit me të cilat ingerenca ishte përhapur, fillimisht me Ligjin për Veprim me Objektet e Paligjshme¹⁸ dhe Ligji për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjin për Veprim me Objektet e Paligjshme¹⁹, si dhe me Ligjin për Tokë Ndërtimtarie²⁰ dhe Ligjin për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit për Tokë Ndërtimtarie²¹.

Komuna e Ilindenit ishte komunat e parë që është në vëzhgim dhe që morri të drejtën të udhëheq me tokën shtetërore ndërtimtarie të pandërtuar²² -*"Komuna e Ilindenit e morri këtë të drejtë pasi i kishte plotësuar kushtet e parashikuara me Ligjin për Tokë Ndërtimtarie që hyri në fuqi më 1 korrik të këtij viti. Ishte miratuar edhe programi vjetor për udhëheqje me tokë shtetërore, janë siguruar një numër i mjaftueshëm i nëpunësve të licencuar komunal dhe është vendosur sistem për ankand publik elektronik, si dhe komision për këtë detyrë. Pas trajnimeve dhe testimeve të zbatuara, katër nëpunës të punësuar në Komunën e Ilindenit kanë marrë autorizim për udhëheqje të procedurave për tjetërsim të tokës shtetërore të pandërtuar"*²³.

4.3 Nën-indeks i gjendjes financiare të komunës në pjesën e urbanizmin

Ky nën-indeks ka lidhje me aftësinë financiare të komunave për implementim të ingerencës në fushën e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik. Faktori i peshës së këtij nën-indeksi është 31/100, d.m.th., ky nën-indeks merr pjesë me peshë prej 31% në vlerën e plotë të IPDU.

Vlera e këtij nën-indeksi dhe notat mesatare të treguesve që e formojnë për 2008, 2009, 2010 dhe 2011 janë shfaqur në tabelën, ndërsa më poshtë është dhënë përshkrim i hollësishëm i secilit prej treguesve. Vlera e këtij nën-indeksi është rritur prej 3,13 (2009) në 3,52 në 2011, por nuk ka arritur vlerën e vitit 2008 - 3,44.

18 Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 23/11

19 Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 54/11

20 Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 17/11

21 Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 53/11

22 Përfshirë 31 dhjetorin, 2011 kushtet i kanë plotësuar komunat: 1. Manastir, 2. Shtip, 3. Gjevgjeli, 4. Demir Kapi, 5. Probishtip, 6. Ilinden, 7. Koçan, 8. Berovë, 9. Karposh, 10. Strumicë, 11. Strugë, 12. Kisella Vodë, 13. Vinicë dhe 14. Dellçeva

23 <http://www.ilinden.gov.mk/en/node/595>

2008		2009		2010		TREGUES / faktori i peshës (%)	2011		
NI 2	nota e in.	NI 2	nota e in.	NI 2	nota e in.		vlera на ин.	nota e in.	NI 2
	3,08		2,67		2,83	2.1 Aftësia financiare e komunës për implementim të PU	0,26	3,00	
	3,92		3,58		3,67	2.2 Shpenzime kapitale në komunën për banorë	2,594	3,67	
3,44	4,08	3,13	3,67	3,37	4,42	2.3 Aftësia finance e komunës për hartimin e PU	0,92	4,75	3,52
	2,33		2,33		2,00	2.4 Kapaciteti i komunës për rrëzimin e objekteve të paligjshme	0,26	2,00	

Tregues 2.1: Aftësia financiare e komunës për implementim të PU

Ky tregues tregon sa prej shpenzimeve të plota të komunës janë të synuar për shpenzime kapitale dhe fitohet si përpjesëtim i shpenzimeve kapitale mbi shpenzimet e plota. Sa më i madh përpjesëtimi, aq më e madhe nota e treguesit.

Ky tregues bashkë me tjetrin, nëpërmjet shpenzimeve kapitale jep indikacion sa është aftësia financiare e komunave të zbatojnë PU. Faktori i peshës së këtij treguesi është 21%.

Vlera mesatare e këtij treguesi është 0,26 në vitin 2011. Nota mesatare e këtij treguesi në vitin 2011 është 3,00 dhe vitin e tretë me rend shënon rritje për dallim nga 2010 (2,83) por është më e vogël nga nota mesatare e këtij treguesi në vitin 2008 (3,08).

Praktikisht, kjo do të thotë që komunat e analizuar edhe në vitin 2011, njësoj sikur në tre vitet paraprake, kanë shfrytëzuar vetëm 20% të buxheteve të plota për investime kapitale, ndërsa pjesa tjetër shpenzohet për shpenzimet aktuale dhe shpenzime për rroga dhe kontribute.

Tregues 2.2: Shpenzime kapitale në komunën për banorë

Ky tregues jep vlerësim për shumën e investimeve kapitale për banor në komunën. Fitohet si përpjesëtim i shpenzimeve të plota kapitale dhe numrin e banorëve në komunën. Sa më i madh përpjesëtimi, aq më e madhe nota e treguesit. Faktori i peshës së këtij treguesi është 21%.

Vlera e këtij treguesi është në rritje të vazhdueshme, në vitin 2011 është 2594 denarë/banor dhe është rritur për dallim nga vitet 2008 (2.039) dhe 2009 (1.639), dhe 2010 (2440 denarë/banor).

Notat mesatare përkatëse për këtë tregues për gjitha komunat e analizuar janë 3,92 (2008), 3,58 (2009), 3,67 (2010) dhe 3,67 (2011).

Vlera mesatare e treguesit në vitin 2011 shënon rritje për 6.3% në krahasim me vitin 2010, sërish nota mesatare e indeksit është në nivel të njëjtë me 2010. Kjo do të thotë që ka renditje të parregullt të madhësisë së mjeteve të shpenzuara për investime kapitale mes komunave të analizuar. Shkaku i dytë është kufiri i vlerës së treguesit që e cakton madhësinë e notës së treguesit. Numri i rritur i investimeve mbi pjesën e sipërme të kufirit për vlera të larta është arsye për përpjesëtimin e pabarabartë të rritjes së vlerës së mesme të treguesit dhe notës përkatëse mesatare në vitin 2010 dhe 2011.

Tregues 2.3: Aftësia finance e komunës për hartimin e PU

Ky tregues tregon sa komunat pavarësisht financojnë hartimin e PU. Treguesi kalkulohet nëpërmjet përpjesëtimin të shumës së mjeteve vetjake që komuna ka shpenzuar për financim të hartimit të PU dhe shpenzimet e plota të shpenzuara për financim të hartimit të PU. Faktori i peshës së këtij treguesi është 35%.

Vlera e këtij treguesi është rritur prej 0,86 më 2010 në 0,92 në vitin 2011. Notat mesatare përkatëse për këtë tregues janë 4,08 (2008), 3,67 (2009) dhe 4,42 (2010) dhe 4,75 në 2011.

Kjo rritje e vlerës mesatare të treguesit për 7% dhe notës përkatëse mesatare për 7.5% në vitin 2011 për dallim nga viti 2010 që vetëm e konfirmon konkluzionin e dhënë në vitin 2010 që komunat ende më tepër kanë vazhduar vetë të financojnë hartimin e dokumentacionit urbanistik. Praktikisht, kjo do të thotë se komunat e analizuar në pjesën më të madhe, rreth 90%, vetë financojnë hartimin e PU-ve.

Edhe në vitin 2011 është aktuale konstatimi i vitit 2010 që shpeshherë, ngadalësia e procedurave për sjelljen e planeve urbanistike shton mospërdorimin e mjeteve të parashikuara në buxhetin komunal për këtë detyrë dhe të mos të realizohen në tërësi.

Gjithashtu, edhe në vitin 2011 paraqitet praktika ekzistuese ku firmat e licencuara për hartimin e PU shkruajnë dokumentet në baza që nuk përputhen me gjendjen faktike, shpie drejt mospërdorimit të planeve të reja të hartuara në afat më të gjatë dhe imponon nevojën e azhurnimit të tyre të vazhdueshëm, dhe mund të shkakton mungesë kronike të mjeteve për hartimin e dokumentacioneve urbanistike në buxhetet komunale.

Tregues 2.4 Kapaciteti i komunës për rrëzimin e objekteve të paligjshme

Treguesi jep vlerësim sa pjesë të mjeteve të parashikuara për rrëzimin e objekteve të paligjshme janë realizuar. Sa më i madh përpjesëtimi, aq më e madhe nota e treguesit. Faktori i peshës së këtij treguesi është 23%.

Vlera e këtij treguesi në 2011 (0.26) është njësoj me vitin 2010 (0,26). Gjithashtu, edhe nota përkatëse mesatare e këtij treguesi në vitin 2011 është njësoj me atë 2010 (2,00).

Kjo do të thotë se edhe në vitin 2011, njësoj sikur në vitin 2010 komunat e analizuara kanë realizuar vetëm rreth 20% të mjeteve të parashikuara për rrëzimin e objekteve të paligjshme.

Edhe në vitin 2011, njësoj sikur në vitet paraprake, një prej arsyeve është mjetet e pamjaftueshme për realizim të gjitha vendimeve të sjella. Në vitin 2011 si arsye kryesore theksohet pritja e zbatimit të Ligjit për Veprime me Objektet e Paligjshme me të cilën do të rregullohet statusi i objekteve të paligjshme.

4.4 Nën-Indeks i performancave të shërbimeve komunale në pjesën e urbanizmit

Ky nën-indeks përfshin tregues që kanë të bëjnë me performancat e shërbimeve që ofrojnë komunat në pjesën e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik.

Faktori i peshës së këtij nën-indeksi është 24/100, d.m.th., ky nën-indeks merr pjesë me peshë prej 24% në vlerën e plotë të IPDU.

Vlera e këtij nën-indeksi dhe notat mesatare të treguesve që e formojnë për 2008, 2009, 2010 dhe 2011 janë shfaqur në tabelën, ndërsa më poshtë është dhënë përshkrim i hollësishëm i secilit prej treguesve. Vlera mesatare e këtij nën-indeksi në 2011 është ulur në 3,01 në krahasim me vitet paraprake të analizuara - 3,13 (2008), 3,18 (2009) dhe 3,10 (2010) dhe është viti i tretë në ulje. Kjo ulje kryesisht ndodh për shkak të vlerës së ulët të inspeksionit urbanistik dhe ndërtimor.



Tabela 1

2008		2009		2010		TREGUES / faktori i peshës (%)	2011		
NI 3	nota e in.	NI 3	nota e in.	NI 3	nota e in.		vlera e in.	nota e in.	NI 3
	2,08		2,08		2,08	3.1 Mbulimi me PGJU, PUD, PU për fshat dhe PU jashtë vendbanimeve në territorin e komunës	0,06	2,00	
	5,00		5,00		5,00	3.2 Efikasiteti i lëshimit të Ekstraktit për PU	0,96	4,83	
	4,25		4,83		4,33	3.3 Efikasiteti i lëshimit të Vendimit për Kushte Lokacioni	0,75	3,83	
3,13	4,42	3,18	4,50	3,10	4,42	3.4 Efikasiteti i lëshimit të Aprovimeve për ndërtim	0,90	4,50	3,01
	4,33		4,33		3,92	3.5 Efikasiteti i lëshimit të Aprovimit për përdorim	0,94	4,75	
	1,83		1,58		1,75	3.6 Performanca të inspektoratit urbanistik dhe ndërtimor	0,07	1,00	
	2,58		2,67		2,75	3.7 Inovacioni në implementimin e ingerencave	2,92	2,92	

Tregues 3.1: Mbulimi me PGJU, PUD, PU për fshatrat dhe PU jashtë vendbanimeve në territorin e komunës

Ky tregues tregon sa pjesë e territorit të komunave të analizuara është mbuluar me plane urbanistike në vitin aktual. Faktori i peshës së këtij treguesi është 29%.

Nota mesatare përkatëse për këtë tregues edhe në vitin 2010 është e ngjashme me dy vitet paraprakisht të analizuar. Dallimet e vogla janë rezultat i afatit të skaduar të një pjese të dokumentacionit urbanistik dhe mungesa e të rejave për disa komuna, që është prezantuar si ky problem nuk ekziston.

Ndonëse ka rritje të investimit vetjak në përpilimin e dokumentacionit urbanistik gjatë viteve të analizuara, komunat e analizuara ende kanë nevoja të dukshme për rritje të sipërfaqes së përfshirë me PU-të dhe ajo është një prej prioriteteve të tyre, posaçërisht pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Veprim me Objekte të Paligjshme dhe Ligjit për Tokë Ndërtimtarie dhe ndryshimet e tyre.

Tregues 3.2: Efikasiteti i lëshimit të Ekstraktit për PU

Efikasiteti i komunave të analizuar për lëshimin e Ekstraktit nga PU matet me anë të përpjesëtimit të Ekstrakteve të lëshuara dhe kërkesave të dorëzuara. Faktori i peshës së këtij treguesi është 9%.

Njësoj sikur në tre vitet paraprake të analizuar (2008, 2009 dhe 2010), ky tregues edhe në vitin 2011 ka vlerë e cila paraqet 0,96. Nota mesatare përkatëse për këtë tregues është 4,83.

Komunat e analizuar mbajnë ende gati 100% efikasitet në lëshimin e Ekstrakteve nga PU.

Tregues 3.3: Efikasiteti i lëshimit të Vendimit për Kushte Lokacioni

Efikasiteti i komunave të analizuar për lëshimin e Vendimeve për kushte lokacioni matet me anë të përpjesëtimit të Vendimeve të lëshuara dhe kërkesave të dorëzuara. Faktori i peshës së këtij treguesi është 12%.

Vlera e këtij treguesi në vitin 2011 është 0,75 dhe shënon ulje për dallim nga 2010 (0,87), 2009 (0,94), dhe 2008 (0,83).

Nota mesatare përkatëse për këtë tregues është 3,83 për vitin 2011 dhe 4,33 (2010), 4,83 (2009) dhe 4,25 (2008).

Niveli prej 75% të efikasitetit të dhënies së Vendimeve për Kushte Lokacioni është ulje për dallim nga vitet paraprake, ndonëse nuk ka qenë e konfirmuar, ajo është rezultat i kërkesave të pakompletuara për dhënien e vendimeve sesa mungesa e efikasitetit të komunave.

Tregues 3.4: Efikasiteti i lëshimit të Aprovimeve për ndërtim

Sa komunat e analizuar janë efikase në lëshimin e Aprovimeve për ndërtim shihet nga përpjesëtimi i numrit të kërkesave të dorëzuara dhe numrit i aprovimeve. Faktori i peshës së këtij treguesi është 12%.

Vlera e këtij treguesi është rritur prej 0,88 në 2010 në 0,90 në vitin 2011.

Gjithashtu edhe nota mesatare përkatëse për këtë tregues në vitin 2011 është rritur në 4,50 për dallim nga viti 2010 (4,42) dhe ka arritur vlerën që ka pasur treguesi në vitin 2009.

Efikasiteti i lartë i lëshimit të Aprovimeve për ndërtim prej 90% është mbajtur edhe në vitin 2011.

Tregues 3.5: Efikasiteti i lëshimit të Aprovimit për përdorim

Efikasiteti i komunave të analizuar për lëshimin e Aprovimeve për përdorim matet me anë të përpjesëtimit të Aprovimeve të lëshuara dhe kërkesave të dorëzuara. Faktori i peshës së këtij treguesi është 12%.

Vlera e këtij treguesi pas tre viteve ulje - 0,86 (2008) 0,84 (2009) dhe 0,76 (2010) - në 2011 e arrin vlerën më të madhe prej 0,94.

Nota mesatare përkatëse për këtë tregues prej 4,75 në 2011 është gjithashtu vlera më e madhe që është arritur gjatë katër viteve të vëzhgimit.

Ky është një prej treguesve që shënon ulje për dallim nga tre vitet paraprake si rezultat i investimeve që janë realizuar në periudhën paraprake.

Lëshimi i Aprovimeve për përdorim mbetet një shërbim me përqindje të lartë të efikasitetit prej 85%.

Tregues 3.6: Performanca të inspektoratit urbanistik dhe ndërtimor

Përpjesëtimi mes Vendimeve të realizuara të objekteve të paligjshme dhe numrit të Vendimeve të marra për rrëzimin e objekteve të paligjshme tregon si komunat e analizuar trajtojnë objektet e paligjshme. Faktori i peshës së këtij treguesi është 15%.

Vlera mesatare e këtij treguesi prej 0,07 në vitin 2011 është niveli më i ulët për dallim nga vitet paraprake 0,25 (2010), 0,19 (2009) dhe 0,27 (2008).

Nota mesatare përkatëse për këtë tregues në vitin 2011 është gjithashtu më e ulët dhe paraqet 1,00.

Në komunat e analizuar Tendencia e performancës së dobët për realizimin e Vendimeve për Rrëzimin e Objekteve të Paligjshme vazhdoi si vitet paraprake ashtu edhe në vitin 2011 me rreth 7% të vendimeve të realizuara. Arsyet janë në pritjen e rezultateve të para nga zbatimi i Ligjit për Veprim me Objektet e Paligjshme. Kjo duhet të alarmojë komunat se në vend që të ndërpritet praktika për të cilën edhe ishte sjellë ligji, krijohet një klimë e mosrespektimit të mëtutjeshëm të dispozitave ligjore nga fusha e urbanizmit.

Tregues 3.7: Inovacioni në implementimin e ingerencave

Sa komunat e analizuar janë inovative në implementimin e ingerencave tregon ky tregues mes përdorimit të internetit dhe GIS teknologjisë në zbatimin e ingerencave, si dhe me posedimin e resurseve përkatëse njerëzore që mund të përdorin teknologjitë e reja. Faktori i peshës së këtij treguesi është 12%.

Vlera mesatare e këtij treguesi është njësoj me vlerën mesatare të notës së treguesit në vitin e katërt me rend shënon përmirësim të vazhdueshëm. Në vitin 2011, shënon rritjen e vlerës në 2,92 për dallim nga 2,75 (2010), (2,67 2009) dhe 2,58 (2008).

Edhe në vitin 2011 mund të përfundohet se komunat e analizuara katër vite me rend kanë rritur vlerën e treguesit për inovacion në implementimin e ingerencave, por ende nuk kanë arritur kapacitete të rëndësishme për implementim të ingerencës me përdorimin e arritjeve të reja teknike.

4.5 Nën-indeksi i transparencës dhe përgjegjshmërisë në pjesën e urbanizimit

Ky nën-indeks ka të bëjë me transparencën e komunave gjatë zbatimit të ingerencës urbanizëm dhe planifikim urbanistik.

Faktori i peshës së këtij nën-indeksi është 17/100, d.m.th., ky nën-indeks merr pjesë me peshë prej 17% në vlerën e plotë të IPDU.

Vlera e këtij nën-indeksi dhe notat mesatare të treguesve që e formojnë bashkë me notat mesatare përkatëse të gjitha komunave të analizuara për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011 janë shfaqur në tabelën, ndërsa më poshtë është dhënë përshkrim i hollësishëm i secilit prej treguesve. Vlera mesatare e këtij treguesi është e njëjtë me vlerën e notës së treguesit dhe në vitin 2011 shënon mbajtje të vlerës prej 4,07 për dallim nga viti paraprak 2010 - 4,10.

Tabela 2

2008		2009		2010		TREGUES / faktori i peshës (%)	2011		
NI 4	nota e in.	NI 4	nota e in.	NI 4	nota e in.		vlera e in.	nota e in.	NI 4
3,42	3,08	3,42	3,17	4,10	4,00	4.1 Shkalla e përfshirjes së qytetarëve në çështje për planifikim hapësinor dhe urbanistik me rëndësi lokale	4,50	4,50	4,07
	3,83		3,75		4,25	4.2 Përgjegjshmëria për punën	3,42	3,42	
	3,42		3,42		4,08	4.3 Gatishmëria e informatave me karakter publik	4,17	4,17	

Tregues 4.1: Shkalla e përfshirjes së qytetarëve në çështje për planifikim hapësinor dhe urbanistik me rëndësi lokale

Ky tregues është caktuar nëpërmjet mënyrave në të cilat komunat e analizuar grumbullojnë informatat kthyesë nga qytetarët dhe format e organizuara të pjesëmarrjes qytetare në procedurat për sjelljen e PU. Faktori i peshës së këtij treguesi është 39%.

Vlera mesatare e këtij treguesi është e njëjtë me vlerën mesatare të notës së treguesit në vitin 2011 dhe shënon rritjen e vlerës në 12,5% (4,50) për dallim nga 2010 (4,00).

Rritja e notës mesatare për këtë tregues do të thotë se komunat e analizuar kanë vazhduar edhe në vitin 2011 të përmirësojnë sistemin e grumbullimit të informatave kthyesë nga qytetarët dhe format e organizuara të pjesëmarrjes qytetare në procedurat për lidhur me çështjet për planifikim hapësinor dhe urbanistik.

Tregues 4.2: Përgjegjshmëria për punën

Treguesi për përgjegjshmëri në punën e komunave të analizuar në fushën e urbanizmit matet me mënyrat e informimit të qytetarëve për çështjet nga fusha e urbanizmit dhe planifikimit urbanistik. Faktori i peshës së këtij treguesi është 31%.

Vlera mesatare e këtij treguesi është e njëjtë me vlerën mesatare të notës së treguesit në vitin 2011 dhe shënon vlerën më të vogël prej 3,42 për dallim nga vitet paraprake.


Në vitin 2011 komunat e analizuar përveç që kanë përmirësuar sistemin për grumbullimin e informatave kthyesë nga qytetarët, kanë rritur edhe nivelin e përgjegjshmërisë në punë në fushën e urbanizmit.

Tregues 4.3: Gatishmëria e informatave me karakter publik

Ky tregues mat transparencën e komunës me anë të kërkesave të përgjigjur për qasje në informata me karakter publik. Faktori i peshës së këtij treguesi është 0,31.

Vlera e këtij treguesi është e njëjtë me vlerën mesatare të notës së treguesit në vitin 2011 dhe shënon rritjen e vlerës - 4,17 - për dallim nga 2010 (4,08).

Ndonëse nota prej 4,17 në shkallë deri 5,00 do të thotë se komunat e analizuar janë mjaft transparente për qasje në informata me karakter publik nga fusha e urbanizmit sërish duhet të theksohet që numri i informatave me karakter publik të kërkuar nga fusha e urbanizmi nuk është i lartë.



ANEKSI 1:

Kritere për notimin e treguesve fiskal

Definicioni i treguesit	Variabël sasiore dhe cilësore	KRITER dhe NOTË				
		1	2	3	4	5
1.1. Pjesëmarrje në shpenzimet komunale për shpenzime publike në RM për banor	1. Shpenzimet e plota të komunës/banor	< 0,08	0,09 -0,11	0,12 - 0,14	0,15 - 0,17	> 0,18
	2. Shpenzimi i plotë publik në RM/banor					
1.2. Pjesëmarrje në të hyrat e buxhetit themelor në lidhje me të hyrat e plota	1. Të hyrat në buxhetin themelor të komunës	< 0,30	0,31 -0,35	0,36 - 0,40	0,41 - 0,45	> 0,46
	2. Të hyrat e plota e komunës					
1.3. Shkalla e autorizimit për vendimmarrje të pavarur	1. Shuma e të hyrave për të cilat komuna vetë i përcakton tarifat	< 0,10	0,11 - 0,15	0,16 - 0,20	0,21 -0,30	> 0,31
	2. Të hyrat e plota të komunës (buxheti i plotë)					
1.4. Kontrolli lokal mbi transferimet nga pushteti qendror	1. Transferime në buxhetin themelor	< 0,10	0,11 - 0,15	0,16 - 0,20	0,21 -0,30	> 0,31
	2. Transferimet e plota					
1.5. Pjesëmarrje në shpenzime kapitale në shpenzime të plota	1. Shpenzimet e plota kapitale	< 0,10	0,11 - 0,15	0,16 -0,20	0,21 -0,30	> 0,31
	2. Shpenzimet e plota					
1.6. Pjesëmarrje me mjete vetjake në financimin e programeve/fushave (rrugë dhe rrugica, arsim, mbrojtje sociale, zjarrfikës, komunale, kulturë, sport etj.)	1. Shpenzimet e plota sipas fushave/programeve	< 1,00	1,01 - 1, 30	1,31 -1,50	1,51 -1,90	> 1,91
	2. Transferimet e plota nga pushteti qendror sipas fushës/programit					
2.1. Bilanci financiar vjetor (rezerva)	1. Të hyrat e plota vjetore	< 0,05	0,06 - 0,09	0,10 - 0,12	0,13 -0,15	> 0,15
	2. Shpenzimet e plota vjetore					
2.2. Shpenzimet kapitale në komunën për banor (dhe krahasim me RM)	1. Shpenzimet e plota kapitale	< 500	500 - 1.000	1.000 -1.500	1.500 - 2.000	> 2.000
	2. Numri i banorëve në komunën					
2.3. Shpenzime lokale për lloj të paragrafit ekonomik	1. Paragrafë shpenzuese zhvillimore (46+47+48)	< 0,15	0,16 -0,25	0,26 -0,35	0,35 - 0,40	> 0,41
	2. Paragrafë operativ-administrativ (40+41+42)					

Definicion i treguesit	Variabël sasiore dhe cilësore	KRITER dhe NOTË				
		1	2	3	4	5
2.4. Gatishmëria e shpenzimeve operuese	1. Të hyrat vjetore operative (71+72)	< 0,15	0,16 – 0,25	0,26 – -0,35	0,35 – -0,40	> 0,41
	2. Të hyrat e plota e komunës					
2.5. Struktura e të hyrave	1. Të hyrat e plota	< 1,00	1,01 – 1,25	1,26 – 1,50	1,51 – -1,80	> 1,81
	2. të hyrat nga transferime dhe donacione					
2.6. Të hyrat për banor (krahasim me RM)	1. Të hyrat e plota	<5.000	5.001 – 7.000	7.001- 9.000	9.001 – -11.000	> 11.001
	2. Numri i banorëve në komunën					
3.1. Shkalla e papunësisë	1. Numri i personave të papunësuar	> 0,61	0,60 – 0,46	0,45 – 0,31	0,30 – -0,16	< 0,15
	2. Numri i popullatës aktive ekonomikisht					
3.2. Shkalla e varfërisë	1. Popullata e varfër (sipas kritereve të ESHS)	0,48		0,392		0,128
	2. Popullata e plotë					
3.3. Të hyrat për amvisëri	1. Numri i amvisërive	< 5.000	5.000 – -10.000	10.001 – - 15.000	15.001 – - 20.000	> 20.000
	2. Të hyrat mesatare mujore për amvisëri					
4.1. Gatishmëria e informatave për buxhetin dhe bilancin përfundimtar të komunës	1. Informata për buxhetin dhe bilancin përfundimtar janë të gatshme publikisht	Nuk janë të gatshme – 0, deri më 2 mënyra informimi – 1 pikë, më tepër se 2 mënyra – 2 pikë				
	2. Ekzistojnë procedura zyrtare për mënyrën si qytetarët njoftohen me planifikimin dhe realizimin e buxhetit komunal	Nuk ka procedura zyrtare – 0 pikë, ka – 1 pikë				
	3. Forma të pjesëmarrjes së qytetarëve në krijimin e buxhetit komunal	Nuk ka pjesëmarrje – 0, deri më 2 mënyra – 1 pikë, më tepër se 2 mënyra – 2 pikë				
4.2. Përgjegjshmëria në punë	1. Revizori i brendshëm	Nuk ka revizor të caktuar – 0 pikë, ka revizor – 1, ka revizor dhe procedura të themeluara – 3 pikë				
	2. Raportet revizore nga ESHR publikohen, si në nivelin lokal ashtu edhe në komunë	Jo – 0, Nuk ka pasur revizion –1, Po – 2				
4.3. Gatishmëria e informatave me karakter publik	1. Numri i kërkesave të përgjigjur për gatishmëri të informatave me karakter publik	Të gjitha të përgjigjur – 2, nuk ka kërkesa ose pjesërisht të përgjigjur – 1, asnjë – 0				
	2. Komuna ka qenë lëndë e ESHR në vitin 2008 ose 2009	Jo – 0, Po – 1				
	3. Gatishmëria e dokumenteve nga revizioni financiar i bërë nga ESHR	Janë të gatshme në komunën – 2, nuk janë të gatshme – 0				

ANEKSI 2: Kritere për notimin e treguesve në arsim

TREGUES	Nivel/notë 5	Nivel/notë 4	Nivel/notë 3	Nivel/notë 2	Nivel/notë 1
1.1. Komuna merr pjesë aktive në punën e bordeve shkollore	Janë emëruar përfaqësues në gjitha KD; lajmërohet nga secila seancë deri në periodike;	Janë emëruar përfaqësues në 41-80% të KD; lajmërohet prej në vit deri në periodike;	Janë emëruar përfaqësues në 41-60% të KD; lajmërohet prej në vit deri në periodike;	Janë emëruar përfaqësues në 21-40% të KD; nuk lajmërohet	Janë emëruar përfaqësues në më pak se 20 % të KD; nuk lajmërohet nga seancat;
1.2. Komuna ndërmerr dhe realizon iniciative për hapje të shkollave të reja dhe mbyllje të atyre ekzistuese	Janë bërë një ose më tepër elaborate dhe është realizuar së paku një iniciativë	Janë bërë një ose më tepër elaborate, të pranuar nga MASH dhe iniciativa është dhënë për vendim nga Këshilli i Komunës	Është bërë së paku një elaborat dhe iniciativa është dërguar MASH-it që është në proces të vendimit	Iniciativa për ndryshimin e rrjetit është në fazë përpunimi, por nuk është dërguar në MASH	Nuk janë bërë elaborate as iniciativa për ndryshim të rrjetit
1.3. Komuna respekton ligjet dhe politikat për arsim fillor	Mungesa e masave të caktuara gjatë vëzhgimit të bërë nga MASH; komunikimi me ISHT është e rregullt	Janë dhënë masa dhe iniciativa për kryerjen e ingerencës së përgjithshme, komunikimi me ISHT është e rregullt	Janë dhënë dënime për mungesat materiale dhe procedurale, ndërsa komunikimi me ISHT është e rregullt	Janë dhënë nota dhe masa për ligjshmërinë e vendimeve, ndërsa komunikimi me ISHT nuk është e rregullt	Është dhënë masë për marrje ne ingerencës nga ana e MASH; komunikimi me ISHT nuk ekziston
1.4. Komuna udhëheq dokumentim të drejtë për shkollat e saja, sipas rregullave ligjore	Përveç atyre të detyrueshmeve, udhëheq edhe baza dhe regjistra tjerë	Udhëhiqen regjistrat e parashikuar me ligj, ndërsa mbliidhen edhe të dhëna tjera të pasistematizuara	Udhëhiqen regjistrat e parashikuar me ligj dhe në formë të sistematizuara	Udhëhiqen regjistrat e parashikuar me ligj, por jo në formë të sistematizuara	Komuna nuk i udhëheq regjistrat për shkollat të parashikuara me ligj
1.5. Komuna ka marrë pronësinë mbi objektet shkollore	Më tepër se 81%	prej 61 - 80%	prej 41 - 60%	prej 21 - 40%	Më pak se 20 %
2.1. Përpjesëtimi i gjithsej mjeteve të harxhuara në arsim dhe mjeteve të fituara me dotacion nga niveli qendror	>111%	101 -110%	90,1 - 100%	81 - 90%	<80%

TREGUES	Nivel/notë 5	Nivel/notë 4	Nivel/notë 3	Nivel/notë 2	Nivel/notë 1
2.2. Pjesëmarrje të mjeteve vetjake komunale në shpenzimet e plota për arsim	>30,1%	10,1 - 30,0 %	3,1 - 10%	0,1 - 3%	0%
2.3. Shpenzime kapitale të synuar për arsimin	>10,1%	7,01 - 10%	3,01 - 7%	0,1 - 3%	0%
2.4. Shuma e dotacioneve kapitale për arsim të fituara nga niveli qendror, në emër dhe dispozicion të komunës	>1.000	600 - 999	300 - 599	1 - 299	0
2.5. Kuadro plotësues mësimor financiar nga komunat	>20	10 - 19	2 - 9	1	0
2.6. Menaxhim efektiv financiar i sistemit arsimor lokal	<p>Për secilin nga pesë kriteret fitohet nga një pikë nëse është plotësuar:</p> <ol style="list-style-type: none"> Vendim i Këshillit të komunës për matësit dhe kriteret e shpërndarjes së mjeteve mes shkollave në komunën; Janë themeluar procedura lokale për rregullimin e punimit buxhetor dhe planifikimit të shkollave; Komuna përgatit analizë të gjendjes financiare dhe nevojave të shkollave të bëra në bazë të treguesve organizativ, financiar dhe tjerë; Komuna përgatit elaboratë për racionalizim të shpenzimeve në komunat, dhe Transferimi i mjeteve financiare me kohë shkollave. 				
3.1. Shkollat pajisen për të plotësuar normat dhe standardet për hapësirë dhe pajisje	Njohje me normat, analizat e bëra dhe mjetet plotësuese të investuara	Njohje me normat, incizimet dhe analizat e bëra ose mjetet e investuara për ndihmesa shkollore.	Nuk ka njohje me normat, nuk janë bërë incizimet dhe analizat ose por janë investuar mjete për ndihmesa shkollore.	Nuk ka njohje me normat, por janë bërë incizimet dhe analizat. Nuk janë investuar mjete për ndihmesa shkollore	Nuk ka njohje me normat, nuk janë bërë incizimet dhe analizat. Nuk janë investuar mjete për ndihmesa shkollore
3.2. Efektiviteti në sigurimin e transportit falas të nxënësve dhe drunjt për shkollat	Prokurimet publike bëhen në mënyrë lokale dhe nuk ka pasur asnjë vonesë në sigurimin e shërbimit dhe as ndërprerje të mësimin	Prokurimet publike bëhen në mënyrë lokale dhe ka pasur vonesë në sigurimin e shërbimit për shkak të vonesës së klientit ose pengesa procedurave por nuk ka pasur ndërprerje të mësimin	Prokurimet publike bëhen në mënyrë lokale dhe ka pasur vonesë në sigurimin e shërbimit për shkak të publikimit të vonshëm të procedurës së tenderit, por nuk ka pasur ndërprerje të mësimin	Prokurimet publike bëhen në mënyrë lokale, me vonesë të shërbimit nga më tepër arsye por nuk ka pasur ndërprerje të mësimin	Prokurimet publike nuk bëhen në mënyrë lokale, me vonesë të shërbimit nga më tepër arsye dhe me ndërprerje të mësimin

TREGUES	Nivel/notë 5	Nivel/notë 4	Nivel/notë 3	Nivel/notë 2	Nivel/notë 1
3.3. Kapaciteti organizues për udhëheqje me sistemin dhe shërbimit arsimore lokale	Së paku një person punon vetëm për arsimin; ekziston inspektor lokal për arsim; zbatohen më tepër se tre mënyra të komunikimit me shkollat, mes të cilave edhe vizita personale	Një person punon pjesërisht vetëm për arsimin; ekziston inspektor lokal për arsim; zbatohen dy mënyra të komunikimit me shkollat	Një person punon pjesërisht vetëm për arsimin; nuk ekziston inspektor lokal për arsim; zbatohen dy mënyra të komunikimit me shkollat	Nuk ka person që ka detyra për arsim, nuk ka inspektor për arsim, por ka komunikim të drejtpërdrejtë me shkollat në lidhje me planet financiare	Nuk ka person që ka detyra për arsim, nuk ka inspektor për arsim dhe nuk ka vizita personale të shkollave
3.4. Qasja strategjike për udhëheqjen e sistemit dhe shërbimet arsimore lokale	Ka strategji për arsim, projekte të buxhetuar, ndërsa vetë-vlerësimi i shkollave përfshihet në planifikimin strategjik	Ekziston strategji, nuk ka projekte të buxhetuar ndërsa vetë-vlerësimi nuk merret parasysh	Ka strategji, por si pjesë e strategjisë për ZHLE. Ka projekte të buxhetuar, por rezultatet e vetë-vlerësimi nuk merren parasysh	Strategjia për arsim është në fazën përgatitore. Rezultatet e vetë-vlerësimi të shkollave ende nuk merren parasysh	Nuk ka strategji, ndërsa vetë-vlerësimi nuk merret parasysh gjatë planifikimit strategjik
4.1. Transparencë dhe publicitet në punën e komunës nga fusha e arsimit	> 4 mënyra të informimit të qytetarëve; organizohen takime me KD; organizohen takime me SHQ	> 4 mënyra të informimit të qytetarëve; organizohen takime me KD; nuk organizohen takime me SHQ	< 3 mënyra të informimit të qytetarëve; nuk organizohen takime me KD; organizohen takime me SHQ;	Qytetarët në mënyrë të kufizuar informohen për çështjet e arsimit; nuk organizohen takime me KS; nuk organizohen takime me SHQ;	Qytetarët nuk informohen për çështjet e arsimit; nuk organizohen takime me KS; nuk organizohen takime me SHQ;
4.2. Përgjegjshmëri në punën dhe gatishmëri të informatave me karakter publik	Arsimi është përfaqësuar në raportet dhe materialet e informimit; raportet financiare të shkollave publikohen në gazetata zyrtare; informatat publike nga arsimi janë vendosur në internet faqen e komunës; raportet nga vetë-vlerësimi publikohen në ueb faqen e komunës	Arsimi është përfaqësuar në raportet dhe materialet e informimit; raportet financiare të shkollave publikohen në gazetata zyrtare; informatat publike nga arsimi janë vendosur në internet faqen e komunës; raportet nga vetë-vlerësimi nuk publikohen në ueb faqen e komunës	Arsimi është pjesërisht i përfaqësuar në raportet dhe materialet e informimit; raportet financiare të shkollave publikohen në gazetata zyrtare; informatat publike nga arsimi janë vendosur në internet faqen e komunës; raportet nga vetë-vlerësimi nuk publikohen në ueb faqen e komunës	Arsimi nuk është përfaqësuar në raportet dhe materialet e informimit; raportet financiare të shkollave publikohen në gazetata zyrtare; informatat publike nga arsimi nuk janë vendosur në internet faqen e komunës; raportet nga vetë-vlerësimi nuk publikohen në ueb faqen e komunës	Arsimi nuk është përfaqësuar në raportet dhe materialet e informimit; raportet financiare të shkollave nuk publikohen në gazetata zyrtare; informatat publike nga arsimi nuk janë vendosur në internet faqen e komunës; raportet nga vetë-vlerësimi nuk publikohen në ueb faqen e komunës.

ANEKSI 3:

Kritere për notimin e treguesve në urbanizmin

Definicioni i treguesit	Variabël sasiore dhe cilësore	KRITER dhe NOTË				
		1	2	3	4	5
1.1. Bashkëpunimi mes komunës dhe pushtetit qendror	1. Numri i pajtimeve të fituara nga ministritë	< 0,2	0,2-0,4	0,4-0,6	0,6-0,8	> 0,8
	2. Numri i pajtimeve të kërkuara në ministritë					
1.2. Liri në ekzekutimin e ingerencave	1. Nota të udhëheqësve të sektorëve/ departamenteve për urbanizëm dhe kryetarëve të komunave	< 0,2	0,2-0,4	0,4-0,6	0,6-0,8	> 0,8
1.3. Aftësia financiare e komunës për implementim të PU	1. Shpenzime të plota kapitale	< 0,10	0,11-0,15	0,16-0,2	0,21-0,3	>0,31
	2. Shpenzime të plota					
1.4. Shpenzime kapitale në komunën për banor	1. Shpenzime të plota kapitale	<500	500-1.000	1.000-1.500	1.500-2.000	>2.000
	2. Numri i banorëve në komunë					
1.5. Aftësia finance e komunës për hartimin e PU	1. Shuma e mjeteve vetjake që komuna i ka shpenzuar për financim të hartimit të PU-së (në denarë)	< 0,2	0,2-0,4	0,4-0,6	0,6-0,8	> 0,8
	2. Shuma e mjeteve të plota të shpenzuara për financim të hartimit të PU-së (në denarë)					
1.6. Kapaciteti i komunës për rrëzimin e objekteve të paligjshme	1. Shuma e mjeteve të realizuara për rrëzimin e objekteve të paligjshme (në denarë)	< 0,2	0,2-0,4	0,4-0,6	0,6-0,8	> 0,8
	2. Shuma e mjeteve të parashikuara për rrëzimin e objekteve të paligjshme (në denarë)					
1.7. Mbulimi me PGJU, PUD, PU për fshat dhe PU jashtë vendbanimeve në territorin e komunës	1. 1. Sipërfaqja e komunës e përfshirë me PU (ha)	< 0,02	0,02-0,04	0,04-0,08	0,08-0,1	> 0,1
	2. 2. Sipërfaqja e plotë e komunës (ha)					
1.8. Efikasiteti i lëshimit të Ekstraktit për PU	1. Numri i ekstrakteve të nxjerra nga PU	< 0,3	0,3-0,5	0,5-0,7	0,7-0,9	> 0,9
	2. Numri i kërkesave të parashtruara për ekstrakte të PU					
1.9. Efikasiteti i lëshimit të Vendimit për Kushte Lokacioni	1. Numri i Vendimeve të dhëna për kushte lokacioni	< 0,3	0,3-0,5	0,5-0,7	0,7-0,9	> 0,9
	2. Numri i kërkesave të parashtruara për Vendimeve të dhëna për kushte lokacioni					

Definicion i treguesit	Variabel sasior dhe cilësor	KRITER dhe NOTË				
		1	2	3	4	5
1.10. Efikasiteti i lëshimit të Aprovimeve për ndërtim	1. Numri i Aprovimeve të dhëna për ndërtim 2. Numri i kërkesave të parashtruara për Aprovimeve për ndërtim	< 0,3	0,3-0,5	0,5-0,7	0,7-0,9	> 0,9
1.11. 5 Efikasiteti i lëshimit të Aprovimit për përdorim	1. Numri i Aprovimeve të dhëna për përdorim 2. Numri i kërkesave të parashtruara për Aprovimeve për përdorim	< 0,3	0,3-0,5	0,5-0,7	0,7-0,9	> 0,9
1.12. Performanca të inspektoratit urbanistik dhe ndërtimor	1. Numri i Vendimeve të realizuara për rrëzimin e objekteve të paligjshme 2. Numri i Vendimeve të sjella për rrëzimin e objekteve të paligjshme	< 0,3	0,3-0,5	0,5-0,7	0,7-0,9	> 0,9
1.13. Inovacioni në implementimin e ingerencave	1. Formularët nga fusha e urbanizmit janë të gatshme në internet 2. Komuna posedon kompjuter me softuer të licencuar për GIS 3. Komuna ka punonjës që kanë njohuri për krijimin e bazave me të dhëna dhe prezantim grafik me GIS softuer	1.(jo=1; po=2) 2. (jo=0; po=1) 3. (jo=0; po 2 = 1; >2=2) 1+2+3				
1.14. Shkalla e përfshirjes së qytetarëve në çështje për planifikim hapësior dhe urbanistik me rëndësi lokale	1. Numri i mënyrave për grumbullimin e informatave kthyesë nga qytetarët 2. Numri i formave të organizuara të pjesëmarrjes qytetare në procedurat e sjelljes së UP	1.(nuk ka dhe deri më 2 = 1; >2=2) 2. (jo=0; po2 = 1; >2=3) 1+2				
1.15. Përgjegjshmëria për punën	1. Numri i mënyrave për informim të qytetarëve për çështje nga fusha e urbanizmit	nuk ka =1; deri më 2=1; 3=3; 4=4; 5=5				
1.16. Gatishmëria e informatave me karakter publik	1. Numri i kërkesave të përgjigjur për gatishmëri në informata me karakter publik 2. Numri i ankesave të përgjigjur për gatishmërinë e informatave me karakter publik	1.(gjitha-3, nuk ka kërkesa/ pjesërisht -2, asnjë-1) 2.(gjitha -2, nuk ka kërkesa/ pjesërisht -1, asnjë -0) 1+2				

ANEKSI 4:

Përmbledhje e notës sipas fushave për partner komunat

KOMUNA KUMANOVË		2008		2009		2010		2011	
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	Kumanovë	RM	Kumanovë	RM	Kumanovë	RM	Kumanovë	RM
1. Financa	50%	2,78	2,96	2,85	2,81	2,88	2,99	2,70	2,97
2. Arsimit	25%	3,44	3,39	3,50	3,49	3,43	3,52	3,57	3,67
3. Urbanizëm	25%	2,90	3,12	3,02	3,05	3,17	3,24	3,46	3,24
Indeksi i përgjithshëm		2,98	3,11	3,06	3,04	3,09	3,19	3,11	3,21

KOMUNA TETOVË		2008		2009		2010		2011	
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	Tetovë	RM	Tetovë	RM	Tetovë	RM	Tetovë	RM
1. Financa	50%	2,43	2,96	2,21	2,81	2,27	2,99	2,44	2,97
2. Arsimit	25%	3,05	3,39	3,10	3,49	3,74	3,52	3,64	3,67
3. Urbanizëm	25%	2,99	3,12	3,37	3,05	3,07	3,24	3,48	3,24
Indeksi i përgjithshëm		2,73	3,11	2,72	3,04	2,84	3,19	3,00	3,21

KOMUNA GOSTIVAR		2008		2009		2010		2011	
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	Gostivar	RM	Gostivar	RM	Gostivar	RM	Gostivar	RM
1. Financa	50%	2,40	2,96	2,31	2,81	2,63	2,99	2,98	2,97
2. Arsimit	25%	3,49	3,39	3,60	3,49	2,66	3,52	3,48	3,67
3. Urbanizëm	25%	3,49	3,12	3,35	3,05	3,07	3,24	3,45	3,24
Indeksi i përgjithshëm		2,95	3,11	2,89	3,04	2,75	3,19	3,22	3,21

KOMUNA KARPOSH		2008		2009		2010		2011	
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	Karposh	RM	Karposh	RM	Karposh	RM	Karposh	RM
1. Financa	50%	4,26	2,96	3,91	2,81	4,26	2,99	4,04	2,97
2. Arsimit	25%	3,48	3,39	3,65	3,49	3,18	3,52	4,20	3,67
3. Urbanizëm	25%	3,23	3,12	3,51	3,05	3,97	3,24	3,96	3,24
Indeksi i përgjithshëm		3,81	3,11	3,75	3,04	3,92	3,19	4,06	3,21

KOMUNA STRUMICË		2008		2009		2010		2011	
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	Strumicë	RM	Strumicë	RM	Strumicë	RM	Strumicë	RM
1. Financa	50%	3,60	2,96	3,27	2,81	4,18	2,99	4,13	2,97
2. Arsimit	25%	3,60	3,39	3,75	3,49	3,75	3,52	4,08	3,67
3. Urbanizëm	25%	3,07	3,12	3,32	3,05	3,76	3,24	3,91	3,24
Indeksi i përgjithshëm		3,47	3,11	3,40	3,04	3,97	3,19	4,06	3,21

KOMUNA VELES		2008		2009		2010		2011	
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	Veles	RM	Veles	RM	Veles	RM	Veles	RM
1. Financa	50%	2,85	2,96	2,75	2,81	2,60	2,99	2,72	2,97
2. Arsimit	25%	3,96	3,39	4,01	3,49	3,89	3,52	4,20	3,67
3. Urbanizëm	25%	3,43	3,12	2,73	3,05	3,16	3,24	3,08	3,24
Indeksi i përgjithshëm		3,27	3,11	3,06	3,04	3,06	3,19	3,18	3,21

KOMUNA BOGOVINË		2008		2009		2010		2011	
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	Bogovinë	RM	Bogovinë	RM	Bogovinë	RM	Bogovinë	RM
1. Financa	50%	1,37	2,96	1,60	2,81	1,81	2,99	2,05	2,97
2. Arsimit	25%	2,96	3,39	3,04	3,49	3,82	3,52	3,41	3,67
3. Urbanizëm	25%	2,37	3,12	2,59	3,05	3,33	3,24	3,68	3,24
Indeksi i përgjithshëm		2,02	3,11	2,21	3,04	2,69	3,19	2,80	3,21

KOMUNA DIBËR		2008		2009		2010		2011	
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	Dibër	RM	Dibër	RM	Dibër	RM	Dibër	RM
1. Financa	50%	3,14	2,96	2,71	2,81	2,55	2,99	2,72	2,97
2. Arsimit	25%	3,21	3,39	3,06	3,49	3,85	3,52	4,07	3,67
3. Urbanizëm	25%	3,42	3,12	2,81	3,05	2,68	3,24	3,41	3,24
Indeksi i përgjithshëm		3,23	3,11	2,82	3,04	2,91	3,19	3,23	3,21

KOMUNA NEGOTINË		2008		2009		2010		2011	
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	Negotinë	RM	Negotinë	RM	Negotinë	RM	Negotinë	RM
1. Financa	50%	2,75	2,96	2,94	2,81	3,15	2,99	2,96	2,97
2. Arsimit	25%	2,96	3,39	3,16	3,49	3,17	3,52	3,57	3,67
3. Urbanizëm	25%	2,60	3,12	2,44	3,05	3,26	3,24	3,14	3,24
Indeksi i përgjithshëm		2,77	3,11	2,87	3,04	3,18	3,19	3,16	3,21

KOMUNA ILINDEN		2008		2009		2010		2011	
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	Ilinden	RM	Ilinden	RM	Ilinden	RM	Ilinden	RM
1. Financa	50%	4,19	2,96	3,94	2,81	4,43	2,99	4,07	2,97
2. Arsım	25%	4,06	3,39	4,13	3,49	4,20	3,52	3,64	3,67
3. Urbanizëm	25%	3,58	3,12	3,58	3,05	3,63	3,24	3,66	3,24
Indeksi i përgjithshëm		4,01	3,11	3,90	3,04	4,17	3,19	3,86	3,21

KOMUNA STARO NAGORIÇANË		2008		2009		2010		2011	
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	Staro Nagoriçanë	RM	Staro Nagoriçanë	RM	Staro Nagoriçanë	RM	Staro Nagoriçanë	RM
1. Financa	50%	2,69	2,96	2,42	2,81	2,09	2,99	1,96	2,97
2. Arsım	25%	1,97	3,39	2,58	3,49	2,57	3,52	3,48	3,67
3. Urbanizëm	25%	2,91	3,12	2,30	3,05	2,39	3,24	2,39	3,24
Indeksi i përgjithshëm		2,57	3,11	2,43	3,04	2,29	3,19	2,45	3,21

KOMUNA OHËR		2008		2009		2010		2011	
Indeksi i performancave	Faktori i peshës	Ohër	RM	Ohër	RM	Ohër	RM	Ohër	RM
1. Financa	50%	3,75	2,96	3,53	2,81	3,33	2,99		2,97
2. Arsım	25%	4,47	3,39	4,33	3,49	4,01	3,52	2,62	3,67
3. Urbanizëm	25%	3,34	3,12	3,54	3,05	3,36	3,24	3,50	3,24
Indeksi i përgjithshëm		3,83	3,11	3,73	3,04	3,51	3,19	3,28	3,21